


Faqe 4

**Krerët e Qeverisë “zhvendosen” në parti**



Faqe 3

**Krasniqi pranon, Tadiqi ka bërë deklaratë politike**



Faqe 22

**Ulpiana, vetëm një për qind në dorë të shtetit**




Shtojca

**KOHA për sport: Humanisti Kuqi**


# KOHA Ditore

Numri 4256 • e hënë, 20 prill 2009 • Çmimi € 0.30


Arbëri Faqe 2

## Zbatimi i kontratave publike nuk monitorohet

Zbatimi i kontratave që lidhen në sektorin publik, të cilat financohen me paratë e taksapaguesve kosovarë, tash e sa kohë nuk është duke u monitoruar nga asnjë institucion jashtë autoriteteve kontraktuese. Por as monitorimi dhe zbatimi i Ligjit të prokurimit publik nuk është duke u bërë siç duhet, thuhet në raportin mbi përkrahjen e reformimit të prokurimit publik, i cili financohet nga BE-ja dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian. Në këtë raport, i cili është hartuar nga një konsorcium prej katër firmave ndërkombëtare, po ashtu theksohet se as rolet e tri institucioneve qendrore të prokurimit, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik(KRRPP), Organi Shqyrtues i Prokurimit(OSHP), si dhe Agjencia e Prokurimit Publik(APP), nuk janë shumë qartë të ndara. Në anën tjetër, ekspertët e projektit të Komisionit Evropian janë befasuar me njohuritë...

**Me shi**



Min. 8°C - Maks. 17°C

### Ekipi joformal i “Kohës Ditore” për GjND-në ballafaqon argumentet për pavarësi

# Mbrohen historia dhe ligjshmëria e pavarësisë

**Parimi i “Vetëvendosjes zhdëmtuese”, (remedial self-determination), uti possidetis, (zotëruesi i territorit në fund të konfliktit), mungesa e dokumenteve që Kosova ka qenë pjesë legale e Serbisë dhe përparësia e anës historike në anën e Kosovës, shihen si anët e forta të Kosovës para GjND-së nga ekspertët e së drejtës dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të historisë: Marc Weller, Florian Bieber, Noel Malcolm dhe Enver Hasani**

KOHA Ditore

*Sami Kastrati*

Prishtinë, 19 prill – Parimi i “Vetëvendosjes zhdëmtuese”, (remedial self-determination), parimi “uti possidetis”, (zotëruesi i territorit në fund të konfliktit), mungesa e dokumenteve se Kosova ka qenë pjesë legale e Serbisë dhe përparësia historike në anën e Kosovës, janë disa nga argumentet e ekspertëve më në zë të së drejtës ndërkombëtare dhe të historisë për mbrojtjen e pavarësisë së Kosovës, dy ditë pasi që Prishtina, Beogradi dhe një numër i shteteve i kanë deponuar deklaratat e tyre në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë.

Ekipi joformal i “Kohës Ditore” me ekspertët e së drejtës ndërkombëtare dhe të historisë, Marc Weller, Florian Bieber, Noel Malcolm dhe Enver Hasani, mendojnë se argumentet e lartpërmendura janë ndër më të rëndësishmet që do të mund të shfrytëzohen nga GjND-ja, para se kjo e fundit të japë opinionin këshillëdhënës për ligjshmërinë e pavarësisë.

“Kosova duket të jetë rasti i parë i ‘vetëvendosjes zhdëmtuese’ (remedial self-determination) – një e drejtë për vetëvendosje e krijuar në saje të një dëmi të shkaktuar nga qeveria ndaj një grupi që kërkon shkëputjen. Dëme do të mund të jenë shkeljet e të drejtave të njeriut, spastrimi etnik apo përjashtimi në vendimmarrje i grupit, për të cilin bëhet fjalë”, ka thënë Marc Weller në librin e tij “Shtetësia e kontestuar”.

Sipas tij, në një rast të tillë, kur një segment i definuar me rëndësi kushtetuese i popullsisë së shtetit i është nënshtruar represionit të vazhdueshëm, ku është përjashtuar nga qeverisja në hapësirën e vet kompakte të jetesës si dhe nga shteti qendror, dhe i cili i është ekspozuar fushatës sistematike dhe të zgjeruar për zhvendosjen e vet të përhershme, doktrina e unitetit territorial do të mund të humbte fuqinë e vet bindëse.

“Në vend të kësaj, vullneti i popullit i shprehur pa dyshime çdoherë e më shumë do të mund ta udhëzonte të vepruarit ndërkombëtar në rrethana dramatike dhe të jashtëzakonshme të kësaj natyre që njihen si të tilla botërisht. Për fat të keq, abuzimi që ia bëri kësaj doktrine Rusia, e cila veproi në rrethana plotësisht të ndryshme në raport me Osetinë Jugore dhe Abkhazinë, e kanë dëmtuar këtë zhvillim potencial”, shprehet ai.

(vijon në faqen e tretë)



**Me moton “Qëndro për vikend – përjetoje Kosovën”, të mërkurën në Prishtinë pritet të mbahet panairi i parë i turizmit i quajtur “Dita e turizmit në Kosovë”. Organizatorët e këtij panairi synojnë të fillojnë ta bëjnë Kosovën një destinacion turistik duke u munduar t’i ndalin turistët potencialë të qëndrojnë për vikende në Kosovë**

Arbëri Faqe 5

### Recensione të pavlera në UP

Statuti i Universitetit të Prishtinës shpesh është shpërfillur, me rastin e zgjedhjes së personelit akademik nga anëtarët e Senatit. Sa herë që të shpallet konkurs për personel, ngrihen komisione recensuese prej fakulteteve, vlerësimet e anëtarëve të të cilave komisione pak merren për bazë nga senatorët. Në shumë raste këta anëtarë nuk nxjerrin përfundime konform asaj që parasheh statuti...

Ekonomi Faqe 8

### Banka për Rindërtim dhe Zhvillim – “çelës i zhvillimit”

Ideja e partive opozitare për hapjen e një banke për zhvillim dhe rindërtim ka shtyrë njëkohësisht dhënien e mendimeve të ndryshme rreth dukjes dhe mënyrës së funksionimit të mundshëm të kësaj banke. Nëpërmes hapjes së një banke të tillë, socialdemokratët parashohin që të ketë përmirësim të gjendjes së rëndë sociale në Kosovë, e njëkohësisht edhe një zhvillimin të hovshëm ekonomik. Këshilli i sektorit...

Ekonomi Faqe 9

### Në pritje të kontratave për pronën e blerë në privatizim

Besim Elshani nga Tirana tash katërmbëdhjetë muaj ka blerë tokën bujqësore në Shkabaj përmes procesit të privatizimit në Kosovë dhe ende nuk ka nënshkruar kontratë për shitblerje me zyrtarët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). Ai i është futur garës për të blerë tokën bujqësore përmes firmës së tij “AGNA Investitor” nga Tirana duke ofruar çmimin më të lartë blerës prej 12.3 milionë euro...

Botë Faqe 21

### G-8 dështon në luftimin e urisë

Bota është "shumë larg arritjes" së qëllimit të vënë nga OKB-ja që deri më 2015 të përgjysmohet numri i njerëzve që ballafaqohen me urinë kronike, thuhet në draftin e deklaratës së tetë shteteve më të industrializuara të botës, ka raportuar të dielën "Financial Times". Burme brenda G-8-ës kanë thënë se kjo është "një e dhënë alarmuese" krahasuar me synimin që i kishin vënë vetes tetë vendet anëtare...

## Plus-minus

### Plusi i javës

# Ndalja e humbjeve të Trustit

**Pas rënies së madhe të aksioneve të Fondit të Trustit të Kursimeve Pensionale, raporti i fundit i Trustit tregon për ngritje të vlerës së aksioneve**




Në një vend ku lajmet e këqija janë përditshmëri, lajm i mirë mund të konsiderohet edhe zbutja e një lajmi të keq. Këtë herë plus i javës mund të konsiderohet lajmi i kumtuar se më nuk është duke rënë vlera e parave të Trustit Pensional të kosovarëve.

Muaji mars ka qenë muaj i kthimit pozitiv të vlerës së investimeve duke i kthyer shpresat tek kursimtarët kosovarë. Pas më shumë se një viti të rënies së vlerës së aksioneve të Fondit të Trustit të Kursimeve Pensionale, raporti i fundit i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës tregon për një ngritje të vlerës së aksioneve ku janë investuar mjetet e fondit pensional për afro 2,2 për qind që i bie rreth 5,6 milionë euro.

Ndryshe nga muaji mars që janë regjistruar ngritje të vlerës së aksioneve, në muajin shkurt Trusti ka rezultuar me humbjen e vlerës së aksioneve për 10 milionë e 188 mijë euro, përderisa në muajin e parë të këtij viti humbjet e Trustit kanë qenë 8 milionë e 513 mijë euro.

Trusti në tregjet ndërkombëtare ka investuar 80 për qind të mjeteve që kanë paguar kursimtarët e detyrueshëm, ndërsa pjesa tjetër, që shtohet çdo ditë nga kontribuuesit kosovarë, vazhdon të qëndrojë në Kosovë.

### Minusi i javës

# Marionetat

**Lajmi i keq: Tadiqi hyri sërish në "Kosovën e Serbisë sonë". Lajmi i mirë: kryeministri i Kosovës nuk ka deficit patriotik**



Si zakonisht, edhe këtë herë dilemën e hoqi Ambasada amerikane: "Përshëndesim vendimin e Qeverisë së Kosovës që t'i japë leje kryetarit të Serbisë, Boris Tadiq, që të lutet në Manastirin e Deçanit me rastin e së Premtes së Mirë ortodokse serbe... Ishte një vendim i drejtë".

Në të vërtetë, kjo deklaratë e lëshuar nga Dragodani tregon sa është "sovrane" Kosova.

Ndonëse zyrtarët kosovarë qenë zotuar se nuk do të lejojnë më zyrtarët e Serbisë që të enden poshtë e përpjetë Kosovës si në tokë të veten, dhe komisari i policisë pati thënë prerë se ka pranga edhe për presidentin Tadiq në kufi nëse ka nevojë - presidenti i Serbisë, Boris Tadiq, erdhi në Kosovë të premten. Ndezi një qiri në Manastirin e Deçanit dhe e kualifikoi Kosovën si pjesë të Serbisë.

"Porosia ime në Manastirin e Deçanit është porosi e paqes për serbët, për shqiptarët dhe të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovën e Serbisë sonë", ka theksuar ai.

Tadiqi nuk ka kërkuar leje nga institucionet e Kosovës, por nga misioni evropian në Kosovë, ndërsa Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar e mori atë ftesë dhe propozoi që Tadiqit t'i lejohej hyrja.

Pas këtij "propozimi" kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, dha "lejen" që Tadiqi, kryetari i Serbisë, të hynte në Kosovë, jo si kryetar i një shteti fqinj që shkon për vizitë në shtetin tjetër, por si kryetar në Kosovën "e Serbisë sonë".

Hyrja e Tadiqit është shkelje e sovranitetit të Kosovës. Mirëpo, institucionet e Kosovës edhe ashtu nuk janë duke vepruar si institucione të një vendi sovran. Vetë përkrahja nga Ambasada Amerikane tregon se "prapa vendimeve" të institucioneve të Kosovës gjithnjë qëndron dikush tjetër që i merr vendimet me të vërtetë. Kjo e bën Kosovën vend josovran dhe zyrtarët legjitimë të Kosovës i bën "marioneta" që lëvizin sipas penjve të të tjerëve.

Më parë, kur nuk iu lejua hyrja disa zyrtarëve të tjerë serbë që të hynin në Kosovë, institucionet e Kosovës mburreshin për "sovranitetin" e tyre, ndërsa më pas u mor vesh se ndalesa ndaj zyrtarëve serbë ishte masë ndëshkuese përmirësuese nga Evropa për disa nga këta zyrtarë që kishin dhënë deklarata të papërshtatshme.

Mirëpo, nuk është krejt gjithaq keq. Nga e gjithë kjo dëshmi e humbjes së sovranitetit, bile një gjë doli pozitive. Morëm vesh se, sido që të jetë, kryeministrin e kemi patriot.

"Nuk kam deficit patriotik në jetën time", tha ai. Dhe buzëqeshi.

**Zyrtarët e prokurimit në Kosovë vlerësohen me nota të dobëta**

# Zbatimi i kontratave publike nuk monitorohet

**Përveçse është vërejtur që zbatimi i kontratave publike nuk është duke u monitoruar nga organet jashtë autoriteteve kontraktuese, ekspertët e një projekti të Komisionit Evropian janë befasuar me njohuritë tepër të dobëta rreth prokurimit që kanë zyrtarët e prokurimit në Kosovë**

*Salie Gajtani-Osmankaq*

Prishtinë, 19 prill - Zbatimi i kontratave që lidhen në sektorin publik, të cilat financohen me paratë e taksapaguesve kosovarë, tash e sa kohë nuk është duke u monitoruar nga asnjë institucion jashtë autoriteteve kontraktuese. Por as monitorimi dhe zbatimi i Ligjit të prokurimit publik nuk është duke u bërë siç duhet, thuhet në raportin mbi përkrahjen e reformimit të prokurimit publik, i cili financohet nga BE-ja dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian.

Në këtë raport, i cili është hartuar nga një konsorcium prej katër firmave ndërkombëtare, po ashtu theksohet se as rolet e tri institucioneve qendrore të prokurimit, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik(KRRPP), Organi Shqyrtues i Prokurimit(OSHP), si dhe Agjencia e Prokurimit Publik(APP), nuk janë shumë qartë të ndara.

Në anën tjetër, ekspertët e projektit të Komisionit Evropian janë befasuar me njohuritë tepër të dobëta rreth procesit të prokurimit që kanë parë te zyrtarët e prokurimit në përgjithësi në Kosovë. Ata kanë thënë qartë në raport se "njohuritë dhe aftësitë e zyrtarëve të prokurimit ishin të dobëta në përgjithësi".

Aty theksohet se ekipi i projektit është përballur me njohuri të dobëta teorike dhe praktike të zyrtarëve të prokurimit, tek të cilët është vërejtur se veç të tjerash ata "janë shumë të dobët edhe në të kuptuarit e Ligjit të prokurimit".

Ekspertët kanë përmendur se zyrtarët e prokurimit në Kosovë kishin huti edhe rreth kritereve, specifikimeve dhe detyrave të tyre punës.

Ekipi i projekti, thuhet në raport, ishte befasuar kur kishte mësuar se me vetëm 10 ditë trajnim mund të certifikohesh si zyrtarë prokurimi në Kosovë.

Ndërsa zyrtarët e prokurimit, të të gjitha niveleve institucionale, citohet të kenë pranuar vetë se standardet e trajnimit, për të cilat janë investuar para të majme, nuk ishin të një niveli mjaft të lartë.

Duke përmendur çështjen e mungesës së një monitorimi të mirëfilltë të zbatimit të kontratave publike, në raport vlerësohet se monitorimi i kryer nga Departamenti i Monitorimit dhe Mbikëqyrjes i KRRPP-së është i mbyllur për kontrollimin e dokumenteve në prokurime tashmë të përfunduara dhe nuk përfshin monitorimin e zbatimit të kontratave.

"Vetëm një përqindje e vogël e prokurimeve të kryera në sektorin publik janë të monitoruar në këtë mënyrë".

Ekziston monitorimi i Ligjit nga auditori i brendshëm i autoritetit kontraktues dhe departamenti i tij monitoron prokurimet aktuale, mirëpo efektshmëria e tyre është e panjohur.

Po ashtu përmendet se nuk ka asnjë monitorim specifik as të legjislacionit dytësor. Rreth kësaj, sipas ekspertëve të projektit, pjesa më e madhe e legjislacionit dytësor mund të bëhet më efektiv vetëm duke u bërë një riorganizim i hartimit të tij. Në raport thuhet qartë se duhet të bëhet "riorganizim e jo thjeshtësim", meqë kjo pjesë e legjislacionit është cilësuar edhe si shumë komplekse.

Duke analizuar punën e KRPP-së, në raport nënvizohet se "ai është institucion i mirëthemeluar që ka kryer punë për më shumë se katër vjet, por ndryshimet e ligjit dhe ndryshimet e fundit në politikë kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në këtë institucion. KRPP-ja nuk e ka më autoritetin e saj të mëparshëm dhe duket që vuan nga një krizë identiteti".

Në anën tjetër, OSHP-ja si organ i ri është vlerësuar se ende është duke e gjetur drejtimin e saj.

"Është vërejtur se ueb-faqja e OSHP-së përmban informata shumë të kufizuara dhe se vendimet e Bordit nuk janë publikuar ende. Kjo është shkelje e mandatit të këtij institucioni", thuhet në këtë raport.

Qëllimi i këtij raporti, theksohet në të, është sigurimi i një administrimi të duhur të fondeve publike, transparencës dhe efektivitetit të shpenzimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të kornizës së prokurimit publik.



Ekipi joformal i "Kohës Ditore" për GjND-në ballafaqon argumentet për pavarësi

# Mbrohen historia dhe ligjshmëria e pavarësisë

**Parimi i "Vetëvendosjes zhdëmtuese", (remedial self-determination), uti possidetis, (zotëruesi i territorit në fund të konfliktit), mungesa e dokumenteve që Kosova ka qenë pjesë legale e Serbisë dhe përparësia e anës historike në anën e Kosovës, shihen si anët e forta të Kosovës para GjND-së nga ekspertët e së drejtës dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të historisë: Marc Weller, Florian Bieber, Noel Malcolm dhe Enver Hasani**

(vijon nga ballina)

### Rasti Burkina Faso – Mali

Studiuesi i Shkencave Politike, profesori Florian Bieber në Universitetin Kent, mendon se Serbia do të bazojë argumentet e veta në kuptimin konvencional të së drejtës ndërkombëtare, e cila përgjithësisht ka marrë një qasje shumë kufizuese të së drejtës së vetëvendosjes së popujve.

"E drejta e vetëvendosjes në këtë kuptim i është dhënë vetëm procesit të dekolonizimit dhe në rastet e shpërbërjes së shteteve", është shprehur Bieber.

Ky mendon se rasti precedent i Burkina Faso – Mali në GjND rreth kontestit shtetëror në mes këtyre dy shteteve do të mund të vlejë edhe në rastin e Kosovës.

"Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë më herët pati vendosur mbi parimin e uti possidetis, në vitin 1986 në kontestin e kufirit në mes Burkina Faso dhe Mali që kufiri në fund të udhëheqjes koloniale të jetë si përfundimtar", është shprehur Bieber.

Sipas Bieberit, ekzistojnë tri strategji për Kosovën: të argumentojë për shkeljen masive të të drejtave të njeriut në vitin 1999 në Kosovë; të argumentojë se në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë ajo ka qenë e ngjashme me republikat e ish-RFSJ-së dhe e ka pasur të drejtën e pavarësisë njëjtë sikurse edhe njësitë e tjera dhe të argumentojë se deklarimi i pavarësisë nuk ishte një aspiratë, por një realitet ekzistues.

"Do të isha i befasuar nëse GjND-ja do të merrte një qëndrim të qartë në favor të këtyre argumenteve. Unë do të kisha pritur se GjND-ja do të marrë një vendim, i cili përgjithësisht askënd nuk do ta bëj të lumtur, mirëpo që esencialisht do të deklarojë se njohja ndërkombëtare e shteteve është çështje e fakteve dhe një çështje më shumë politike sesa e së drejtës ndërkombëtare", shprehet ai.

Autori i librit "Kosova një histori e shkurtër", Noel Malcolm, në një prononcim për "Kohën Ditore", ka thënë se me gjithë faktin që ekzistojnë mjaft argumente historike në favor të Kosovës, GjND-ja do të marrë parasysh më shumë aspektet legale.

"Kjo çështje do të do të vendoset vetëm në bazë të argumenteve të së drejtës ndërkombëtare; megjithëse ekzistojnë argumente të mira historike për pavarësinë e Kosovës", ka thënë Malcolm.

I fundit ka qenë historiani që ka argumentuar thyerjen e mitit serb për krijimin e shtetit të tyre në territorin e Kosovës.

"Historia për serbët fillon në shekullin VII kur ata vendosen në Ballkan dhe më pas në shekullin XIII edhe e pushtojnë, por baza e themelimit të shtetit të tyre ka qenë jashtë Kosovës që dëshmon se 'Kosova nuk është djep i Serbisë'", thotë Malcolm.

### Pa dokument, që e bën Kosovën pjesë legale të Serbisë

Argumenti kryesor i Kosovës para GjND-së, sipas Enver Hasanit, është se Kosova legalisht nuk ka qenë pjesë e Serbisë por e Jugosllavisë, dhe Serbia nuk ka ekzistuar si shtet prej vitit 1918 deri në vitin 1992, kur është shpërbërë Jugosllavia.

"Me rëndësi është që Kosova nuk ka qenë pjesë e Serbisë, sepse Serbia nuk ka ekzistuar si shtet. Serbia nuk ka ekzistuar kurrë de jure e de facto. De jure dhe de facto ka ekzistuar vetëm në momentin kur është njohur Republika e Malit të Zi, atëherë Serbisë i kanë mbetur të drejtat në pjesën e Vojvodinës dhe të Kosovës. Në momentin që Kosova ka shpallur pavarësinë dhe është njohur, Serbia ekziston si shtet, pa Kosovën. Kosova nuk ka qenë kurrë pjesë e Serbisë dhe nuk ka asnjë dokument që e provon këtë", është shprehur ai.

Hasani thotë se Komisioni i Badinterit nuk ia ka mohuar të drejtën Kosovës për formimin e shtetit.

"Badinteri ka treguar se si mund të krijohen shtetet e reja brenda Bashkimit Sovjetik, Jugosllavisë dhe Çekosllovakisë dhe ai e ka dhënë shumë qartë se shtetet brenda këtyre pjesëve mund të krijohen vetëm në bazë të entiteteve territoriale dhe etnike që kanë ekzistuar në vitin 1991. Kosova ka qenë e definuar territorialisht, saktësisht e definuar në vitin 1991. Serbia, me gjithë faktin që ka menduar se po arrit ta zhvendosë komplet strukturën e popullsisë, nuk ka arritur që ta krijojë një gjendje të re faktike", ka thënë ai.

Krijimi i shteteve, sipas tij, është çështje faktike dhe ato nuk krijohen me norma juridike.

Paralelisht me këtë ai mbron deklarimin unilateral të pavarësisë, pjesë kjo e pyetjes së Serbisë në GjND për mendimin këshillëdhënës.

"Asnjëherë shpalljet e pavarësisë nuk janë bilaterale ose multilaterale. Historia e së drejtës ndërkombëtare dhe krijimit të shteteve nuk njeh përveç rastit të Izraelit krijimin e shteteve përmes veprimeve multilaterale. Izraeli është krijuar nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Sigurimit që e ka legalizuar një realitetet që ka qenë. 99,9 për qind të rasteve të krijimit të shteteve janë deklarata unilaterale, të cilat janë oferta të botës për njohje. Kosova deri tash është njohur prej gati 60 shteteve dhe me këtë është dëshmuar se Kosova ka gjetur përkrahjen ndërkombëtare".



**"Kosova duket të jetë rasti i parë i 'vetëvendosjes zhdëmtuese' remedial self-determination) – një e drejtë për vetëvendosje e krijuar në saje të një dëmi të shkaktuar nga qeveria ndaj një grupi që kërkon shkëputjen. Dëme do të mund të jenë shkeljet e të drejtave të njeriut, spastrimi etnik apo përjashtimi në vendimmarrje i grupit për të cilin bëhet fjalë" – Marc Weller**



**"Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë më herët ka vendosur mbi parimin e uti possidetis, në vitin 1986, në kontestin e kufirit në mes Burkina Faso dhe Mali që kufiri në fund të udhëheqjes koloniale të jetë si përfundimtar" - Florian Bieber**



**"Kjo çështje do të vendoset vetëm në bazë të argumenteve të së drejtës ndërkombëtare; megjithëse ekzistojnë argumente të mira historike për pavarësinë e Kosovës" – Noel Malcolm**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, kthehet nga Sllovenia

# Krasniqi e pranon se Tadiqi ka bërë deklaratë politike në Kosovë

**Ai ka thënë se është përgjegjësi e ekzekutivit nëse do të lejojë ndonjë vizitë tjetër të mundshme të presidentit serb në Kosovë**

Prishtinë, 19 prill (KD) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, edhe pse e ka mbrojtur veprimin e kryeministrit Thaçi për lejimin e vizitës në Kosovë të presidentit serb, Boris Tadiq, megjithatë e ka pranuar se Tadiqi ka bërë deklaratë politike gjatë qëndrimit në Deçan.

Ai ka thënë se është përgjegjësi e ekzekutivit nëse do të lejojë ndonjë vizitë tjetër të mundshme të presidentit serb në Kosovë.

Pas qëndrimit të tij në Kongresin e Lëvizjes Evropiane në Slloveni me temën "Organizatat e shoqërisë civile sfidojnë autoritetet publike", Krasniqi ka premtuar se do të krijojnë kushte të veprimit të lirë për shoqërinë civile. Duke e konsideruar shoqërinë civile si shumë të rëndësishme në ndërtimin e shoqërisë demokratike, kryekuvendari Jakup Krasniqi ka premtuar kushte të veprimit të lirë të tyre.

Krasniqi pohoi se kanë marrë mbështetjen e të gjitha shteteve pjesëmarrëse në këtë kongres, përveç të Bosnjë-Hercegovinës.

Sipas tij, ky shtet ka vështirësi ta njohë Kosovën dhe kjo për shkak të mungesës së një konsensusi. Krasniqi ka thënë se presidenti slloven, Danilo Turk, ka vlerësuar lart të arriturat e Kosovës, duke premtuar ndihmë nga shteti i tij në të gjitha planet, në veçanti në integrimin evropian.



**"Me rëndësi është që Kosova nuk ka qenë pjesë e Serbisë, sepse Serbia nuk ka ekzistuar si shtet. Serbia nuk ka ekzistuar kurrë de jure e de facto. De jure dhe de facto ka ekzistuar vetëm në momentin kur është njohur Republika e Malit të Zi, atëherë Serbisë i kanë mbetur të drejtat në pjesën e Vojvodinës dhe të Kosovës" – Enver Hasani**

### Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka filluar fushatën për regjistrimin e anëtarëve të rinj

# Krerët e Qeverisë "zhvendosen" në parti

**Fushata e nisur të dielën nga PDK-ja parashihet të zgjasë deri më 24 maj, ndërsa në këtë periudhë anëtarët e partisë, deputetët, vullnetarët, personalitetet publike dhe civile do të udhëtojnë anekënd vendit për të nxitur anëtarësimin e njerëzve në PDK dhe për të bërë regjistrimin e tyre**

KOHA Ditore *ARBEN ATASHI*

PRISHTINË, 19 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë një "tërheqje taktike" të dielën nga selia në ndërtesën e Qeverisë, në selinë e partisë që drejton (PDK), për të shtuar dhe regjistruar anëtarë dhe simpatizantë të rinj të partisë.

Afrimi i zgjedhjeve lokale e ka detyruar kryeministrin e vendit t'i lërë anash për pak kohë hallet e Qeverisë dhe të merret me hallet e partisë së tij. Nga kafeneja "Syri i kaltër", i shoqëruar nga zëvendëskryeministri, Hajredin Kuçi, dhe nga zyrtarë të tjerë të Qeverisë e të partisë, Thaçi ka shërbyer si mbështetje logjistike për fushatën më të re të PDK-së për regjistrimin e anëtarësisë.

Fushata e nisur të dielën parashihet të zgjasë deri më 24 maj, ndërsa në këtë periudhë anëtarët e PDK-së, deputetët, vullnetarët, personalitetet publike dhe civile, do të udhëtojnë anekënd vendit për të nxitur anëtarësimin e njerëzve në PDK dhe për të bërë regjistrimin e tyre.

"Motoja e këtij projekti është 'Bëhu pjesë e së ardhmes, bashkohu me PDK'", ka bërë të ditur në një konferencë për media zëdhënësi i partisë, Blerand Stavileci.

I pari që të dielën është regjistruar në listat e PDK-së si anëtar i ri i saj ka qenë reperi Genc Prelvukaj, i cili iu ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve të veprojnë si ai, të anëtarësohen në partinë që drejton Qeverinë e vendit.

Zëdhënësi, Blerand Stavileci, ka theksuar se përmbushja e premtimeve ka bërë që qytetarët të kuptojnë se PDK-ja është parti e veprimeve dhe e rezultateve, andaj, sipas tij, për rrjedhojë shumë qytetarë kërkojnë t'i bashkohen PDK-së në mënyrë që të bëhen pjesë e kësaj lëvizjeje për të ardhmen.

"Për t'iu përgjigjur gjithë këtyre kërkesave dhe për të mundësuar që gjithë këta qytetarë të bëhen pjesë e së ardhmes, PDK-ja ka vendosur ta bëjë më të lehtë një gjë të tillë për ata që duan t'i bashkohen asaj në këtë kauzë", ka thënë Stavileci, duke nisur fushatën e regjistrimit.

Ai ka bërë të ditur se njëkohësisht PDK-ja ka nisur edhe emetimin e spoteve televizive për projektin e regjistrimit të anëtarëve, të cilat do të shfaqen nëpër televizionet e Kosovës. Këto spote janë emetuar edhe në konferencën për media.

Të ngjashme me reklamat e KFOR-it, në të cilat paraqiten qytetarë të ndryshëm që përsërisin të njëjtën frazë "Edhe unë jam Kosovë", në spotet e PDK-së përsëritet slogani "Bëhu pjesë e së ardhmes, bashkohu me PDK". Në këto reklama nuk është lënë pa u përmendur edhe kryeministri Thaçi për punën e tij si drejtues i Qeverisë së Kosovës.

Zëdhënësi i PDK-së ka lajmëruar edhe funksionalizimin e faqes zyrtare të PDK-së në internet, e cila ka gati një vit që është jashtë funksionit. Me një dizajn të ri, të ngjashëm me dizajnin e faqes zyrtare të Qeverisë, faqja e PDK-së




në internet përmban pothuajse të njëjtat materiale si edhe faqja e Qeverisë. Fjalimet dhe fotografitë e kryeministrit Hashim Thaçi zënë njësoj hapësirën më të madhe edhe të kësaj faqeje.

Zëdhënësi i PDK-së ka shpalosur edhe një varg lëvdatash për partinë, me rastin e nisjes së fushatës. "PDK-ja është partia më e madhe dhe më unike në Republikën e Kosovës dhe vazhdon të rritet çdo ditë me një ritëm të shpejtë. PDK-ja po rritet sepse ajo përfaqëson ëndrrat dhe shpresat e popullit të Kosovës. Ne i fituam zgjedhjet, ne po e qeverisim vendin tonë, dhe ne po rritemi", ka thënë Blerand Stavileci.

"Partia jonë është e përkushtuar të ndërtojë një Kosovë të fortë, një vend stabil për të gjithë. Nën udhëheqjen e kryeministrit Hashim Thaçi, PDK-ja ka vazhduar ta çojë përpara vendin tonë dhe t'i prijë zhvillimit dhe integrimit të tij me Evropën dhe Perëndimin edhe gjatë këtyre kohërave sfiduese për Kosovën", ka shtuar ai mes të tjerash.

Përderisa aktivistët e partisë janë përgatitur për fushatën më të re për regjistrimin e anëtarësisë, kryeministri Hashim Thaçi ka qarkulluar në relacionin nga selia e partisë në kafenenë afër saj dhe anasjelltas, duke i shtrënguar duart me simpatizantët dhe duke iu ofruar mbështetje. Ai ua ka bërë për hair zyrtarëve të partisë së tij nisjen e fushatës në sheshin "Nëna Tereze". Nisja është shoqëruar me muzikë nga altoparlantë të vendosur pranë bustit të Nënës Tereze, ku qytetarë të ndryshëm kanë filluar regjistrimin si anëtarë të rinj të PDK-së.

### PDK-ja lavdërohet për mijëra vende të punës

Zyrtarët e PDK-së janë lavdëruar të dielën se Qeveria e drejtuar nga kjo parti ka krijuar mijëra vende të reja të punës, gjë që iu është dukur e pabesueshme gazetarëve të pranishëm në konferencën për media.

"Me qeverisjen e udhëhequr nga PDK-ja kemi krijuar mijëra vende të reja të punës, kemi ndërtuar qindra kilometra rrugë, kemi ndërtuar dhjetëra shkolla të reja dhe kështu jemi duke ndërtuar një ardhmëri të mirëfilltë të Kosovës", ka thënë zëdhënësi i PDK-së, Blerand Stavileci. Ndërkohë, përfaqësuesit e mediave kanë kërkuar sqarime se ku janë krijuar gjithë ato vende të punës, pasi Kosova vazhdon të jetë një ndër vendet me numrin më të lartë të papunësisë. Mirëpo, përgjigjja e dhënë pa ndonjë shifër konkrete nuk i ka bindur të interesuarit.

"Të gjitha punët që janë bërë në të gjithë sektorët janë përcjellë me një numër të madh të hapjes së vendeve të reja të punës, si projektet e ndërtimit të rrugëve, të shkollave etj. Punësimi ka qenë një premtim elektoral dhe ne në masë të madhe e kemi përmbushur", është përgjigjur zëdhënësi Stavileci.

### Në Teatrin Kombëtar u shënua Dita e Veteranëve të Luftës së Koshares

# Sejdiu: Me gjithë sfidat, misioni i heronjve është përmbushur

**Presidenti Fatmir Sejdiu ka theksuar se dhjetë vjet pas Betejës së Koshares Republika e Kosovës ka hyrë në vitin e dytë të pavarësisë së saj, duke i ndërtuar me kujdes të gjithë mekanizmat që e garantojnë funksionalitetin e shtetit dhe sigurinë e qytetarëve**

PRISHTINË, 19 PRILL - Presidenti i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu, ka konstatuar të dielën se me gjithë sfidat e shumta që vendi ka pasur në këtë dhjetëvjetësh, pas përfundimit të luftës, misioni për të cilin ranë heronjtë dhe dëshmorët është përmbushur.

Këtë konstatim ai e ka bërë në një akademi përkujtimore në Teatrin Kombëtar, të organizuar në kuadër të manifestimit "Ditët e Shqipes", në përvjetorin e rënies së heroit Sali Çekaj, që shënohet edhe si Ditë e Veteranëve të Luftës së Koshares.

Akademia është mbajtur nën patronazhin e presidentit, ndërsa të pranishëm kanë qenë personalitete të ndryshme, ndër të cilët edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, dhe ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Islam Lauka.

"Me krenari mund të themi se misioni për të cilin ranë heronjtë e Koshares, Agim Ramadani e Sali Çekaj, dhe heronjtë e tjerë të luftës së fundit çlirimtare të Kosovës, si Adem Jashari, Zahir Pajaziti e shumë të tjerë, është përmbushur", ka thënë presidenti Sejdiu.

Ai nuk ka harruar që me këtë rast të përmendë edhe ish-presidentin Rugova.

"Është përmbushur vizioni politik i presidentit Rugova: Kosova është vend i pavarur, sovran dhe demokratik, shtet i të gjithë qytetarëve të saj të barabartë, me synime krejtësisht të qarta për të ardhmen - integrimin sa më të shpejtë në strukturat euroatlantike", është shprehur i pari i vendit.

Presidenti Sejdiu ka vlerësuar se prijësit e Betejës së Koshares, Sali Çekaj dhe Agim Ramadani, kanë hyrë në përjetësinë e kombit duke e shembur njëherë e përgjithmonë murin e zi shqiptaro-shqiptar.

Fitorja në Betejën e Koshares, sipas tij, ishte pa dyshim njëra ndër pikat më të shndritshme të luftës për liri gjatë viteve 1998-'99, pasi shënoi fillimin e fundit të pushtimit gati njëshekullor nga Serbia, por njëkohësisht edhe sinjalin e qartë të rilindjes së Kosovës.

Derisa ka folur fjalë miradije për dy heronjtë, Sali Çekaj e Agim Ramadani, presidenti i vendit i ka cilësuar ata si "burra të dheut", duke vlerësuar se njerëzit rrallë e kanë privilegjin të kenë virtyte të tilla, siç i kishin këta dy luftëtarë të Kosovës.

Mes të tjerash, presidenti Fatmir Sejdiu ka theksuar se dhjetë vjet pas Betejës së Koshares Republika e Kosovës ka hyrë në vitin e dytë të pavarësisë së saj, duke i ndërtuar me kujdes të gjithë mekanizmat që e garantojnë funksionalitetin e shtetit dhe sigurinë e qytetarëve.

"Kemi krijuar Forcën e Sigurisë së Kosovës, e cila do të formësohet sipas standardeve më të larta të NATO-s, kemi krijuar Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës dhe Këshillin Kombëtar të Sigurisë, duke e rrumbullakuar kështu procesin e ndërtimit të institucioneve më të larta për sigurinë e vendit", është shprehur ai.

Po ashtu, presidenti ka rikujtuar se Kosovën e kanë njohur 57 vende të botës, ndërsa ka thënë se priten njohje të reja, për çka ka pohuar se ka marrë sinjale konkrete nga vende të ndryshme të botës.

Ai ka përmendur edhe deponimin e argumenteve të Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, për të mbrojtur legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë një vit më parë. "Duke besuar plotësisht në përgjegjësinë e këtij institucioni të lartë ndërkombëtar, ne besojmë se Kosova do ta tejkalojë me sukses edhe këtë sfidë të vogël, në mënyrë që të hiqet përfundimisht hezitimi që kanë disa vende për ta njohur pavarësinë e shtetit tonë", është shprehur Sejdiu.

Më këtë rast presidenti Sejdiu u ka ndarë familjarëve të heronjve Sali Çekaj dhe Agim Ramadani mirënjohjen më të lartë të vendit, urdhrin "Hero i Kosovës", me të cilin ata i kishte nderuar ish-presidenti Ibrahim Rugova.

Ndërkohë zëvendësministri i Drejtësisë, Arsim Janova, e ka ndarë "Çmimin e Drejtësisë" për heroin Sali Çekaj, në nderim në kontributit të tij politik dhe juridik gjatë rezistencës në vitet e nëntëdhjeta.

Për jetën e Sali Çekajt ka folur edhe Sylë Bruqi, përfaqësues i brigadës 138 "Agim Ramadani", i cili ka lexuar një historik të heroit, duke bërë thirrje që të qartësohet kontributi i secilit në luftë dhe të njihen meritat.

Ai ka thënë se në vitin 1991, një grup prej 30 anëtarësh nën komandën e Sali Çekajt, në mesin e të cilëve kishin qenë edhe Adem Jashari, Zahir Pajaziti etj., nën përkujdesjen e sigurimit të shtetit shqiptar kishin sjellë në Kosovë një sasi të madhe armatimi. Sipas Bruqit, kjo ka qenë bërthama e parë e UÇK-së.

"Është koha që meritat e të gjithëve të thuhen pa ekuivokë dhe pa paragjykime. Të shpresojmë se gjërat do të qartësohen, sepse të gjithë i kemi borxh këtij njeriu", është shprehur ai.

Sali Çekaj është lindur në fshatin Broliq të Deçanit, në vitin 1956, ndërsa ka rënë në ballë të frontit më 19 prill 1999, te Rrasa e Koshares. Ai ka qenë i angazhuar në dy fronte, në atë ushtarak dhe diplomatik, ndërsa gjatë luftës i ka takuar Forcave të Armatosura të Kosovës (FARK).

*A. A.*


AltaVia Travel telefono 543 543

www.altaviatravel.com/ONLINE

Rezervo ONLINE, FLUTURO më LIRË
dhe mbani rezervimet pa pagesë 48 orë

Shembull:
Prishtinë - Zagreb prej: EUR 179
Prishtinë - Stanboll prej: EUR 182
Prishtinë - Londër prej: EUR 282
Selanik - Dusseldorf prej: EUR 256
Shkup - Prage prej: EUR 292

Çmimet janë më të gjitha shërbimet dhe taksat e aeroportit

**Gjatë një mandati shpërfillen procedurat me rastin e përzgjedhjes së stafit akademik në Universitetin e Prishtinës**

# Recensione të pavlera

**Me rastin e përzgjedhjes së stafit akademik, në shumë raste anëtarët e komisioneve recensuese nuk nxjerrin përfundime konform asaj që parasheh statuti, e në anën tjetër senatorët shpeshherë anashkalojnë statutin tek përcaktohen për zgjedhjen si staf akademik të kandidatëve, për të cilët komisionet recensuese nuk japin notë kaluese**

*BESNIK KRASNIQI*

PRISHTINË, 19 PRILL – Statuti i Universitetit të Prishtinës shpesh është shpërfillur, me rastin e zgjedhjes së personelit akademik nga anëtarët e Senatit.

Sa herë që të shpallet konkurs për personel, ngrihen komisione recensuese prej fakulteteve, vlerësimet e anëtarëve të të cilave komisione pak merren për bazë nga senatorët. Në shumë raste këta anëtarë nuk nxjerrin përfundime konform asaj që parasheh statuti, e në anën tjetër senatorët shpeshherë anashkalojnë statutin tek përcaktohen për zgjedhjen si staf akademik të kandidatëve, për të cilët komisionet recensuese nuk japin notë kaluese.

Kjo ndodh, ani pse neni 180 i Statutit thotë se "i gjithë personeli akademik do të emërohet nga rektori sipas vendimit të Senatit, i bazuar në propozimin e këshillit të njësisë akademike" dhe se "të gjitha emërimet bëhen pasi t'i shqyrtojë fletëparaqitjet komisioni vlerësues (recensues) i formuar nga këshilli i njësisë akademike".

Sedat Kuçi, njëri nga senatorët e UP-së, pranon se Senati shpeshherë ka shpërfillur statutin, meqë nuk ka kthyer prapa në njësitë akademike propozimet për kandidatët që duheshin bërë anëtarë të stafit akademik, por ka vendosur të zgjedhë për personel kandidatët që nuk kanë marrë vlerësim pozitiv në fakultete.

"Të them sinqerisht, kam qenë kundër kësaj dukurie. Kam qenë për t'u respektuar procedura e rregullt. Pra, që emërimi të bëhet sipas vendimit të Senatit, i cili do të bazohej në propozimin e Këshillit të fakultetit", ka thënë Kuçi. "Faktikisht, nuk është respektuar procedura ligjore".

Mandatarët aktualë që përbëjnë Senatin, kryesisht kanë vendosur ashtu siç ka propozuar Komisioni shkencor që vepron në nivel universiteti. Sedat Kuçi pranon se Senati, gati në të gjitha rastet, ka vendosur, ashtu siç ka propozuar ky komision.

"Lirisht mund të themi se pa përjashtimisht është respektuar mendimi i këtij komisioni", ka thënë ky senator.

## Recensione të kundërligjshme

Enver Hasani, rektori i UP-së, pranon se kjo ka ndodhur dhe jep arsyet pse është vepruar kësisoj. Sipas tij, po të bëhet një hulumtim, mesatarisht del se në 70 për qind të rasteve raportet e komisioneve recensuese janë shkruar në mënyrë të kundërligjshme dhe se propozimet e dhëna për kandidatët nuk janë përputhur me dispozitat e statutit dhe standardet evropiane të arsimit të lartë.

"Ka raste tragjikomike kur iu kanë shkruar (recensione pozitive) për asistentë njerëzve që kanë pasur 50-60 vjet, ka raste kur pensionistit i kanë shkruar (recension pozitiv) që të zgjidhet asistent ose profesor, dhe prandaj është Komisioni për studime dhe Senati që, sipas ligjit, janë vendimmarrësit e fundit", ka thënë rektori Hasani.

Ani pse Statuti thotë që i gjithë personeli akademik do të emërohet nga rektori, sipas vendimit të Senatit, i bazuar në propozimin e këshillit të njësisë akademike, rektori ka shprehur mendimin se nuk është vepruar gabimisht kur është vendosur që propozimet e këshillave të fakulteteve të mos kthehen pas, për t'u dhënë atyre edhe një shans propozimi.

"Po të bënim ne ashtu do të bllokoheshim fare, sepse për tri vite të mandatit ndoshta nuk do të mund të zgjidhej askush. Kthimi ka qenë një praktikë e eliminimit në mënyrë administrative të kundërshtarëve akademikë, po i quaj, eliminimit administrativ të konkurrencës dhe të dijes dhe kjo i ka ngulfatur reformat në të kaluarën", ka thënë rektori Hasani.

Mandatarët e fundit të menaxhmentit të UP-së janë treguar dorështrenjtë për të dhënë thirrjen më të lartë, siç është ajo e profesorit të rregullt. Sipas Statutit, që dikush të marrë këtë thirrje duhet të ketë, ndër të tjera, gradën e doktorit të shkencës ose ekuivalent me të si dhe të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me: një numër të rëndësishëm të monografive, teksteve mësimore dhe publikimeve të rishqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me më së paku 5 punime kryesore të publikuara dhe të shqyrtuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare.

## Standardet evropiane

"Janë zgjedhur dy ose tre profesorë të rregullt prejse unë jam rektor. Unë i kam respektuar standardet perëndimore, sepse as në Perëndim nuk zgjidhen siç janë zgjedhur këtu në të kaluarën", ka thënë rektori. "Mendoj se duhet vazhduar me këtë praktikë, ku për t'u zgjedhur profesor i rregullt duhet të kesh forcë shumë të madhe intelektuale".

Ndërkaq, në thirrjen më të ulët, siç është ajo e asistentit të ri, janë zgjedhur qindra në këto tri vjet. Me nenin 186 përcaktohet se për titullin e asistentit të ri kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte: të ketë të përfunduar me sukses studimet themelore, të ketë notën mesatare gjatë studimeve jo më pak se 8, të jetë nën moshën 28-vjeçare (respektivisht 30 në Fakultetin e Mjekësisë duke i dhënë prioritet specialistit) kur emërohet për herë të parë, të jetë nën moshën 32-vjeçare kur punësohet për herë të parë nëse ka mbaruar studimet postdiplomike për master. Ndërkaq, neni 101 saktëson se Universiteti ofron këto lloje të studimeve themelore akademike dhe postdiplomike: studimet themelore (studimet bachelor) dhe studimet postdiplomike (studimet master dhe studimet e doktoraturës).

Pavarësisht kësaj, Senati shumë kandidatë që kishin të përfunduar studimet bachelor i ka eliminuar, por kishte edhe disa raste që janë zgjedhur në thirrjen e asistentit të ri, ani pse kandidatët kishin vetëm studimet themelore.

Ani pse është vepruar kështu, rektori Enver Hasani konsideron se nuk është shpërfillur statuti.

"Nuk është shpërfillur, por vetëm është interpretuar në mënyrë ekstensive. Ajo dispozitë e statutit është kundër standardeve evropiane dhe kundër ligjeve të tjera mbi arsimin e mesëm dhe të lartë në Kosovë, sepse me atë diplomë juristi nuk mund të punojë as në shkollë dhe as në gjykatë, e lëre më në universitet", ka thënë ai.

Për senatorin Sedat Kuçi, kandidatët për asistent të rinj që kishin diplomën vetëm të nivelit bachelor të studimeve nuk do të duhej të pengoheshin të zgjidheshin në këtë thirrje.

"Ka disa raste që me bachelor janë pranuar. Varësisht nga kandidati është bërë edhe zgjedhja", ka thënë senatori Kuçi. "Unë pajtohem me atë se ka kute të dyfishta me rastin e zgjedhjes së asistentëve të rinj".



**Statuti i Universitetit të Prishtinës shpesh është shpërfillur, me rastin e zgjedhjes së personelit akademik nga anëtarët e Senatit**

# Maqedonia qetë rrumbullakoi rrethin e dytë zgjedhor në pesë komuna

SHKUP, 19 PRILL - Në Maqedoni është zhvilluar të dielën raundi i dytë i votimeve për zgjedhjet vendore në pesë komuna, kryesisht rurale. Nga 88 vendvotime të numëruara nga gjithsej 123 në pesë komuna në Maqedoni, jehona e votuesve deri në orën 16:00 sipas Komisionit shtetëror zgjedhor (KSHZ) ka qenë në 44,38 për qind.

Kryetari i KSHZ-së, Aleksandër Novakovski, ka theksuar se në tre vendvotime në Komunën e Çuçer-Sandevës procesi zgjedhor ka vazhduar deri në orën 20:00 për shkak se materiali zgjedhor kishin arritur me 1 orë vonesë.

"Në Dollnen dalja deri në orë 16:00 ka qenë 49,48 për qind, Zelenikovë 61,14 për qind, Mavrovë-Rostushë 31,95 për qind, Studeniçan 39,05 për qind dhe Çuçer Sandevë 57,18 për qind. Deri në këtë moment KSHZ-ja nuk ka pranuar asnjë parregullsi zyrtare, do të thotë se parregullsi nuk janë shënuar në të gjitha vendvotimet në këto 5 komuna", ka theksuar kryetari i KSHZ-së, Aleksandar Novakovski.

VMRO-DPMNE ka garuar me Bashkimin Demokratik për Integrim (BDI), partnerin e saj në qeveri, në Dollneni dhe Mavrovë-Rostushë, ndërsa në Zelenikovë, VMRO –DPMNE ishte në balotazh me një kandidat të pavarur.

BDI-ja në balotazh ishte me kandidatin e partisë për ardhmëri evropiane në Studeniçan, ndërsa në Çuçer Sandev në balotazh ishin një kandidat i pavarur dhe kandidati nga Partia Radikale Serbe.

Në zgjedhjet vendore, përgjithësisht, numrin më të madh të komunave e ka fituar VMRO-DPMNE-ja me 54 komuna dhe qytetin e Shkupit, BDI-ja me 13 komuna, LSDM-ja me 7, PDSH-ja dhe DR-ja kanë marrë nga një komunë, 2 komuna kandidatë të pavarur dhe nga një komunë Lidhja e Romëve dhe Partia Demokratike e Turqve.

*F. B.*



Konferencë shtypi e socialdemokratëve

# PSD-ja ua ndjell Sejdiut e Thaçit vizitën në Preshevë për Fitër Bajram

**"Ne mendojmë që përgjigjja e institucioneve tona ndaj kërkesës së Tadiqit do të duhej të ishte po, por...", vlerëson zëdhënësi i PSD-së**

PRISHTINË, 19 PRILL – "Presim që Bajramin e parë kryeministri apo presidenti ta falin në Preshevë", këtë qëndrim e ka shfaqur Partia Socialdemokrate e Kosovës, në konferencën për gazetarë të së dielës, duke kërkuar nga Fatmir Sejdiu dhe Hashim Thaçi njëjtësi të veprimeve me kryetarin serb Boris Tadiq, i cili gjatë ditës së premte ka qëndruar për vizitë në Manastirin e Deçanit.

"Shpreh keqardhje për pozicionin e institucioneve kosovare, për aftësinë, zotësinë dhe kapacitetet e tyre për të menaxhuar sfida të tilla, siç ishte vizita e Boris Tadiqit", ka thënë zëdhënësi i PSD-së, Gëzim Kasapolli, në konferencën e rregullt për shtyp të këtij subjekti politik.

Duke treguar se vizita e Tadiqit në Kosovë ka ndikuar edhe në skenarin e tyre, ku për sot ata kishin planifikuar të merrnin në shqyrtim krejt diçka tjetër, Kasapolli ka thënë se vizita e Tadiqit në Kosovë ishte edhe një dëshmi e moskoordinimit të institucioneve tona dhe politikës nënshtruese me qëllim të ruajtjes së pozitave aktuale pavarësisht nga interesat shtetërore të Kosovës.

"Ne mendojmë që përgjigjja e institucioneve tona ndaj kërkesës së Tadiqit do të duhej të ishte po, por...", ka theksuar ai, duke shpalosur variantin e subjektit të tij, se si do të duhej ta administronin institucionet e Kosovës një situatë të tillë.

"Pse po?", ka pyetur Kasapolli, për të vazhduar pastaj: "Sepse ne edhe në Pakon e Ahtisarit edhe me qëndrimet tona të proklamuara të politikës së fqinjësisë së mirë, e kemi pranuar dhe e pranojmë të drejtën e Serbisë për t'u kujdesur për pozicionin, gjendjen dhe vlerat e komunitetit serbë që jeton në Kosovë dhe në shtetet e tjera jashtë Serbisë".



**"Shpreh keqardhje për pozicionin e institucioneve kosovare, për aftësinë, zotësinë dhe kapacitetet e tyre për të menaxhuar sfida të tilla, siç ishte vizita e Boris Tadiqit", ka thënë zëdhënësi i PSD-së, Gëzim Kasapolli, në konferencën e rregullt për shtyp të këtij subjekti politik**

Zëdhënësi i PSD-së ka deklaruar se socialdemokratët kosovarë mendojnë që institucionet kosovare kanë dështuar edhe njëherë që ta bindin kryetarin serb Tadiq, të tjerët dhe veten se Kosova është shtet, dhe se Tadiqi duhet t'i përfillë kërkesat e shtetit fqinj, të cilin ai e viziton. Sipas Kasapollit, institucionet e Kosovës kanë dështuar në disa pika në raport me sendërtimin e vizitës së të parit serb këtë të premte në Deçan.

"Edhe pse kërkesa është bërë në zyrën e Unionit Evropian, përgjigjja është dashur të jepet me shkrim, me vulën e Republikës së Kosovës dhe me kushte dhe rregulla, të cilat duhet të përfillen", është shprehur ai.

Sipas Kasapollit, organizimin e vizitës është dashur ta bëjnë institucionet kosovare, sepse, siç ka thënë ai, "ne shqiptarët e kemi traditë që pasi ta lejojmë dikë të na hyjë në oborr, ne nuk e prejmë në besë më pas".

Kasapolli mandej ka kujtuar se presidenti i Serbisë, gjatë vizitës në Kosovë, është dashur të shoqërohej nga përfaqësuesit legjitimë të serbëve në Kosovë. Duke u shkoqitur veçanërisht tek kushtet që është dashur t'i vihen liderit serb, zëdhënësi i PSD-së ka theksuar se "presidenti apo kryeministri duhet të kishin kushtëzuar presidentin Tadiq që edhe ata të shkojnë në Manastirin e Deçanit dhe në Graçanicë dhe t'u urojnë festat ortodokse ashtu si edhe ato islame apo katolike".

Kasapolli ka treguar se socialdemokratët kosovarë vlerësojnë të nevojshëm konsultimin me përfaqësuesit ndërkombëtar në Kosovë, por njëkohësisht e konsiderojnë të domosdoshëm edhe konsultimin me faktorin vendor.

"Ishte ky rast i mirë për t'i aktivizuar faktorët vendimmarrës dhe politikëbërës në Kosovë, por fatkeqësisht edhe ky rast u shndërrua në rast të humbur", është ankuar ai.

Duke pyetur "pse nuk u mblodh Këshilli Nacional i Sigurisë, i cili është i thirrur që të definojë dhe t'i mbrojë interesat kombëtare?", "pse Ministria e Jashtme mbeti absolutisht e papërfillur në këtë rast të vizitës së një presidenti të një vendi fqinj?" dhe "pse nuk u konsultua komisioni parlamentar për siguri apo ai për politikë të jashtme?", Kasapolli është shprehur se ka qenë një rast për ta afirmuar shtetin e Kosovës, për t'i aktivizuar dhe ushtruar mekanizmat vendimmarrës dhe politikëbërës të Kosovës.

"Në fakt po ndodh e kundërta, Tadiqi erdhi, injoroi institucionet tona, injoroi realitetin në Kosovë dhe e bëri këtë vizitë denigruese për ne", ka nënvizuar ai.

Duke u ndalur në diskutim te kisha, Kasapolli është shprehur se socialdemokratët kosovarë mendojnë që ka ardhur koha, siç ka thënë ai, e fundit, që të fillojë ndarja e Kishës ortodokse serbe dhe formimi i Kishës ortodokse të Kosovës.

*Uran Krasniqi*

# Lëvizja për Bashkim bëhet me Lëvizje Rinore për Bashkim

PRISHTINË, 19 PRILL – Pesëmbëdhjetë të rinj kanë fituar besimin e anëtarëve të Kryesisë së Lëvizjes Rinore për Bashkim,trup ky që do të funksionojë në kuadër të Partisë Lëvizja për Bashkim.

Fitor Murati, deri tani udhëheqës i Grupit Nismëtar të të rinjve të kësaj partie, ka thënë për gazetën se kryetari dhe kryesia janë lënë që të zgjidhen dy javë më vonë.

Afro 50 të rinj ishin mbledhur të dielën te hotel "Victory" në Prishtinë, për të marrë pjesë në themelimin e Lëvizjes Rinore për Bashkim.

Nënkryetari i Lëvizjes për Bashkim, Raif Qela, u ka uruar të rinjve punë të mbarë në, siç ka thënë ai, "vënien e themeleve të një organizmi që synon t'ia çelë vetes dhe kombit rrugën e ardhmërisë".

"Ju 'të bijtë e shekullit të ri', siç do të thoshte Migjeni, jam shumë i bindur se do të bëni epokë: me vrullin tuaj rinor, me dijen dhe zellin tuaj", u ka thënë Qela të rinjve, të cilët po merrnin pjesë në hapjen e Kuvendit për të zgjedhur drejtuesit e "trupit" që e posedojnë edhe partitë e tjera.

Qela i ka porositur të rinjtë se atdhetar i mirë mund të jetë ai, i cili paraprakisht është njeri i mirë.

"Duke i respektuar shumë të rënët për liri, duke qenë fort të ndërgjegjshëm për veprat e tyre madhore, ne megjithatë duhet të betohemi më shumë në djepa sesa në varre, siç thotë një shok dhe bashkëveprimtar i yni. Sepse edhe vetë dëshmorët e kanë bërë sakrificën e tyre për brezat që vijnë", ka nënvizuar numri dy i Partisë Lëvizja për Bashkim, pa precizuar më shumë se për cilin shok dhe bashkëveprimtar e ka parafrazuar.

Qela e ka vlerësuar me notë pozitive edhe punën e deritanishme të Grupit Nismëtar të lëvizjes që po konstituohej tani, duke thënë se "kontributi i juaj i gjertanishëm, sa do që në shikim të parë duket modest, është mjaft i madh".

"Në kohën kur krrokëritjet për dofarë idealesh të pavarësisë që na paskëshin qenë ideale tonat shekulloren i shqyejnë veshët, ju e përhapni idealin e vërtetë, idealin dhe aspiratën e të gjithë brezave të shqiptarëve: bashkimin e krejt kombit në një shtet të përbashkët", u ka thënë Qela të rinjve, që tani e tutje do të operojnë nën ombrellën Lëvizja Rinore për Bashkim.

Për përfaqësuesin e deritanishëm të Grupit Nismëtar të të rinjve të Partia Lëvizja për Bashkim, Fitor Murati, iniciativa e formimit të grupit që ai e kishte drejtuar gjer tani kishte lindur krejt natyrshëm.

"Ne, një grup të rinjsh, pavarësisht nga jeta e përditshme, asnjëherë nuk na iku nga mendja ajo se çka jemi dhe se çka duhet të bënim që të lartësojmë atë se çka jemi", është shprehur para të pranishmeve i riu Murati.

Ai ka treguar edhe për disa nga aksionet që ka kryer grupi të cilin e ka udhëhequr, duke përmendur atë të 28 nëntorit të vitit të kaluar, kur para dyerve të Qeverisë së Kosovës kishin vendosur pllakatin që kërkonte që 28 nëntori të bëhej festë zyrtare edhe në Kosovë, ciklin e aksioneve "Presheva është Kosovë!", "Mitrovicë, Serbia jashtë!", "Kosova është Shqipëri" etj.

*U. K.*

Edhe Partia e Drejtësisë reagon ndaj vizitës së presidentit serb në Kosovë

# PD: Deklarata e Tadiqit - luftë e pashpallur me Kosovën

**"Deklarata politike e kryetarit serb, edhe me rastin e një feste fetare, dëshmon qartë se Serbia është në gjendje lufte të pashpallur, edhe pse ndoshta jo me mjete ushtarake me Republikën e Kosovës", ka thënë Agani**

KOHA Ditore *VALON MALOKU*

PRISHTINË, 19 PRILL - Partia e Drejtësisë ka vlerësuar të dielën se deklarata e presidentit të Serbisë, Boris Tadiq, e dhënë para disa dite në Manastirin e Deçanit, në Kosovë , ka shkaktuar ndjenja shumë të hidhura në mesin e qytetarëve të Kosovës, për faktin se sipas PD-së kjo deklaratë është dhënë pikërisht në dhjetëvjetorin e përkujtimit të mijëra të masakruarve dhe të vrarëve shqiptarë nga shteti serb, krime këto për të cilat asnjëherë nuk është kërkuar falje.

Kreu i PD-së, Ferid Agani, ka theksuar në konferencën e rregullt për gazetarë se deklarata e presidentit serb dhënë me rastin e vizitës së tij me motive "fetare" në Deçan, njëkohësisht ka bërë të ditur se lufta në mes Kosovës dhe Serbisë nuk ka pushuar, por tashmë kjo luftë vazhdon në një formë dhe mënyrë tjetër.

"Deklarata politike e kryetarit serb, edhe me rastin e një feste fetare, dëshmon qartë se Serbia është në gjendje lufte të pashpallur, edhe pse ndoshta jo me mjete ushtarake me Republikën e Kosovës", ka thënë Agani.

Ai ka shprehur mirëkuptimin e partisë së tij në lidhje me qëndrimin e kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, për dhënien e lejes presidentit serb për vizitën me karakter "fetar" në Kosovë. Agani ka shprehur mendimin se të njëjtën gjë duhet ta praktikojnë edhe autoritetet e serbe, në qoftë se ndonjëri nga udhëheqësit e Kosovës do të qëndronte për vizitë në pjesët e Kosovës Lindore.

"Partia e Drejtësisë pret që presidenti ose kryeministri i Kosovës do të kërkojnë nga miqtë tanë ndërkombëtarë që në frymën e Planit të Ahtisarit, në pajtim të plotë me konventat ndërkombëtare për liritë fetare, dhe në interes të marrëdhënieve fqinjësore, t'ua mundësojnë edhe atyre vizitën në kuvendet komunale dhe në këshillat e Bashkësisë Islame të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjes, për shembull me rastin e Festës së Bajramit", ka theksuar Agani.

Sipas tij, në këtë mënyrë udhëheqja kosovare do të dalë nga defanziva e skajshme politike në relacion me Serbinë, duke përmbushur obligimin shtetëror, kombëtar dhe moral, që të interesohet për komunitetin shqiptar në Republikën e Serbisë. Agani ka vlerësuar se me një veprim të tillë, bashkësia ndërkombëtare do t'ia dëshmonte popullit shqiptar të Kosovës se respekton parimet e barazisë dhe reciprocitetit që janë parime themelore në marrëdhëniet ndërmjet shteteve sovrane.

"Ky kredit politik i fituar në një partneritet konstruktiv me përfaqësues të bashkësisë evropiane dhe SHBA-së duhet të shndërrohet në vlerë konkrete për qytetarët e Kosovës dhe për zhvillimet pozitive në vendin tonë, në të kundërtën e gjithë kjo do të duket edhe si një episod i një subjektiviteti politik dhe mungese të një kreativiteti politik dhe një veprimi energjik politik në një situatë shumë delikate", ka thënë ai.

Partia e Drejtësisë, sipas Aganit, pret nga kryeministri i Kosovës që me tërë potencialin e tij 'patriotik', me mbështetjen e madhe edhe të Bashkimit Evropian dhe SHBA-së, të ndërmarrë masat për zhbërjen e plotë të strukturave jokushtetuese të shtetit serb në Kosovë, zbardhjen e fatit të mijëra të pagjeturve në Kosovë, ndërprerjen e krimit të organizuar, ekonomik dhe politik në veriun e Kosovës, si dhe ndërprerjen e shantazhimit të Serbisë për mallrat e prodhuara në Kosovë, në kundërshtim të plotë me marrëveshjen e CEFTA.

**Mënyra e komunikimit mes PDK-së dhe AAK-së kujton kohën e pasluftës në Kosovë**

# Vokabulari tensionues PDK-AAK

**PDK-ja dhe AAK-ja e fajësojnë njëra-tjetrën si iniciuese të fjalorit të vrazhdë në komunikimin e ndërsjellë, ndërkaq partitë e tjera ndonëse e gjykojnë një mënyrë të tillë komunikimi vlerësojnë se ai nuk mund të prodhojë destabilitet në Kosovën aktuale**

PDK

ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS
ALLIANCE FOR THE FUTURE OF KOSOVA

Përfaqësuesit e PDK-së dhe të AAK-së ia hedhin fajin njëri-tjetrit për vokabularin e ashpër që aplikojnë

KOHA Ditore *Rexhep Krasniqi*

Prishtinë, 19 prill – Rrebeshe akuzash nga lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, drejt qeverisë Thaçi mbushin këto ditë storiet televizive dhe ballinat e gazetave kosovare. Pasojnë revanshet e vartësve të kryeministrit Thaçi e ndonjëherë edhe të vetë atij plot ironi e injorim karshi rivalit kryesor politik.

Kaloi më se një vit i institucioneve të reja dhe Hashim Thaçi e Ramush Haradinaj nuk arritën të ulen sy më sy përballë njëri-tjetrit qoftë edhe për kurtuazi para publikut. Këto ua kujtojnë njerëzve animozitetet në Kosovën e pasluftës mes LDK-së dhe PDK-së.

"Atëherë ishte më ndryshe, se përballë ishin një parti e luftës dhe një tjetër e paqes, ndërkaq tash kemi të bëjmë me dy parti të luftës, dhe këtu është pak më ndryshe", thoshte një bukëpjekës prishtinas të enjten derisa po e shikonte ballinën e një gazete kosovare me akuzat e Haradinajt se qeveria Thaçi u ngjet vendeve të Lindjes dhe me injorimin e zv.kryeministrit Kuçi që shprehej se s'kishte kohë të merrej me Haradinajn.

Përfaqësuesit e PDK-së dhe të AAK-së ia hedhim fajin njëra-tjetrës për vokabularin e ashpër që aplikojnë. Për zëdhënësin e PDK-së, Blerand Stavileci, edhe nëse bëhen "copë e grimë" me fjalë liderët partiakë, ato s'mund të prodhojnë destabilitet politik.

"Nuk mendoj se vokabulari politik mund të prodhojë destabilitet, janë thjesht fjalë apo deklarata në gjendje afektive, nuk mund të ketë telashe për shkak të një fjalori të tillë. Njerëzit i shohin dhe i kuptojnë deklarimet e pabaza dhe nuk i përfillin", ka shfaqur bindjen e tij ai. "Nuk e kanë efektin fjalët e liderit të AAK-së, Haradinaj, sepse puna jonë e dëshmon të kundërtën e fjalëve të tij. Edhe sondazhet e pavarura janë në favor të punës sonë dhe kundër fjalëve të Haradinajt".

Ai ka theksuar se partia e tij "aplikon një fjalor të zgjedhur me kujdes, jokërcënues, jodenigrues, joprovokativ siç e përdorin të tjerët".

"Por çështja është se këto janë thjesht fjalë dhe nuk e besoj se ato mund ta tensionojnë situatën. Me rëndësi është se në Kosovë po funksionon demokracia. Mendoj se gjithçka po shkon brenda kornizave të demokracisë", është shprehur zëdhënësi i partisë më të madhe në Kosovë.

Ardian Gjini nga AAK-ja të enjten ka tërhequr vërejtjen se "vokabulari politik i AAK-së është shumë i pastër".

"Vokabulari jonë është larg më i mirë se vokabulari që e ka përdorur PDK-ja kur ka qenë në opozitë", është shprehur Gjini. "AAK-ja e ka fjalorin shumë të pastër, nuk i përdor fjalët fyese që i ka përdorur PDK-ja derisa ka qenë në opozitë".

Partneri i PDK-së në koalicionin qeveritar është i kujdesshëm në vlerësimin e mënyrës se si komunikojnë PDK-ja dhe AAK-ja.

"Mendoj se fjalori i ashpër s'i bën nder askujt, por besoj se s'do të prodhojë ndonjë destabilitet", ka thënë të enjten sekretari i përgjithshëm i LDK-së, Ramë Manaj.

Ai ka shfaqur bindjen se është koha për një fjalor më racional në skenën politike kosovare.

## Mungesë kulture politike

Edhe pse kishte bindjen se PDK-ja e AAK-ja aplikojnë një fjalor që mund të reflektojë destabilitet, Luzim Zeneli nga LDD-ja ka shfaqur bindjen se ai megjithatë nuk do të ndikojë për të prishur klimën politike në masë ekstreme.

"Një fjalor i tillë nuk përkon me kulturë politike, por ne e dimë që pas luftës kemi pasur momente shumë më të acaruara dhe është ruajtur stabiliteti, prandaj shpresojmë që edhe tani të evitohen telashet", ka thënë Zeneli. "Ne si LDD punojmë që komunikimi ynë politik të jetë në suaza të fjalorit që korrespondon me etikën politike, i shmangemi një vokabulari që do ta cenonte komunikimin e shëndoshë mes spektrit politik dhe do të krijonte edhe një imazh negativ".

Ai ka tërhequr vërejtjen se "aktualisht një fjalor agresiv është futur edhe në Kuvendin e Kosovës dhe adresohet kryesisht nga pozita me tone ofenduese".

Nëse vazhdon kjo mënyrë komunikimi mes PDK-së dhe AAK-së "ende pa u ditur data e zgjedhjeve", kjo sipas Zenelit "mund të ndikojë në krijimin e një mjedisi të pafavorshëm që do të reflektojë me pasoja në terren". "Sinjalet nga qendra kanë ndikim në periferi, në terren, duke e ditur edhe nivelin dhe shkallën e emancipimit që dallon, por si LDD ne jemi kundër përdorimit të një fjalori që nuk përkon me kulturë parlamentare", është shprehur Zeneli.

Ibrahim Makolli, nga AKR-ja, ka vënë në pah se ai dhe partia e tij nuk e simpatizojnë mënyrën e komunikimit mes PDK-së dhe AAK-së.

"Nuk kisha me i dhënë vetes e as partisë sime të drejtë me komuniku si ata", ka theksuar Makolli.

Megjithatë, ai ka shfaqur bindjen se kjo mënyrë komunikimi nuk mund të rezultojë me ndonjë destabilitet.

"Nuk ekziston ndonjë rrezik për tensionim, besoj se as ky vokabular nuk do ta rrezikojë stabilitetin e vendit, s'e besoj se ia lejojnë vetes ata rrezikimin e shtetit", është shprehur Makolli duke kujtuar se "në të kaluarën nuk e ka pasur lehtë Kosova me i kalue tensionet".

"Afër zgjedhjeve zakonisht ngrihet toni, por veprimet tona duhet t'i bindin qytetarët për zgjedhje demokratike", ka sugjeruar nënkryetari i AKR-së.

Ai ka porositur se "qytetari duhet ta kuptojë se ky është thjesht fjalor politik" dhe ka shfaqur bindjen se kultivimi i një komunikimi më racional mes PDK-së dhe AAK-së do t'i bënte mirë skenës politike kosovare.

## Fjalor që duhet zbutur

Mazllum Bajraliu, njohës i zhvillimeve politike në Kosovë, i pyetur rreth vokabularit të ashpër që po aplikojnë PDK-ja dhe AAK-ja ka thënë se "çdo vokabular i cili reprezenton mungesën apo nivelin e duhur të një kulture politike, është një paradigmë e cila mund të shpjerë edhe në diçka që quhet ashpërsim i gjendjes politike dhe sociale në vend, por edhe i shkaktimit të pakënaqësive dhe zhgënjimeve të qytetarëve".

"Për të ardhur deri te një destabilitet varet nga gradacioni i atij vokabulari, nga ajo që quhet arsenal i vokabularit dhe nga shumë parakushte të tjera, mirëpo qytetarët janë të lodhur me çështje të tilla dhe ata janë të interesuar të merren me problemet e tyre jetike që i kanë mjaft të mprehta dhe prezente, siç janë ekzistenca sociale, mirëqenia etj.", ka veçuar Bajraliu. "Patjetër që duhet të zbutet fjalori, Kosova është dëshmuar në kohë të vështira që ka një kulturë politike, nuk guxojmë që qoftë individët, qoftë grupet politike të lejojnë që të degradohet ky nivel dhe të përdorin një zhargon tjetër. Ishte dashtë që përkundrazi të avancohet kjo gjendje", është shprehur ai.

Komunikimin e ashpërsuar ndërmjet PDK-së dhe AAK-së, Bajraliu e ka parë edhe si "përpjekje për të përvetësuar sa më shumë elektoratin" dhe kjo sipas tij "është normale derisa nuk kalon në diçka që është e papranueshme".

**Dhjetë vjet pas zhdukjes së avokatit Alishefik Spahiu, familjarët thonë se zhdukja e tij është bërë me urdhër zyrtar**

# As dëshmitë e Hagës nuk ndihmojnë gjetjen e avokatit ferizajas

**E bija e avokatit Spahiu ka ngritur kallëzim penal ndaj ish- eprorit policor serb, Dragan Gjorgoviq, mbi faktin se në gjykimin e Hagës një dëshmitar i mbrojtur ka pranuar se së bashku kanë shkuar në shtëpinë e avokatit , por asnjë përgjigje nuk ka marrë që sa vite nga Prokuroria**

KOHA Ditore *Afrim Demiri*

Ferizaj, 19 prill - Dy fotografi të veprimtarit atdhetar, avokatit të mirënjohur ferizajas Alishefik Spahiu, rrinë të vendosura në dhomën e familjes së tij dhe sikur u flasin mbesës Aulonës dhe nipit Alisit për mungesën dhjetëvjeçare të gjyshit. Prej 20 prillit të vitit '99, familja Spahiu nuk di asgjë për kryefamiljarin e tyre, i cili është zhdukur nga forcat serbe. Zhdukja e tij, sipas familjarëve, është bërë me urdhër zyrtar të organeve serbe. Po bëhen vite që e bija e avokatit të zhdukur, Arijeta, ka ngritur kallëzim penal ndaj ish-eprorit policor serb, Dragan Gjorgoviq. Ajo kallëzimin penal e ka mbështetur mbi faktin se në gjykimin e Hagës një dëshmitar i mbrojtur ka pranuar se së bashku kanë shkuar në shtëpinë e avokatit dhe pastaj brenda ka hyrë vetëm Gjorga dhe një polic tjetër. "Po mbushen dhjetë vjet dhe asnjë gjurmë për babanë tim, pastaj as pas kallëzimit penal që bëra askush nuk ka ndërmarrë asgjë, më kanë thënë se është në procedurë e sipër", pohon Arijeta, duke shprehur zhgënjimin e saj në institucionet e vendit dhe në ato ndërkombëtare.

## Kallëzimin penal nuk e shqyrton askush

Familjarët e Alishefik Spahiut kanë bërë çmos për ta ndriçuar fatin e tij. "Kam rrëmihur varre edhe në varrezat serbe të qytetit, sepse na thanë se mund të jetë aty, por sot e asaj dite nuk iu gjet një shenjë", thotë Bedria, e shoqja e cila jeton me ankthin e zhdukjes së të shoqit . Vajza Arijeta, e cila ka trashëguar të atin edhe për nga profesioni, një kohë nëpërmjet Fondit për të drejtat njerëzore të Natasha Kandiqit, derisa punonte aty ishte munduar të gjente të vërtetën e zhdukjes së babait. "Ajo që dihet saktësisht është vetëm fakti se zhdukja e tij është akt zyrtar, sepse ka ekzistuar lista për pushkatim, andaj konsideroj se as faktori vendas dhe as ai ndërkombëtar nuk kanë bërë sa duhet presion në organet serbe që t'i ndriçojnë aktet kriminale ku drejtpërdrejt shteti serb mban përgjegjësi zyrtare, siç është rasti i babit, pastaj i Ukshin Hotit etj.", thotë Arijeta. Mirëpo kjo ka shfrytëzuar një dëshmi të një dëshmitari të mbrojtur gjatë gjykimit të Milosheviqit dhe ka bërë kallëzim penal.

"Është për çudi që sot e asaj dite askush në Prokurori nuk merret me këtë çështje, unë kam sjell argumente se dëshmitari e ka pranuar zyrtarisht se ka qenë eprori serb, polici Dragan Gjorgoviq, ai që ka kërkuar nga ai ta dërgonte në shtëpinë tonë dhe pastaj ai dëshmon gjithashtu se policët kanë hyrë brenda shtëpisë ku ka qëndruar vetëm babai" , rrëfen Arijeta. Edhe mësuesja Bedrie tregon se menjëherë pas arrestimit të Alishefikut kishte kërkuar sqarime në Gjykatën e Ferizajt , por as kryetari i atëhershëm i gjykatës serbe, Toma Petkoviq, nuk i kishte dhënë asnjë sqarim edhe pse për rastet e të pushkatuarve të tjerë ferizajas Haki Brahës,gazetar, dhe Ismet Ramadanit, veprimtar politik, ishin mbajtur ekspertiza nga kjo gjykatë. "Më habit fakti se sot Petkoviq është avokat i lirë në Shtërpcë dhe vjen shpesh në Ferizaj dhe askush nuk e ka marrë asnjëherë në pyetje për të kërkuar të dhëna nga ai për sqarimin e zhdukjes së Alishefikut, kur dihet se ai gjatë kohës së luftës ka qenë edhe shef i Shtabit të krizës", shpreh revoltën e saj Bedria. Dy ditë para se të arrestohej Spahiu ishte bastisur shtëpia e kësaj familjeje nga tre veta, paramilitarë serbë, që ndër vete ishin thirrur me emra të koduar " Cërni", "Zhuti" dhe "Beli".

## Harresa nga institucionet lëndon familjen Spahiu

Alishefik Spahiu ka qenë kryetari i parë i Këshillit themelues të LDK-së në Ferizaj, ka qenë veprimtar shumëvjeçar i çështjes kombëtare, për shumë vjet ka qenë avokat që ka mbrojtur të burgosurit politikë shqiptarë nga akuzat e shtetit serb nëpër proceset e montuara politike. Mirëpo pas lufte, tash e dhjetë vjet, në asnjë manifestim të vetëm nuk është shënuar dhe nuk është folur për shëmbëlltyrën e tij. "Kjo harresë po na lëndon shumë, u bë një dekadë dhe asnjë shënim i vetëm , asnjë përkujtim, asnjë mirënjohje për angazhimin e tij, për çka flet ky injorim institucional?", pyet Bedria. Alishefik Spahiu nuk e kishte lëshuar shtëpinë duke dhënë shembullin e vetëmohimit qytetar dhe kombëtar. " Nuk luftohet vetëm në mal, por edhe në qytet", i kishte thënë të shoqes në ato kohë ai, duke arsyetuar se pse po qëndronin ndër të vetmit në lagje. Për Alishefik Spahiun nuk janë kujtuar as Shoqata e Juristëve, as Oda e Avokatëve, as ish- të burgosurit politikë, as shoqatat e dala nga lufta dhe as pushteti lokal. Sipas familjarëve, "një akuzë tjetër rëndon mbi një qytet". Mirëpo mësuesja Bedrie tregon se as premtimi i vjetshëm i pushtetit lokal që në fund të prillit të mbajë një manifestim përkujtimor në kujtim të atdhetarit Spahiu nuk është mbajtur. Për më keq, edhe pak ditë në përmbushjen e dhjetëvjetorit të zhdukjes asnjë institucion nuk ka paralajmëruar ndonjë shënim. I vetmi gjest që përkujton shëmbëlltyrën e tij është emërtimi i rrugës përskaj shtëpisë së tij "Alishefik Spahiu". Nipi dhe mbesa e tij luajnë në rrugën me emrin e gjyshit pa pasur mundësi asnjëherë ta nderojnë me lule tek varri, një harresë kjo që flet për injorancën tonë jo vetëm institucionale.

**Partitë opozitare vazhdojnë dhënien e ideve për themelimin e bankave për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës**

# Banka për Rindërtim dhe Zhvillim – “çelës i zhvillimit ekonomik”

**Ekspertët e ekonomisë kanë vlerësuar se ideja e partive opozitare për hapjen e një banke të tillë në Kosovë do të ishte e mirëseardhur, sidomos tani kur kriza globale ka filluar ta godasë edhe Kosovën. Mirëpo zyrtarët qeveritarë nuk janë pajtuar me këtë “ide”**

KOHA Ditore *VALON MALOKU*

PRISHTINË, 19 PRILL — Ideja e partive opozitare për hapjen e një banke për zhvillim dhe rindërtim ka shtyrë njëkohësisht dhënien e mendimeve të ndryshme rreth dukjes dhe mënyrës së funksionimit të mundshëm të kësaj banke. Nëpërmes hapjes së një banke të tillë, socialdemokratët parashohin që të ketë përmirësim të gjendjes së rëndë sociale në Kosovë, e njëkohësisht edhe një zhvillimin të hovshëm ekonomik. Këshilli i sektorit të ekonomisë i Partisë Socialdemokrate ka bërë të ditur nëpërmes një komunikate për media të dielën se Banka e Kosovës për Rindërtim dhe Zhvillim do ta luante rolin e një banke gjithëpërfshirëse, nëpërmes së cilës do të kalonin të gjitha transaksionet e mundshme të Republikës së Kosovës. Aksionari kryesor i kësaj banke, sipas socialdemokratëve, do të duhej të ishte Qeveria e vendit. Ata kanë treguar se hapja e një banke të tillë garanton një stabilitet më të mirë ekonomik, ndërsa pohojnë se të gjitha vendet e rajonit tashmë kanë të hapura këso lloj bankash.

“Edhe Kosova, po qe se zyrtarët e saj duan që ta ndërpresin stagnimin gati 20-vjeçar të zhvillimit ekonomik, duhet të marrë një hap urgjent, pra të formohet Banka e Kosovës për Rindërtim dhe Zhvillim, e cila horizontalisht do të shtrihej në 7 qendrat e Kosovës, në kuadër të një infrastrukture të objekteve të Bankës së Kosovës, të cilat tani për tani nuk janë të privatizuara”, thuhet në komunikatën e PSD-së.

Sipas kësaj komunikate, bankat në këto shtatë qendra do ta kishin cilësinë e personit juridik dhe do ishin mbështetje e fortë e zhvillimit ekonomik e regjional të Kosovës. Në bazë të të dhënave të Këshillit për ekonomi të PSD-së, bruto produkti vendor i Kosovës ka mbetur i njëjtë që nga vitet e nëntëdhjeta. “Që nga viti 1990, kur Kosova totalisht u deinstitucionalizua, bruto produkti i saj ishte 2,5 miliardë dollarë, ndërsa në vitin 2007 e mbylli me 2,5 miliardë euro”, thuhet në komunikatën e PSD-së. Ndërsa Safet Merovci, nënkryetar i Partisë së Drejtësisë, ka thënë se duhet të kërkohet nga Qeveria që të bëjë hapjen e një banke të llojit të tillë.

“Ne mendojmë se koncepti i ndërtimit të Kosovës duhet të bazohet në bazë të realitetit, kur e them këtë mendoj në atë që përvojat më të mira tregojnë se asnjë shtet në botë nuk e lë ekonominë e vendit të menaxhohet vetëm nga bankat e huaja”, ka thënë Merovci.

Sipas partive opozitare të cilat janë të pajtimin për idenë e hapjes së një banke për zhvillim, roli dhe funksioni i kësaj banke do të ishte shumë më i gjerë sesa ai i bankave aktuale, të cilat veprojnë në Kosovë.

“Bankat e tanishme që veprojnë në Kosovë, jovendoret dhe vendoret në politikën e tyre afariste, gjatë gjithë kësaj kohe kanë dështuar se janë në shërbim të ngurtë dhe të ngushtë të maksimalizimit të profitit dhe të interesave të aksionarëve të tyre dhe asgjë me tepër, ndërsa kjo bankë do të kryente edhe të gjitha punët e tjera bankare nga fushëveprimi i saj”, është bërë e ditur në komunikatën e socialdemokratëve.




**Ideja e partive opozitare për hapjen e një banke për zhvillim dhe rindërtim ka shtyrë njëkohësisht dhënien e mendimeve të ndryshme rreth dukjes dhe mënyrës së funksionimit të mundshëm të kësaj banke**

## Ekspertët “pro” Bankës për Zhvillim – Qeveria kundër

Sipas komunikatës së PSD-së, kjo bankë do të kishte kompetenca për mobilizim dhe menaxhimin e buxhetit të Kosovës, i shprehur në formë suficiti apo deficiti, menaxhimin e buxheteve komunale, depozitat në BPK nga fondet e ndërmarrjeve publike, Trustin e Pensioneve, si dhe fondet nga privatizimi. Ekspertët e ekonomisë e kanë mbështetur një gjë të tillë, duke pohuar se hapja e një banke të llojit të tillë do të ishte çelësi më i përshtatshëm për zhvillimin ekonomik të vendit.

Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, ka theksuar se duhet të futet një konkurrencë më e madhe bankare në mënyrë që të ndihmojë bizneset duke i ulur kamatat dhe duke qenë më fleksibile në mbështetjen e ekonomisë kosovare, sidomos në sektorët e prodhimtarisë vendore.

“Në Kosovë mungon një bankë që do ta ndihmonte zhvillimin e ekonomisë, sepse këto bankat aktuale janë banka private. Edhe pse janë të mbikëqyrura nga autoriteti qendror bankar, prapëseprapë këto do ta shikojnë interesin e tyre, që të jenë me përfitim më të madh për vetë bankën”, është shprehur Shahini.

Sipas tij, duhet të gjendet një mënyrë që të ndihmohet ekonomia e Kosovës, “e pse jo nëpërmes fondeve që tash janë jashtë, siç është fondi i privatizimit, është fondi i Trustit Pensional”.

“Nga viti në vit neve po na paraqitet suficit. Suficiti që paraqitet në këtë kohë kur kriza po e godet edhe Kosovën, atëherë duhet menduar se a duhet t’i ulim taksat në mënyrë që ky suficit të mbesë në biznes, apo duhet të investohet përmes një banke të një lloji të tillë që do të ishte e përbërë prej fondeve private dhe publike, të cilat do t’i ndihmonin drejtpërsëdrejti rimëkëmbjes së ekonomisë”, ka theksuar ai.

Ideja për hapjen e një banke për zhvillim nuk është mirëpritur edhe nga zyrtarët qeveritarë, të cilët kanë theksuar se “idetë e partive opozitare janë të mirëseardhura në kuptimin e pasurimit të debatit politik në Kosovë”.

Zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se Qeveria nuk e ka ndërmend të ndryshojë planin e saj zhvillimor.

“Ne kemi një program politik të qartë, i votuar nga shumica e qytetarëve të Kosovës... Banka për Zhvillim dhe Rindërtim nuk është koncept i mendimit tonë qeveritar”, është shprehur Krasniqi.

## Idetë e mëhershme për themelim

Eksperti i ekonomisë nga Oda Ekonomike e Kosovës, Flamur Keqa, ka vlerësuar se ideja për themelimin e një banke zhvillimore daton qysh moti, dhe kjo bankë qëllim themelor do ta kishte financimin me kushte me të favorshme për sektorët që potencialisht do të ndikonin në shtimin ekonomik dhe në zbutjen e papunësisë. “Funksionimi i saj do të dallonte nga funksionimi i bankave të tipit komercial, sepse si qëllim kryesor nuk do ta kishte maksimalizimin e profitit, por krijimin e kushteve me te favorshme për biznes”, është shprehur Keqa.

Sipas tij, kapitali dhe mjetet për themelimin e kësaj banke do të paraqitnin problemin me të vogël, ndërkaq burimi i mjeteve do të ishte burim që do të sillte stabilitet të madh për kreditim të sigurt të sektorëve përfitues nga këto mjete.

“Themelimi i kësaj banke apo këtij fondi do të ndikonte, nëse jo në uljen e çmimit të kredive të bankave që aktualisht operojnë në Kosovë, atëherë se paku në mosngritjen e çmimeve, sepse nëse kriza globale vazhdon të zgjasë më tepër, kjo do të mund të ndikonte në rritjen e çmimit të kredive dhe vështirësitë për të ardhur deri te kreditë”, ka vlerësuar ai.

### Roli i Bankës së Kosovës për Rindërtim dhe Zhvillim

Plani i Këshillit Ekonomik i PSD-së parasheh që përmes garancive që do t’i kishte ofruar Qeveria, roli dhe efektet e funksionimit të Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim do të ishin të mëdha, sidomos në këto aspekte: mobilizimin e kapitalit në vend, zvogëlimin e derdhjes së tij jashtë vendit me kushte shumë të pavolitshme, rënien rapide të normave të kamatave, rritjen e likuiditetit në ekonomi dhe banka, si dhe krijimin e kushteve të volitshme për kreditimin e bizneseve profitabile, pavarësisht nga madhësia e tyre.

“Do të fillonin të krijoheshin kushte për zhvillimin e hovshëm të prioriteteve zhvillimore të Kosovës, siç janë bujqësia, turizmi, energjetika, agroindustria, zejtaria, si dhe infrastruktura që është drejtpërdrejt e lidhur me prodhimtarinë materiale dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi dhe stimulimin e të gjitha prodhimeve vendore, eksportin e mallrave dhe shërbimeve”, thuhet në komunikatën e PSD-së.

# Evitohen problemet në linjat e operatorit “Vala”

PRISHTINË, 19 PRILL — Operatori i telefonisë mobile “Vala” ka evituar problemet e paraqitura në thirrjet telefonike gjatë ditës së shtunë dhe të diel, të cilat janë shkaktuar nga punimet në riparimin dhe zgjerimin e rrjetit të këtij operatori. Kështu ka bërë të ditur zëdhënësi i këtij operatori, Menduh Abazi, i cili ka pohuar se gjatë këtyre dy ditëve ka pasur probleme në thirrjet e platformës pre-paid, nga të cilat, sipas tij, i janë shkaktuar humbje të pakonsiderueshme këtij operatori të telefonisë.

“Dje edhe sot kemi pasur probleme teknike edhe pas implementimit të rrjetit të pestë të zgjerimit të rrjetit nga kompania ‘Alcatel Lucent’. Një pjesë e konsumatorëve nuk kanë pasur qasje në llogarinë e tyre dhe për këtë ka pasur dështim të thirrjeve”, ka njoftuar Abazi.

Sipas tij, menaxhmenti i PTK-së është duke punuar në evitimin e këtyre probleme, por, megjithatë, do të kërkohet edhe kompensim nga kompania e cila është duke u marrë me punët e zgjerimit të rrjeti “Alcatel Lucent”.

“Menaxhmenti do të kërkojë kompensim material nga ‘Alcatel Lucent’ për dëmin e shkaktuar si pasojë e mosfunksionimin të linjave në mënyrë të rregullt gjatë këtyre dy ditëve... ne do të kërkojmë kompensim material dhe të imazhit gjatë këtyre dy ditëve”, ka theksuar Abazi.

Ai ka pohuar se këso probleme janë paraqitur edhe më herët në këtë operator të telefonisë mobile, të cilat llogaritet të kenë shkaktuar humbje deri në nëntë milionë euro.

“Ne si PTK edhe ashtu kemi nisur një procedurë ndaj “Alcatelit” pak kohë më parë, për shkak të mospërfundimit me kohë të fazës së pestë të zgjerimit, dhe kjo e vërteton faktin e kërkimit të dëmshpërblimit nga PTK-ja”, ka thënë ai.

Faza e pestë e zgjerimit të rrjetit të PTK-së parasheh shtirjen e rrjetit në 99 për qind të territorit të Kosovës, shtimin e konsumatorëve deri në 1 milion e dyqind mijë konsumatorë, si dhe efikasitetin dhe stabilitetin e rrjetit.

*V. M.*

### Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) nuk ngutet në nënshkrimin e kontratave të shitblerjes

# Në pritje të kontratave për pronën e blerë në privatizim

**"Që 14 muaj ne presim ta nënshkruajmë kontratën dhe ende nuk na është dhënë bekimi nga AKP-ja, na janë bllokuar paratë që kemi marrë kredi për të kryer pagesën, 3 milionë kemi paguar dhe 9.2 milionë euro presim t`i paguajmë", ka thënë për "Kohën Ditore", Besim Elshani, blerësi i tokës bujqësore në Shkabaj**

KOHA Ditore *ARBANA XHARRA*

PRISHTINË, 19 PRILL - Besim Elshani nga Tirana tash katërmbëdhjetë muaj ka blerë tokën bujqësore në Shkabaj përmes procesit të privatizimit në Kosovë dhe ende nuk ka nënshkruar kontratë për shitblerje me zyrtarët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). Ai i është futur garës për të blerë tokën bujqësore përmes firmës së tij "AGNA Investitor" nga Tirana duke ofruar çmimin më të lartë blerës prej 12.3 milionë euro. Elshani fillimisht ka paguar vetëm 3 milionë euro apo 25 për qind të shumës totale duke pritur që të paguajë edhe pjesën tjetër pasi që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes me zyrtarët e AKP-së. Mirëpo, ai që disa muaj radhazi është duke bërë kërkesë edhe me shkrim në AKP që të përfundojnë procedurat dhe ende nuk ka marrë përgjigje se kur do të bëhet pronar legjitim i kësaj prone.

"Që 14 muaj ne presim ta nënshkruajmë kontratën dhe ende nuk na është dhënë bekimi nga AKP-ja, na janë bllokuar paratë që kemi marrë kredi për të kryer pagesën, 3 milionë kemi paguar edhe 9.2 milionë euro presim t'i paguajmë", ka thënë për "Kohën Ditore", Besim Elshani, blerësi i tokës bujqësore në Shkabaj. Ai ka thënë se kjo vonesë është duke i shkaktuar humbje të mëdha për shkak se në të njëjtën kohë kamata është duke ecur në bankën ku ai ka marrë kredinë.

"Është interesi bankar që po ecën, është e palogjikshme të na bëhen këto vonesa kur ne që më shumë se një vit jemi shpallur fitues dhe jemi të gatshëm ta kryejmë tërë pagesën", ka thënë Elshani.

Ai i ka dërguar për herë të fundit në mars të këtij viti një shkresë Bordit të drejtorëve të AKP-së përmes së cilës kërkon të përfundojnë procedurat dhe të bëhet pronar legjitim i pronës që ai ka privatizuar. Në këtë shkresë thuhet se janë në pritje të bëjnë pjesën tjetër të pagesës për të përfunduar pagesën totale prej 12.3 milionë euro. "Kostot e bartura nga shoqëria jonë janë shumë të larta", shkruan në këtë shkresë.

Elshani aty shpreh shqetësimin se me gjithë kërkesave të tyre të vazhdueshme që të sqarohen me zyrtarët e AKP-së lidhur me kontratën, kanë marrë shumë pak përgjigje nga zyrtarët e kësaj agjencie. "Ne si kompani kemi vizion për investime në Kosovë dhe kjo procedurë përmbylljeje kontrate thjesht po na pengon në ecurinë e zhvillimit tonë në Kosovë", thuhet në letrën dërguar Bordit të AKP-së në krye me drejtorin e saj, Dino Asanaj.

Elshani i ka njoftuar zyrtarët e AKP-së se kjo vonesë që po u shkaktohet nga AKP-ja i ka frikësuar edhe bashkëpunëtorët e tyre me të cilët kishin marrëveshje për zhvillimin e disa bizneseve në Kosovë.

Elshanit zyrtarët e AKP-së i kishin thënë më herët se procedurat kanë përfunduar dhe se në mbledhjen e Bordit të AKP-së i mbajtur në fund të shkurtit ishte marrë vendimi që të nënshkruhet kontrata. "Prandaj jemi në pritje që kjo kontratë të nënshkruhet dhe ne kërkojmë nga AKP-ja që të bëjë identifikimin e parcelave të pronës sipas dokumentacionit të tenderit, sepse paratë janë ngurtësuar në bankë", shkruan në kërkesën e Elshanit drejtuar AKP-së.

Ky nuk është rasti i vetëm që ka bërë ankesë për vonesat në nënshkrimin e kontratës. Blerësi i një depoje me oborr që ka qenë pronë e ndërmarrjes shoqërore "17 nëntori" në Pejë, që nga muaji dhjetor i vitit 2007, ende nuk ka kontratë me AKP-në. Ai ka kryer tërësisht pagesën në vlerë prej 313 mijë euro dhe për më shumë se një vit radhazi nuk i është ofruar kontratë dhe qasje në pronën që ka privatizuar. "KD"-ja ka siguruar kërkesën e tij që e ka bërë përmes avokatit në AKP, në muajin nëntor të vitit të kaluar, ku thuhet se kërkohet nënshkrimi i kontratës dhe kompensimi i dëmit për vonesat që i kanë shkaktuar.

"Kërkoj nga ju që të më kompensoni dëmin e fitimit të humbur prej datës kur kam kryer pagesën, e deri në ditën kur të nënshkruani kontratën dhe të ma mundësoni qasjen në pronën time", thuhet në kërkesën e pronarit të tokës. Gazeta ka bërë përpjekje, por nuk ia ka arritur që të kontaktojë pronarin e tokës së blerë.

Zyrtarët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) janë arsyetuar duke thënë se kanë trashëguar shumë punë të pakryera nga Agjencia paraardhëse e tyre, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM).

"Duhet pasur parasysh se Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) si pasardhëse e ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) ka trashëguar një mori çështjesh të papërfunduara, duke përfshirë këtu edhe kontrata të shitjeve", ka thënë zëdhënësja e AKP-së, Zana Haxha. Ajo bëri të ditur se jo vetëm kjo kontratë por edhe një numër i madh i kontratave të tjera janë në pritje të nënshkrimit. "Agjencia ka trashëguar mbi 166 kontrata të panënshkruara nga ish-AKM-ja. Vetë ky numër është indikator i asaj se nënshkrimi kontratave kërkon kohë dhe angazhim i cili medoemos do të ndikojë në kohëzgjatjen e përfundimit të kontratave", ka shtuar Haxha. Ajo ka bërë të ditur se momentalisht Agjencia është në proces të angazhimit të stafit shtesë i cili do të punojë në këtë drejtim, dhe kemi filluar nënshkrimin e kontratave me një dinamikë jashtëzakonisht të mirë. Mirëpo, Bordi i AKP-së është themeluar prej muajit gusht të vitit të kaluar, kanë kaluar rreth dhjetë muaj dhe ende nuk është nënshkruar asnjë kontratë me blerësit e ndërmarrjeve shoqërore në procesin e privatizimit.

### Këtë javë mbahet panairi i parë i turizmit në Kosovë

# Turizmi - katalizator për zhvillimin ekonomik, thonë ekspertët

**Me moton "Qëndro për vikend – përjetoje Kosovën", të mërkurën në Prishtinë pritet të mbahet panairi i parë i turizmit i quajtur "Dita e turizmit në Kosovë". Organizatorët e këtij panairi synojnë të fillojnë ta bëjnë Kosovën një destinacion turistik duke u munduar t'i ndalin turistët potencialë të qëndrojnë për vikende në Kosovë**

KOHA Ditore *LULZIM DEMOLLI*

PRISHTINË, 19 PRILL – Kriza ekonomike globale do të jetë shans i mirë për ngritjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Kështu nuk mendojnë ekspertët ekonomikë, por ata të turizmit, të cilët tashmë janë organizuar për fillimin e aventurës për promovimin e turizmit kosovar.

Njohësit e kësaj fushe thonë se ka treg të mjaftueshëm për zhvillimin e turizmit në Kosovë, por duhen krijuar kushtet për zhvillimin e këtij sektori, i cili pastaj do të rriste dukshëm konsumin e brendshëm, e paralelisht me këtë edhe zhvillimin ekonomik.

"Turizmi është biznes për secilin. Fatmirësisht në Kosovë ka një potencial të mirë për të zhvilluar turizmin dhe ky potencial duhet shfrytëzuar menjëherë nëse dëshironi të keni një zhvillim më të mirë ekonomik të vendit", ka thënë Scott Weyne, ekspert për turizëm.

Ai tash e sa ditë po qëndron në Kosovë i angazhuar nga USAID-i si këshilltar për turizëm në programin për "Ndërmarrjet Private në Kosovë".

Gjatë qëndrimit të tij në Kosovë Weyne thotë se ka parë një potencial të madh për zhvillimin e turizmit alternativ në Kosovë, siç janë atraksionet turistike kulturore, jeta në fshatra e në qytete, shëtitja në bjeshkë dhe shumë vende të tjera që mund të jenë atraktive për komunitetin ndërkombëtar që punon dhe jeton në Kosovë.

"Unë kam parë që në Kosovë ka mjaft treg për të shitur produktet turistike dhe kjo vetëm duhet organizuar. Zhvillimi i turizmit do të ngrehte në zinxhirë edhe zhvillimin e sektorëve të tjerë ekonomik", shprehet Weyne.

Programi për "Ndërmarrjet Private në Kosovë" ka për qëllim stimulimin e konkurrencës në sektorin privat të ekonomisë së Kosovës.

Ky projekt në vlerë prej 17,8 milionë dollarësh pritet të implementohet brenda katër vjetësh dhe ka për qëllim promovimin e kualitetit të përmirësuar dhe efektshmërinë e produkteve dhe shërbimeve, rritjen e numrit të të punësuarave për të gjithë banorët e Kosovës përfshirë të rinjtë dhe minoritetet, zvogëlimin e disbalancit tregtar, dhe integrimin e mëtejmë të Kosovës në Ballkan dhe më gjerë.

Në kuadër të këtij projekti në Prishtinë këtë javë pritet të zhvillohet edhe panairi i parë i turizmit i quajtur ndryshe edhe "Dita e turizmit në Kosovë".

Me moton "Qëndro për vikend – përjetoje Kosovën", organizatorët e këtij panairi kanë për qëllim të fillojnë ta bëjnë Kosovën një destinacion turistik, duke u munduar t'i ndalin turistët potencialë vendorë të qëndrojnë për vikend në Kosovë. "Kriza ekonomike mund të jetë një faktor i mirë që t'i shtyjë turistët potencialë që të bëjnë turizëm në Kosovë dhe mos të dalin jashtë saj. Ne këtë fakt duhet shfrytëzuar. Të mërkurën do të hapet edhe panairi "Dita e turizmit në Kosovë", ku ofertuesit e turizmit do të kenë rast të ofrojnë produktet e tyre turistike për turistët potencialë siç janë ndërkombëtarët që jetojnë dhe punojnë në Kosovë", ka thënë Weyne.

Panairi i turizmit, sipas tij, është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të turizmit kosovar që deri tani nuk është ofruar nga askush. Nga ana e tij, Zekë Çeku, kryetar i Shoqatës së turizmit të Kosovës, thotë se Kosova ka potenciale të mjaftueshme, vende atraktive dhe bukuri natyrore, të cilat mund të jenë konkurrente edhe në rajon.

Ajo që i ka munguar Kosovës deri tani, sipas tij, është promovimi i vlerave turistike, të cilat do mundohen t'i promovojnë gjatë kësaj dite.

Për vizitorët në panair Çeku thotë se do të prezantohen paketa të ndryshme turistike që mund të përjetohen në Kosovë, si çiklizmi aventurier në bjeshkë, demonstrim i gatimit, ekskursione shëtitëse kulturore, vizitë në kulla, ekskursione në verari e shumë produkte të tjera turistike.

"Vendet në zhvillim janë të përkushtuar në zhvillimin e turizmit dhe ne duhet ta kapim këtë hap sepse kemi një potencial të mjaftueshëm për të ofruar eksperienca të reja jetësore për turistët nga shumë vende evropiane që punojnë në Kosovë. Mbi dyzet ofrues të shërbimeve turistike brenda Kosovës do të prezantojnë produktet e tyre dhe me këtë rast presim që ata do të kenë mundësitë edhe t'i shesin ofertat e tyre", thotë Çeku.



**Si atraksion turistik Kosova do të sprovohet më 1 maj, kur edhe arrin grupi i parë i turistëve londinezë që do të vizitojë Kosovën, nën organizimin e kompanisë prestigjioze nga Londra "Regent Holidays"**

Si atraksion turistik Kosova do të sprovohet më 1 maj, kur edhe arrin grupi i parë i turistëve londinezë që do të vizitojë Kosovën, nën organizimin e kompanisë prestigjioze nga Londra "Regent Holidays".

Në këtë paketë të vizitës turistike janë përfshirë vizita të monumenteve kulturo-historike dhe të bukurive natyrore të Kosovës. Destinacion i vizitorëve do të jenë Prishtina, Peja dhe Deçani.

**Shikim nga Brukseli**

# Kosova, tokë e askujt!

**Nuk qëndron problemi në faktin se Qeveria e Kosovës nuk e ka penguar vizitën e Tadiqit në "Kosovën e Serbisë" sepse Qeveria e Kosovës nuk ka mundësi të pengojë një vizitë të tillë. Problemi qëndron në rrahjen e gjoksit kur kosovarëve u është dhënë leje nga bashkësia ndërkombëtare që të pengojnë ardhjen e disa ministrave të Serbisë në Kosovë. Kosovarët as nuk e kanë marrë vetë vendimin që të mos u lejohet ministrave të Serbisë të vijnë në Kosovë e as t'i japin Tadiqit leje që të vijë**

*AUGUSTIN PALOKAJ*



Presidenti i Serbisë, Boris Tadiq, ka ardhur në Kosovë dhe ka kryer ritualin fetar të ndezjes së qirinjve në të Premten e madhe sipas kalendarit ortodoks dhe ka kryer misionin e tij si president i Serbisë që atë ditë të thotë në Deçan se Kosova është pjesë e Serbisë. Ai me fjalimin e tij ka shkelur Kushtetutën e Kosovës, sipas së cilës Kosova është shtet i pavarur por ka respektuar Kushtetutën e Serbisë, preambula e së cilës thotë se "Kosova është pjesë e Serbisë". Sikur Kosova të ishte një shtet normal, me sovranitet të plotë, sikur të mos ishte "sui generis" një vizitë e tillë do të ishte e pamundur. Por, pasi që Kosova nuk ka sovranitet të plotë dhe është „sui generis" vizita të tilla ndodhin, dhe do të ndodhin edhe në të ardhmen dhe me to nuk duhet të shqetësohen kosovarët.

Por, kosovarët duhet të jenë të vetëdijshëm se si bëhet politika dhe si merren vendimet në Kosovë. Kur këtë ta kuptojnë nuk do të habiten e as që do të shqetësohen me vendime të tilla. Para Tadiqit në Kosovë, pa kërkuar fare leje dhe pa e njoftuar fare asnjë autoritet, kishte ardhur ministrja e Mbrojtjes e Spanjës. Edhe për të, sikur edhe për Tadiqin, Kosova nuk është shtet i pavarur.

Ajo pse duhet kritikuar lidershipin kosovar është pse rrahin gjoks për gjëra që nuk u takojnë. Nuk qëndron problemi në faktin se Qeveria e Kosovës nuk ka penguar vizitën e Tadiqit në "Kosovën e Serbisë", sepse Qeveria e Kosovës nuk ka mundësi të pengojë një vizitë të tillë. Problemi qëndron në rrahjen e gjoksit kur kosovarëve u është dhënë leje nga bashkësia ndërkombëtare që të pengojnë ardhjen e disa ministrave të Serbisë në Kosovë. Kosovarët as nuk kanë marrë vetë vendimin që të mos u lejohet ministrave të Serbisë të vijnë në Kosovë e as t'i japin Tadiqit leje që të vijë.

Bashkësia ndërkombëtare ka qenë shumë e irrituar me deklaratat e disa ministrave të Serbisë, më 17 shkurt, në përvjetorin e parë të shpalljes së pavarësisë. Irritimi me sjelljen e Beogradit kishte arritur kulmin kur ministri i Serbisë, Jeremiq, kishte ofenduar të dërguarin e BE-së në Beograd dhe kur deputetë të Parlamentit të Serbisë kishin vizituar veriun e Kosovës, duke nxitur tensionimin e situatës. Pas kësaj, bashkësia ndërkombëtare, për t'i dërguar sinjal Beogradit, u kishte dhënë leje kosovarëve që të pengonin ardhjen e disa ministrave të Serbisë në Kosovë. Kosovarët e panë këtë si rast të mirë që të rrahin gjoks. Madje, disa zëdhënës shkuan aq larg sa të thonë se "ka pranga edhe për Tadiqin". Ndërkohë ndryshuan disa rrethana. Beogradi pranoi që të ketë zyrë të BE-së në Serbi, që edhe zyra e EULEX-it të veprojë atje. Beogradi zbuti tonin rreth Kosovës dhe EULEX-it. Kështu meritoi një leje nga BE-ja që Tadiqi ta vizitojë Kosovën. Sipas asaj që ka dalë në opinion, secila palë këtu formalisht është e pastër. Tadiq ka kërkuar "ndihmë" nga Zyra e Bashkimit Evropian, pra nga zyra e një organizate e cila nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe ka qëndrim "neutral" ndaj statusit. Kjo zyrë i ka përcjellë Peter Feithit në Prishtinë këtë dhe ai, në cilësinë e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtarë (i cili e njeh pavarësinë e Kosovës dhe monitoron zbatimin e saj) u ka sugjeruar autoriteteve të Kosovës që të lejojnë vizitën e Tadiqit në Kosovë. KFOR-i, ka ndihmuar këtë vizitë, sepse as NATO-ja nuk e njeh Kosovën si shtet duke pasur parasysh se 4 nga 28 vende të NATO-s kundërshtojnë këtë pavarësi dhe në këto rrethana KFOR-i duhet po ashtu të jetë neutral ndaj statusit dhe vepron sipas Rezolutës 1244. Qeveria e Kosovës ka dhënë leje për këtë vizitë dhe kështu ka lënë përshtypjen se në Kosovë nuk mund të vijë dikush pa lejen e saj.

Ajo që është shqetësuese është pse autoritetet e Kosovës kanë nevojë që Ambasada Amerikane ta mbështetë vendimin për vizitën e Tadiqit. Para dy javësh pamë se si Ambasada Amerikane mbështeti vendimin për rinovimin e një ambulance në Kamenicë. Të gjitha këto janë shenja se Kosova nuk funksionon si duhet si shtet. Pse Administrata amerikane, nga e cila pritet të kontribuojë më shumë në rritjen e numrit të njohjeve të pavarësisë së Kosovës nëpër botë, të merret me politikën ditore të Kosovës.

Në të ardhmen vizitat e liderëve serbë nuk do të duhej shikuar si diçka që lidhet me patriotizëm apo trimëri apo fuqi, por si diçka që lidhet me funksionimin dhe respektimin e shtetit. Nëse autoritet e Kosovës do të jenë nën presion të madh të opinionit për shkak të vizitës së Tadiqit bashkësia ndërkombëtare mund t'u japë leje që të pengojnë vizitën e ndonjë politikani të profilit më të ulët nga Serbia në Kosovë. Atëherë prapë mund të rrahin gjoks se nuk mund të vijë në Kosovë askush që shkel Kushtetutën tonë. Kështu do të jetë deri në rastin tjetër kur Tadiqi të dojë të vijë në Kosovë përsëri.




Autor: Jeton Mikullovci

**Vështrim**

# Pajtimi i "Hamasit" dhe "Fatahut"

**Duke pasur parasysh ideologjinë e "Hamasit", çfarëdo ndryshimi i qasjes së Perëndimit kundrejt këtij grupi në rast të suksesit në Kajro do të jetë i vështirë. Mirëpo një qëndrim i modifikuar dhe pragmatik që përqendrohet në sjelljen e "Hamasit" në terren, e jo në kushte abstrakte, do të jetë i domosdoshëm jo vetëm për vendimmarrësit perëndimorë, por edhe për "Hamasin"**

*MICHAEL BRONING*

Gaza, Jerusalem, 19 prill – Derisa përfaqësuesit e "Hamasit" dhe të "Fatahut" janë takuar për raundin e katërt të bisedimeve për bashkim kombëtar palestinez në Kajro, jo vetëm palestinezët, mirëpo edhe amerikanët dhe evropianët do të jenë duke e përcjellë me vëmendje këtë takim. Bisedimet e nivelit të lartë, nikoqire e të cilave është shefi i inteligjencës egjiptiane, Omar Suleiman, do të jenë jashtëzakonisht të rëndësishme për dhënien fund të konfrontimeve dyvjeçare të përgjakshme midis Gazës, së udhëhequr nga "Hamasi", dhe Bregut Perëndimor, të udhëhequr nga "Fatahu" dhe të qeverisur nga Mahmoud Abbasi, që gëzon mbështetjen e Perëndimit. Duke i pasur parasysh dështimet e mëparshme, këto bisedime mund të jenë mundësia e fundit për ribashkimin e palestinezëve.
Përçarjet e brendshme midis "Fatahut", krahut të moderuar dhe laik në një anë, dhe "Hamasit" islamik, jo vetëm që kanë çrregulluar udhëheqjen palestineze, por po ashtu thuajse i kanë bërë të pamundura negociatat paqësore me Izraelin. Për më tepër, përçarjet ndërpalestineze vazhdojnë t'i pengojnë përpjekjet për rindërtimin e Gazës, gjë kjo e domosdoshme pas ofensivës ushtarake izraelite në fillim të këtij viti. Kështu, epilogu i negociatave në Kajro do të ketë ndikim mbi palestinezët, izraelitët dhe të gjithë që janë të përfshirë në procesin paqësor në Lindjen e Mesme.
Në raundet e mëparshme fraksionet e ndryshme në parim u patën pajtuar që ta formonin një qeverisje të përbashkët në Bregun Perëndimor dhe në Rripin e Gazës dhe të mbanin zgjedhje parlamentare e presidenciale në territoret palestineze gjatë janarit të vitit 2010. Mirëpo, "Fatahu" dhe "Hamasi" ende kanë dal-

→

KOHA Ditore
E përditshme e pavarur informative • Fahu postar 202 • Botues: "Grupi KOHA" • Drejtoreshë menaxhuese: Flaka SURROI • Gazeta redaktohet nga kolegjiumi:
Kryeredaktor: Agron BAJRAMI, zv.kryeredaktor: Bardh RUGOVA, ndihmëse të kryeredaktorit: Valbona MEHMETI & Brikenda REXHEPI, Bekim KUPINA (Kosovë), Blerim Xhemajli (Ekonomi), Elmaz ISUFI & Visar LOCI (Sport), Granit KURTI, u.d. (Kulturë), Nita LLESHI & Arbana MJEKIQI (Botë), Sami KÇIKU (Qendra Grafike), Fotografia: Alban BUJARI & Driton PAÇARADA
Drejtor komercial: Shpend DOBRANJA • Drejtor i marketingut: Luan DOBROSHI
Telefonat e redaksisë: 038/249-104; 249-105; 243 875 • Fax: 038/249-106 • e-mail: redaksia@kohaditore.com • Marketing: tel&fax: 038/248-880,
e-mail: marketing@kohaditore.com; marketing@koha.net • Xhirollogaria: ProCredit - 1110 - 086 926 - 0001 - 89; BRK - 1210271200031975; KSB - 1700200000134405;
Raiffeisen - 1501001002095874; BpB - 27120000308 • Shtypet në Shtypshkronjën "KOHA" • tel.: 044/126 367
KOHA Ditore marketingu për botimin ndërkombëtar: ERA PRESS GmbH, Usteristrasse 11 - CH-8001 Zürich - Tel.+41 (0) 43 497 32 80 - Fax.+41 (0) 43 497 32 84,
E-mail: koha@erapress.ch - Konto në Zvicër: Credit Suisse KN: 992472-01-2 - Postkonto:80-500-4. - Konto në Gjermani:
Deutsche Bank Konstanz konto nr. 0147348 - BLZ 690 700 24 • Druck: SM Druckhaus GmbH Dreieich D. - W.E.Saarbach GmbH D-50332 Hürth.
Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen.

Opinion

# Fati ynë në duar të tregtarëve!

**Resurset tona duhet të shfrytëzohen për interesat tona kombëtare. Çfarëdo vonese që bëjmë në shfrytëzimin e këtyre resurseve, Kosovën e lëmë në shkallë të ulët të zhvillimit ekonomik. Kështu si është, ajo do të jetë e varur nga vendet e rajonit dhe do të jetë tepër e vështirë që ne të kemi në një të ardhme të sigurt si shtet i ri në këtë pjesë të Evropës**

*ETHEM ÇEKU*

Burimet natyrore janë njëri nga faktorët më përcaktues për zhvillimin ekonomik të një shteti. Po të analizojmë me kujdes ngritjet që pësuan shtetet e mëdha në aspektin ekonomik, rezulton se burimet natyrore u bënë forcë ndikuese në progresin e tyre. Ngritja ekonomike e SHBA-së, Gjermanisë, Francës, Britanisë së Madhe, Norvegjisë, Kanadasë, e Australisë erdhi si rezultat i shfrytëzimit me sukses të potencialit të tyre natyror në kohën e duhur dhe me investimet e duhura. Shtetet e zhvilluara arritën në këtë stad, para së gjithash, duke përdorur jo thjesht resurset natyrore, por duke vënë në lëvizje një numër faktorësh, siç janë: resurset humane, infrastrukturën ligjore, tregjet dhe kontratat e mira. Vendosja në harmoni e këtyre faktorëve beri që ritmet e zhvillimit të arrijnë shkallë shumë të lartë zhvillimi. Gjermania pas Luftës ll Botërore kishte arritur që përmes shfrytëzimit të resurseve të saj të kalojë të gjitha ato pengesa të mëdha që u solli lufta; si në anën ekonomike po ashtu edhe atë politike. Britania i përdori në maksimum, në një kohe të caktuar, burimet e saj natyrore për ngritjen e industrisë. Vendet evropiane, posaçërisht ato perëndimore, pas Luftës ll Botërore e deri në vitet e 70-ta ishin të mobilizuara për shfrytëzimin e burimeve të tyre natyrore për të ardhur deri tek rezultatet e pritura. Në kohën e fundit janë të njohura përvojat e mira të menaxhimit të këtyre resurseve natyrore nga shtetet aziatike. Këto shtete arritën rritje vjetore ekonomike deri në 12%, ulen papunësinë, krijuan praktika të suksesshme në kombinimet: resurse humane, resurse natyrore, investime nga jashtë dhe kontrata të mira. A mund Kosova të nënvlerësojë këto përvoja të suksesshme në këto shtete për zhvillimin ekonomik të tyre, a duhet të frikësohemi ne? Mosplanifikimi i mirë i shfrytëzimit të resurseve natyrore është i barabartë me varfërinë e një vendi. Përvoja e vendeve afrikane të cilat kanë resurse të mëdha natyrore tregon se pa menaxhim të suksesshëm nuk ka as progres ekonomik, pa institucione profesionale nuk ka progres ekonomik. Në projektimin e ndërtimit të këtij termocentrali janë marrë parasysh shumë studime të cilat kanë arritur në përfundim se Kosovës i nevojiten 2.100 megavat. Për të joshur investitorët për këtë projekt janë bërë shumë punë. Ndërsa për të fituar investitor kredibil janë vendosur kritere të larta parakualifikuese. Tani kemi katër konsorciume në këto gara, që vijnë nga shtetet që e kanë njohur shtetin e Kosovës. Është e pajustifikueshme nga Qeveria se si e ngadalëson këtë projekt dhe krejt paradoksalisht e shndërron Kosovën nga një vend që ka resurse të mëdha energjetike në një treg për kompani të ndryshme energjetike të rajonit. Pra, ne e dorëzojmë fatin tonë në duar të tregtarëve dhe stërshitësve të energjisë.

Cili është interesi i Kosovës në këtë projekt?

Përvojat e kaluara janë të këqija për Kosovën. Resurset natyrore të Kosovës më shumë ishin në funksion të zhvillimit ekonomik të republikave të tjera në kuadër të federatës jugosllave, sesa të vetë Kosovës. Sektorët e energjisë dhe të minierave ishin bërë baza të fuqishme për ekonominë e shtetit Jugosllav.

Tani gjërat ndërrojnë në mënyrë thelbësore. Shteti i Kosovës është pronar i këtyre resurseve, Qeveria e Kosovës e ka në dispozicion minierën e Sibovcit dhe infrastrukturën përcjellëse, tani shteti është pronar legjitim i këtyre pasurive dhe do të varet nga Qeveria se si do të maksimalizojë përfitimin nga këto resurse. Investitori në bazë të ligjeve të aprovuara është i obliguar të sjellë teknologjinë e cila duhet të jetë në harmoni me kërkesat mjedisore, sepse ligji për mjedisin e përcakton se ndotësi paguan, ai po ashtu është i obliguar që t'i rikultivojë tokat në minierat e Mirashit dhe Bardhit. Qeveria duhet të arrijë ta realizojë marrëveshjen që për konsumin e brendshëm investitori duhet të ofrojë çmim të leverdishëm, të ruajë vendet e punës, të përkujdeset për çështjet sociale të punëtorëve, të përfshijë kompanitë vendore në kryerjen e punëve në këtë projekt, dhe të arrijë të jetë bashkëpjesëmarrëse në profitin e shitjes së energjisë në tregjet e jashtme nga partneri strategjik. Për të realizuar këtë pako të projektit, kjo qeveri duhet të ofrojë bashkëpunim të hapur me partneret ndërkombëtarë në veçanti me katër institucione ndërkombëtare, si: USAID, Bankën Botërore, Komisionin Evropian dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe po ashtu duhet të punojë shumë më afër me Parlamentin e Kosovës që ky projekt të kalojë përmes një konsensusi të plotë politik, pa të cilin do të ishte e vështirë që investitori të bindet të investojë 3.5 miliardë euro. Po ashtu Qeveria duhet të konsultohet me ekspertët vendorë, të cilët kanë përvoja të jashtëzakonshme, gjë që do të mundësonte që Qeveria dhe Parlamenti të realizonin kontratën më të mirë për vendin. Sa i përket pakos së tenderit, Strategjia e Energjisë e ka definuar se si duhet të realizohet ky projekt jetik për të ardhmen e vendit tonë. Kosova si një vend i vogël duhet të jetë shumë e kujdesshëm për çështjen e monopoleve. Kompanitë e mëdha monopoliste kanë ditur që të vendosin politika tepër të rënda sa i përket çështjes së çmimit të produktit të tyre. Përvojat tregojnë se në vendet e varfra dhe ato në zhvillim, kompanitë e mëdha kanë influencuar edhe zhvillime të tjera. Prandaj, kjo qeveri ka për obligim që krahas këtij projekti të vazhdojë punën që ishte bërë për ngritjen e kapaciteteve humane për të qenë bashkëpjesëmarrëse në këtë projekt. Duhet të dimë se si ta valorizojmë minierën e Sibovcit, infrastrukturën energjetike që e posedojmë dhe si ta kapitalizojmë profitin e shitjes së energjisë elektrike. Po ashtu ne duhet të monitorojmë çështjet e mjedisit në bazë të standardeve të vendit tonë dhe të BE-së. Prandaj, ftojmë Qeverinë e Kosovës që të zhvillojë këtë projekt në kohën e duhur, në favorin e shtetit të Kosovës dhe të së ardhmes së qytetareve të saj. Resurset tona duhet të shfrytëzohen për interesat tona kombëtare. Çfarëdo vonese që bëjmë në shfrytëzimin e këtyre resurseve, Kosovën e lëmë në shkallë të ulët të zhvillimit ekonomik. Kështu si është, ajo do të jetë e varur nga vendet e rajonit dhe do të jetë tepër e vështirë që ne të kemi në një të ardhme të sigurt si shtet i ri në këtë pjesë të Evropës. Shteti i Kosovës ka rastin e mirë për të dalë nga kjo shkallë e varfërisë dhe për të hyrë në bashkësinë e popujve të zhvilluar. Tejkalimi i kësaj sfide varet vetëm nga ne! "Kosova C" është projekt jetik për të ardhmen e vendit tonë.

*(Autori është deputet i Kuvendit të Kosovës dhe nënkryetar i Komisionit kuvendor për energji)*

---

lime të mëdha rreth asaj se si ta formojnë qeverinë, detyra e së cilës do të jetë përgatitja e zgjedhjeve.

Diskutimet po ashtu janë përqendruar në kontrollimin e shërbimeve të sigurisë – një fushë kjo në të cilën as "Fatahu" dhe as "Hamasi" nuk kanë shumë hapësirë manovrimi. Për më tepër, ka mosmarrëveshje të shumta rreth sistemit zgjedhor që duhet përdorur.

Derisa "Fatahu" përkrah një sistem të votimit të shumicës, "Hamasi" kërkon një qasje më të personalizuar. Për më tepër, çështja e përfshirjes së "Hamasit" në Organizatën për Çlirimin e Palestinez (PLO) është jashtëzakonisht e rëndësishme. PLO-ja gjithnjë ka qenë i vetmi partner negocues me Izraelin dhe në të nuk përfshihet "Hamasi". Gjatë një debati që kishte të bënte me formulimet gjuhësore, "Hamasi" në bisedimet e mëparshme ka refuzuar që të "zotohet" për zbatimin e marrëveshjeve të arritura nga PLO-ja dhe Izraeli, duke thënë se megjithatë do t'i "respektojë" ato.

Negociatorët në Kajro duhet të merren vesh nëse do të jetë e pranishme një njohje e tillë indirekte e së drejtës së Izraelit për të ekzistuar.

Nën hijen e këtyre pazarllëqeve politike, përfaqësuesit e "Fatahut" dhe të "Hamasit" janë të ngarkuar me gjetjen e mënyrave për pajtimin e ideologjisë së popullarizuar politike të "Hamasit" me aspiratat tradicionale laike të "Fatahut". Kjo nuk është thjesht një çështje e brendshme palestineze, pasi që paraqet një konflikt që mbretëron në tërë Lindjen e Mesme.

Deri tani asnjë shoqëri arabe nuk ka arritur t'i harmonizojë këto trende të kundërta. Në vend të kësaj, pjesa më e madhe e qeverive janë mundur që ta gjejnë një qasje më pak konfrontuese të shtypjes dhe përjashtimit, duke i ndaluar islamikët të marrin pjesë në zgjedhje. Megjithatë, rasti me territoret palestineze është rast tjetër.

Në mungesë të një autoriteti të fuqishëm qendror, ndasia midis nacionalizmit laik dhe fesë së politizuar ka shkaktuar ndarjen gjeografike të territoreve palestineze në dy pjesë. Duke i pasur parasysh vështirësitë me të cilat përballen edhe protagonistët kryesorë të rajonit kur është fjala për Islamin politik, është duke u bërë e qartë se për Autoritetin Palestinez të udhëhequr nga Abbasi vetëm kompromisi dhe dialogu janë mënyrë për tejkalimin e ndasive.

Joçuditërisht, fati i bisedimeve në Kajro është i paqartë. Dështimi për harmonizimin e qëndrimit palestinez pa dyshim se do të shkojë në favor të qeverisë së porsazgjedhur izraelite të Benjamin Netanyahut. Mbi të gjitha, kryeministri izraelit e ka bërë të qartë se ai favorizon menaxhimin e vazhdueshëm të konfliktit në formë të "paqes ekonomike" e jo proceset politike, të bazuara në respektin reciprok dhe bashkëpunimin.

Përballë përçarjeve të brendshme, shtyrja përpara e procesit paqësor është shumë e vështirë për palestinezët. Si pasojë e kësaj, zgjerimi izraelit përmes kolonive në Bregun Perëndimor mund ta varrosë përfundimisht përpjekjen për paqe gjithëpërfshirëse.

Megjithatë, edhe suksesi në Kajro mund të përcillet me sfida. Nëse negociatat përfundojnë me krijimin e një qeverie palestineze, të mbështetur si nga "Fatahu", ashtu edhe nga "Hamasi", atëherë perëndimorët duhet ta marrin një vendim të vështirë. Ata duhet të vendosin nëse do ta vazhdojnë politikën e tyre të bojkotimit financiar dhe politik të "Hamasit" apo nëse do të kenë një qasje tjetër.

Duke pasur parasysh ideologjinë e "Hamasit", çfarëdo ndryshimi i qasjes së Perëndimit kundrejt këtij grupi në rast të suksesit në Kajro do të jetë i vështirë. Mirëpo një qëndrim i modifikuar dhe pragmatik që përqendrohet në sjelljen e "Hamasit" në terren, e jo në kushte abstrakte, do të jetë i domosdoshëm jo vetëm për vendimmarrësit perëndimorë, por edhe për "Hamasin".

*(Autori është drejtor i zyrës së fondacionit "Friedrich Ebert" në Jerusalemin Lindor, fondacion ky politik i lidhur me Partinë Socialdemokratike gjermane. Ky vështrim është shkruar ekskluzivisht për rrjetin e gazetarisë "Project Sindycate", pjesë e të cilit është edhe "Koha Ditore")*

---

Opinion

# Kujt ia shtrenjtoi KEK-u rrymën?

Dhjetë vjet pas luftës KEK-u vazhdon të mos e përfillë e të mos i respektojë qytetarët që paguajnë rregullisht rrymën.

Dhjetë vjet paguesit e rregullt të rrymës, që janë diku 35%, paguajnë rrymë jo vetëm për vete, por edhe për:
- pagat e punëtorëve të KEK-ut
- për serbët që nuk paguajnë rrymë
- për importin e rrymës
- paguajnë për ata që nuk paguajnë rrymë
- paguajnë 3,5 euro për RTK-në

Dhe çka ndodh tani?!

KEK-u vendos ta ngrejë çmimin e rrymës pikërisht për këta 35 për qind të qytetarëve, të cilët 10 vjet me radhë janë viktima të KEK-ut. Këta qytetarë paguajnë rrymë jo se e duan KEK-un, por sepse janë qytetarë që e dinë se duhet paguar dhe këtë e bëjnë nga mirësjellja e tyre. E këtë mirësjellje të qytetarëve KEK-u e kthen në mënyrën më të poshtër të mundshme, sepse shtrenjtimi i rrymës do të godasë mu qytetarin që paguan rrymën. Të tjerët do të vazhdojnë me avazin e vjetër.

Edhe unë jam viktimë e këtij 35- përqindëshi të qytetarëve. Sot ata që nuk paguajnë rrymë ndoshta kanë rrymë edhe pse me reduktime, e serbët e kanë fatin që ne ua paguajmë rrymën. Prandaj, të dashur qytetarë, ne kemi rryme sepse 35 për qind e paguajnë importin e rrymës e jo se KEK-u dhe punëtorët e tij prodhojnë rrymë për ne.

*Shqipe Mehmeti*

---

**Rubrika e përhershme "Shprehu" është krijuar si hapësirë e "Kohës ditore" për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve. Të gjitha shkrimet nuk duhet të jenë më të gjata se 500 fjalë. Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës. Opinionet e shprehura në këtë rubrikë nuk përfaqësojnë qëndrimet e redaksisë.**

Rritet numri i përdoruesve të lëndëve narkotike

# Të rinjtë kosovarë përherë e më të varur nga droga

**Policia dhe psikologët alarmojnë për një rritje të dukshme të konsumimit të lëndëve narkotike në Kosovë, sidomos te të rinjtë. Zëdhënësi i Policisë, Arbër Beka, thotë se në bazë të statistikave që ka policia, duke krahasuar me fazën e parë tremujore të vitit 2008 dhe tremujorin e këtij viti, vërehet shtimi i rasteve të raportuara të narkomanisë**



PRISHTINË, PRILL – Pa pasur asnjë informacion për emrat dhe llojet e drogave, M. I. nga Prishtina e kishte provuar "pluhurin e bardhë" për herë të parë në moshën 15-vjeçare. Këtë e kishte bërë në mëhallën e tij, në një lagje të Prishtinës, pasi u kishte marrë lakmi moshatarëve të vet.

"Para tetë vjetëve kam filluar të merrem me drogë. Kjo ka filluar krejt rastësisht, duke dalë me shoqëri në mëhallë", shprehet M .I ., personi i cili ka qenë "rob" i substancave narkotike plot tetë vjet.

Duke rrëfyer për përjetimet gjatë " viteve të ferrit", M . I. shprehet për gazetën se ka qenë përdorues i të gjitha llojeve të drogës, duke filluar nga marihuana, extasy, e deri tek heroina.

"Ajo çka më ka shtyrë te këto lloj substancash ka qenë mosinformimi i mirë lidhur me drogën. E kam marrë si asgjë duke mos menduar se më vonë do të kaloj në droga të tjera dhe se do të përfundoj keq", ka treguar M. I., i cili tash 3 vjet është rehabilituar dhe ka përfunduar së konsumuari lëndë narkotike.

"Të gjitha llojet i kam përdorur, mirëpo heroinën e kam përdorur pak më rrallë, një herë në javë, ndërsa të tjerat i kam përdorur çdo ditë", shprehet 23-vjeçari M. I.

Terapia e tij për shërim nga droga ka zgjatur plot tre vjet. Ai tash punon si edukator në qendrën për tretman dhe parandalim të drogës, ndërsa bën të ditur se disa nga shokët e tij ende janë të varur nga droga.

Mirëpo jo vetëm disa nga shokët e tij e kanë këtë telash.

Policia dhe psikologët alarmojnë për një rritje të dukshme të konsumimit të lëndëve narkotike në Kosovë, sidomos te të rinjtë. Zëdhënësi i Policisë, Arbër Beka, thotë se në bazë të statistikave që ka policia, duke krahasuar me fazën e parë tremujore të vitit 2008 dhe tremujorin e këtij viti, vërehet shtimi i rasteve të raportuara dhe të iniciuara nga Policia e Kosovës, konkretisht sektori antinarkotik , si në nivelin e Drejtorisë së përgjithshëm të policisë, ashtu edhe në nivelin e drejtorive rajonale.

Beka shprehet se në tremujorin e parë të vitit të kaluar kanë pasur 51 raste të kapjes së lëndëve narkotike, ndërsa në këtë tremujorë numri i rasteve me substanca narkotike është ngritur në 57 raste. Po ashtu, edhe numri i të dyshuarve këtë vit është më i madh. Sipas tij, numri i rasteve me substanca të ndryshme narkotike vitin e kaluar ka qenë 95 raste, ndërsa këtë vit ka arritur në 108 raste.

"Në bazë të statistikave që kemi ne, shihet se është një rritje e numrit të konfiskimeve që pasqyron edhe rezultatet e hetuesve të policisë së Kosovës", bën të ditur zëdhënësi Beka .

Sipas tij, Njësia e policisë në komunitet, në bashkëpunim me organizatat e tjera joqeveritare kanë pasur ligjërata nëpër shkolla të mesme dhe fillore për t'u treguar të rinjve aspektet negative të drogës.

"Këto konfiskime të lëndëve narkotike janë rezultat i hetimeve dhe i angazhimeve të policisë", pohon, Beka.

## 12 - 15 vjeç

Ndërkaq, shefi i Repartit për trajtimin e fenomeneve të varësisë në Spitalin Psikiatrik në Prishtinë, Shaban Mecinaj, ka thënë se numri i pacientëve që kërkojnë ndihmë, për shkak të varësisë së përdorimit të substancave narkotike, është në rritje.

"Më brengos fakti se mosha, e cila është më e rrezikuar nga droga, u takon të rinjve prej moshës 12 deri në 15 vjet, disa prej tyre madje fillojnë edhe me substanca të tjera më të forta, siç është heroina. Mirëpo grupmosha më e rrezikuar që kanë krijuar varësi nga heroina është ajo nga mosha 18 deri në 25 vjet", ka thënë Mecinaj.

Lloji i drogës që përdoret më së shumti nga të rinjtë kosovarë, sipas tij, është marihuana, e cila zakonisht përdoret në fillim të përdorimit të këtyre substancave.

"Është shumë vështirë të flitet me përqindje, mirëpo mund të themi se numri i tyre brenda një viti sillet rreth 60 deri në 70 pacientë të shtrirë në spital, ndërsa po aq pacientë vijnë vetëm për vizitë", ka thënë Mecinaj.

Ndërkohë, numri i pacientëve të cilët janë të hospitalizuar në këtë repart, sipas tij, në tremujorin e parë të këtij viti, është 17 persona.

Ai ka theksuar se arsyet, të cilat i shtyjnë që këta të rinj të marrin substancat narkotike janë ato të aspektit social dhe psikologjik, aspekte këto, sipas tij, të cilat kanë një prioritet në shoqërinë kosovare.

"Kjo shoqëri ka përjetuar luftë, krizë të madhe ekonomike, është shoqëri pa perspektivë, dhe të gjitha këto paraqesin një ambient të përshtatshëm që këta persona, të cilët duan t'i ikin realitetit të dhimbshëm, të merren me drogë", ka thënë Mecinaj. "Paaftësia e shoqërisë që ta integrojë rininë, si në shkollë, në punë, ashtu edhe në aktivitete të tjera, i sjell këto rezultate".

Edhe Safet Blakaj, drejtori i qendrës "Labyrint" , qendër kjo për trajtim dhe parandalim të drogës, thotë se dy vitet e fundit vërehet një rritje e dukshme e numrit të përdoruesve të drogës.

"Sipas tremujorit të parë numri i përdoruesve të lëndëve narkotike gjithnjë e më shumë po rritet, mosha e përdoruesve gjithnjë e më shumë po bie në atë më të re. Kjo dukuri po përhapet nga qendra e qytetit në viset rurale", thekson ai.

## Numri sa vjen e shtohet

Pacientët të cilët vijnë në këtë qendër, sipas tij, janë përdorues të shumtë të marihuanës.

Vetëm në muajin janar të këtij viti në këtë qendër janë paraqitur për herë të parë njëzet persona, numër ky dukshëm më i madh se i viteve të kaluara. Mesatarja e personave të paraqitur në këtë qendër, sipas tij, vitet e kaluara për muaj ka qenë dhjetë persona, ndërsa këta tre muaj është rritur në dymbëdhjetë persona. Faktori kryesor që i shtyn të rinjtë të bëhen përdorues të këtyre lëndëve, sipas Blakajt, është mungesa e programeve parandaluese të përdorimit të drogave.

Dafina Muçaj, psikologe në qendrën "Labyrint", thotë se prej vitit 2002, të funksionimit të kësaj qendre, numri i personave që kërkojnë ndihmë në këtë qendër gjithnjë është në rritje. Ajo çka është më e rëndësishme, sipas saj, është fakti se secilën herë personat që kërkojnë ndihmë janë të moshës më të re. Sipas Muçajt, mosha mesatare e përdoruesve të lëndëve narkotike është ajo e moshës 26-vjeçare, ndërsa ajo më e reja i përket moshës 13 dhe 14-vjeçare.

*Gita Lushi*

Qeveria shqiptare ia lë Kuvendit miratimin e kontratës për licencën e operatorit të katërt të telefonisë celulare

# Kuvendi i Shqipërisë të vendosë për ofertën e PTK-së

KOHA Ditore *BASHKIM SHALA*

TIRANË ME 18 PRILL - Qeveria e Shqipërisë lë në dorë të parlamentarëve miratimin e kontratës së operatorit të katërt të telefonisë celulare në Shqipëri, ku konkurrenti i vetëm është Postë-Telekomi i Kosovës. AKEP-i (Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare) është institucioni që shpall fituesit e tenderëve për të tilla raste, por për rastin e Postë-Telekomit të Kosovës, qeveria shqiptare ka vendosur një tjetër standard për të miratuar tenderin e celularit të katërt.

Në fillim të marsit u zhvillua faza e dytë e tenderit për marrjen e licencës së operatorit të katërt të telefonisë celulare në Shqipëri, ku u paraqit vetëm Postë-Telekomi i Kosovës, ndërsa pasi konkurrenti tjetër, kompania "Univers PG" është tërhequr nga gara, për shkak se dokumentacioni i saj nuk ka qenë i plotë. AKEP duke qenë së në garë mbeti vetëm një konkurrent ka shtyrë afatin për shpalljen e fituesit të tenderit për operatorin e katërt të telefonisë mobile në Shqipëri. Por, oferta e dhënë nga PTK-ja në shumën prej 7,2 milionë euro ishte fituese në krahasim me ofertën tjetër. Për të mos humbur mundësinë e anulimit të tenderit dhe rihapjen e procedurave të reja, që do të sillnin vonesa të tjera, qeveria shqiptare ka gjetur një rrugë tjetër. Ajo ia ka lënë Kuvendit të miratojë kontratën për futjen e celularit të katërt në vend. Në ligj përcaktohet se konsorciumit të përfaqësuar nga PTK-ja i jepet e drejta e përdorimit të frekuencave të shërbimit GSM për 15 vjet, me një vlerë prej 7,2 milionë eurosh. Në kushtet e kontratës parashikohet që pas miratimit, konsorciumi të paguajë paratë brenda një afati prej 7 ditësh. Ligji parashikon edhe mosshitjen e licencës derisa ky konsorcium të plotësojë kushtet afatgjata të mbulimit të territorit me sinjal në masën 85 për qind dhe të popullatës në masën 95 për qind.

Qeveria e Shqipërisë është e interesuar që tenderi të fitohet nga PTK-ja duke shpjeguar edhe arsyet pse kontrata duhet të miratohet nga parlamenti. Arsyeja e parë është vlera, e cila është 45 për qind më e lartë se oferta tjetër. Nga ana tjetër, qeveria nënvizon se kushtet aktuale të krizës botërore e bëjnë të vështirë deri të pamundur gjetjen e një oferte tjetër nga investitorë të huaj. Arsye e tretë tjetër është koha, thonë zyrtarët. Sipas qeverisë, në ekonomi vonesat shkaktojnë gjithnjë humbje. Në këtë rast buxheti humb paratë e shitjes, ekonomia një investim të huaj dhe qytetarët konkurrencën në tregun e celularëve dhe, si rrjedhojë, uljen e çmimeve dhe shtimin e shërbimeve.

Mirëpo, opozita ka qenë kritike. Më i zëshmi ka qenë nënkryetari i grupit parlamentar të socialistëve, Erion Braçe.

"Procesi i tenderimit për dhënien e licencës për operatorin e katërt të telefonisë celulare në Shqipëri është thellësisht jotransparent dhe jashtë vëmendjes, qoftë të publikut, qoftë edhe të interesuarve, ai nuk është në kohën e duhur, jo në interes strategjik dhe në fund ai është thellësisht klientelist", ka theksuar ai. "Po ju them që të listuar në atë kompani që është paraqitur e para në tender janë 5 klientë të Qeverisë së




Republikës së Shqipërisë, mes të cilëve asnjëri i marrë më parë me veprimtari të telefonisë celulare dhe mbi të gjitha njëri prej tyre është kompani shitjesh pijesh energjike ose pijesh alkoolike në Shqipëri dhe ne Ballkan".

Në përgjigje të akuzave të Braçes, ministri i Punëve Publike dhe Telekomunikacioneve, Sokol Olldashi, ka theksuar se qeverisë nuk i intereson se me kë futet në bashkëpunim Posta e Kosovës.

"Ka një vendim të qeverisë së Kosovës për të autorizuar Postën e Kosovës të marrë pjesë në procedurat për GSM-në e katërt në Shqipëri. Nëse Posta e Kosovës apo cilido investitor tjetër futet në një procedurë i vetëm, me aksionarë apo me 'joint venture', kjo nuk është përgjegjësi e jona, por është përgjegjësi e investitorit", ka theksuar Olldashi.




Autoritetet e "Prenk Jakovës" kanë depozituar në komunë kërkesën e zgjerimit të veprimtarisë

# Shkolla e Mesme e Muzikës, nevojë për Gjakovën e traditës

**Astrit Pallaska, ka theksuar të dielën se e ka bërë kërkesën në komunë dhe se e sheh si nevojë të jashtëzakonshme hapjen e Shkollës së Mesme të Muzikës, pasi të ndërtohet objekti i ri i Shkollës së Ulët të Muzikës, ndërsa komuna e ka mirëkuptuar kërkesën, duke thënë se ka mbështetje nga MASHT-i**

KOHA Ditore *Gazmend Doli*

Gjakovë, 19 prill - Në Gjakovë prej shtatorit pritet të startojë Shkolla e Mesme e Muzikës, për të parën herë në histori të saj. Autoritet e shkollës së ulët "Prenk Jakova", kanë pohuar se tashmë është depozituar një kërkesë e tillë në Komunën e Gjakovës dhe se pretendojnë që nga fillimi i vitit të ri, në këtë vatër arsimore të nisë edhe Shkolla e Mesme e Muzikës. Ndërsa të këtij mendimi, ndërkohë janë shprehur edhe autoritet e komunës, të cilat kanë thënë se kanë edhe përkrahjen e Ministrisë së Arsimit. Kjo e fundit ka investuar një objekt të ri, i cili pritet të përfundojë pas disa muajsh. Kjo edhe ka nxitur autoritet e Shkollës së Ulët të Muzikës që në këtë vend të hapet edhe Shkolla e Mesme e Muzikës...

Astrit Pallaska, drejtor, ka thënë të dielën se ka bërë kërkesën në KK. "Shkolla jonë e sheh si nevojë të jashtëzakonshme hapjen e shkollës së mesme", thotë Pallaska. "Duke e pasur parasysh se objekti kushtuar shkollës sonë përfundon në gusht, atëherë ne si shkollë shohim shumë të nevojshme hapjen apo vazhdimin e shkollimit të mesëm", pohon ndërkaq ai.

Pos objektit dhe infrastrukturës ndihmëse që do të ofrojë kjo shkollë me të përfunduar, sipas Pallaskës, shkolla ka edhe kuadrin profesional. Interesimi për hapjen e Shkollës së Mesme të Muzikës ekziston edhe në Komunën e Gjakovës. Madje, aty thonë se kanë edhe përkrahjen e Ministrisë së Arsimit.

"Komuna e ka prioritetet e veta që këtë viti të nisë me Shkollën e Mesme të Muzikës, për herë të parë në komunën tonë", ka pohuar Anton Shala, drejtor i Arsimit. "Ne mendojmë se tashmë janë krijuar kushtet edhe teknikisht që të nisë ky proces për Shkollën e Mesme të Muzikës", ka theksuar ai.

Për këtë ai shprehet se ka mbështetjen edhe të Ministrisë së Arsimit.

"Ne kemi edhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit. "Gjatë takimeve të shumta të mëhershme edhe ministri i Arsimit ka shprehur gatishmërinë, që në Gjakovë si një qytet me trashëgimi në kulturën muzikore të përkrahë hapjen e shkollës së mesme", thotë Shala. "Kjo tashti mbetet definitivisht çështje teknike", shprehet ai.

Komuna, sipas tij, i ka krijuar kushtet më herët, kur ka pranuar në punë disa kuadro të reja. "Paraprakisht ne I kemi bërë përgatitjet, pasi kemi pranuar një kuadër shtesë të kualifikuar dhe aktualisht Drejtoria e Arsimit është duke i bërë përgatitjet, që kjo shkollë të bëhet edhe me arsim të mesëm", ka përfunduar ai.

Gjakova ka një traditë të pasur në kulturën muzikore, prej dekadash, ndërsa shumë kuadro, kanë bërë emër jo vetëm në Kosovë, por edhe në shtete të ndryshme të Evropës. "Prandaj, ky është një fakt më shumë pse Komuna e Gjakovës meriton që më në fund të bëhet me shkollë të mesme", ka thënë në fund drejtori, Astrit Pallaska.



Gjakova ka një traditë të pasur në kulturën muzikore prej dekadash, ndërsa shumë kuadro kanë bërë emër jo vetëm në Kosovë, por edhe në shtete të ndryshme të Evropës, kanë thënë zyrtarë arsimi

## Fotolajm



**Gjakovë, 18 prill - Mungesa e kapakëve të pusetave mbetet "pika e zezë" në infrastrukturën rrugore të Gjakovës. Në pjesë të ndryshme të qytetit mungojnë ata, ndërsa në shumë raste po bëhen problem për qarkullim automjetesh. Dukagjin Hasi, një qytetar i Gjakovës, thoshte se sheh çdo ditë automjete bien në këto puseta. Komuna e Gjakovës në planet e saj buxhetore ka paraparë që të shpenzojë mjete edhe për mbulimin e tyre. Mirëpo, deri tashti ato vazhdojnë të mbesin ashtu siç ishin, ndërsa po rrezikojnë, jo vetëm shoferët, por edhe kalimtarët. (G.D.)**

Ditën e tregut në Rahavec, më shumë shitës sesa blerës

# Pafuqia blerëse - pasqyrë e gjendjes ekonomike

**Tregtarët ankohen për mosshitje prodhimesh, blerësit për pafuqi blerëse, ndërsa që të dytë pasqyrojnë gjendjen e rëndë ekonomike të komunës, shprehen qytetarët**

KOHA Ditore *Bejtullah Sokoli*

Rahavec, 19 prill – Ditën e tregut në Rahavec, më shumë dominojnë shitësit sesa blerësit dhe që të gjithë ankohen, si shitësit, ashtu edhe blerësit. Të parët thonë nuk ka shitje, të dytët shprehen se u ka rënë fuqia blerëse. Kjo pasqyron më së miri gjendjen dhe krizën ekonomike. Në tregun e Rahavecit, pra, dominon refreni i shqiptuar: "Ka ra fuqia blerëse…" Po duhet t'i lus shumë e mezi arrij ta shes këtë thes me fasule, të cilin e prodhoj vetë për të jetuar disi", shprehej të shtunën, Hidajet Hamza, rreth të 30-ve. Ndërkaq, në stendën e mbushur me pemë e perime, thoshte se çmimet nuk janë aq të larta, por njerëzit kanë pak fuqi blerëse. Hamza shprehej se 10 vjet ushtron këtë zanat, ndërsa tregon se, krahasuar me vjet, 10 për qind ka rënë puna dhe këtë ai e sheh si pasojë e papunësisë së madhe.

Inxhinieri i bujqësisë, Nadir Durguti, kishte ekspozuar të shtunën, në një cep toke prodhimet e tij për t'i shitur. "Çdo ditë tregu dal kështu, por s'ka shitje, është kriza e madhe besoj se nuk i shes shtrenjtë perimet e mia, të cilat i kultivoj në një sipërfaqe prej 60 arësh, deklaronte Durguti, njëherësh profesor bujqësie në SHM "Xhelal Hajda-Toni" dhe shtonte se prodhimet e tij si spinaqi, qepët e reja, fasulja, patatet e lakrat nuk janë me çmime të larta. Ai rrëfente se me punë bujqësie mban familjen 4-anëtarëshe.



Tregu i Rahavecit me shumë shitës prodhimesh bujqësore, e me pak blerës, tablo e një situate të vështirë ekonomike

Edhe blerësit pranonin se nuk ka ngritje çmimesh, por shpreheshin se edhe me ato çmime zor të bliheshin artikujt e përditshëm. "Është papunësi e madhe, nuk punoj askund, ku me i marrë paratë me i mbushë qeskat me zarzavate ushqimore", shprehej 43-vjeçari Behajdin Çanta që kishte dalë në treg për t'u furnizuar. Çanta thoshte se është i regjistruar tashmë 20 vjet në Zyrën e punësimit, por pa dobi fare. Edhe qytetari Vllaznim Isma kishte dalë në treg me shpresën se do të mund të furnizohej me çmime më të lira. "Jo, nuk bleva asgjë që pata ndërmend, sepse çmimet ishin të njëjta me ato nëpër minimarkete", pohonte ai.

Ndryshe, tregu i gjelbër, i bulmetrave, i plaçkave, i kafshëve dhe i shpesëve, vazhdojnë të funksionojnë çdo të shtunë në 3 rrugë të kryqëzuara të qytetit me 25 mijë banorë, "Sulejman Vokshi", "Gëzim Hamza-Piktori" dhe "Bajram Veliu". Por jo në vende higjienike. Malsor Morina, shitës bulmetrash nga Sopaj, shprehej kur nuk ka treg, atëherë detyrohemi të shesim në rrugë. "Le të ndërtojë Komuna tregun e gjelbër, ne shesim atje", thoshte Morina, ndërsa ankohej se paguante dulinë 050 deri 1 euro. Ndërkohë, lidhur me këto mjete, para më shumë se 3 vjetësh, KK-ja e udhëhequr nga LDK-ja pati bërë përpjekje të caktonte një lokacion për ndërtimin e tregut, por deri tashti gjithçka ka mbetur vetëm në letër. Ndërsa, Qeveria aktuale lokale ndërtimin e tregut të gjelbër, tashmë një vit qeverisjeje, këtë çështje nuk e ka vënë në shqyrtim në legjislativin e saj me arsyetimin se ende nuk ka një lokacion ku do të ndërtohej tregu.

Nuk ka asnjë rast të etheve hemorragjike në këtë periudhë të vitit në rajonin e Prizrenit

# Preventiva kundër rriqrave - edukimi i popullatës

**Ka raste të pickimit nga rriqrat, por nuk ka të sëmurë me ethe hemorragjike në rajonin e Prizrenit, kanë njoftuar zyrtarë të Institutit të Shëndetit Publik. Ata kanë theksuar se punohet në planin parandalues kundër rriqrave**

KOHA Ditore *Ramadan Baraliu*

PRIZREN, 19 PRILL - Megjithëse vjet në fund të muajit mars në rajonin e Prizrenit ishin paraqitur rastet e para me ethet hemorragjike, këtë përudhë të vitit ende nuk është paraqitur asnjë rast i tillë. Por ka raste të pickimit nga rriqrat në institucionet shëndetësore të rajonit të Prizrenit, i cili konsiderohet si zonë endomiko-epidemike e kësaj natyre. Nyrishahe Hula, drejtoreshë e Institutit të Shëndetit Publik në Prizren, ka bërë të ditur se në këtë rajon ende nuk është evidencuar asnjë rast me ethet hemorragjike. Por instituti ka nisur aktivitetet në parandalimin, për informim dhe edukim të komunitetit në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, strukturat komunale dhe institucionet shëndetësore të këtij rajoni si masë preventive. Ajo ka bërë të ditur se aktivitetin e kanë nisur fillimisht në Komunën e Malishevës, dhe se në këtë komunë që nga 17 marsi i këtij viti janë paraqitur 17 raste të pickimit nga rriqrat. "Më 2009, meqenëse sëmundja është sezonale, ende nuk kemi rate të konfirmuara, zyrtare dhe të evidencuara si raste të dyshimta me ethet hemorragjike. Por më 16. 4. 2009, ekipi i ISHP-së ka shkuar në Malishevë në QKMF dhe ka zhvilluar një takim pune me strukturat e QKMF-së dhe ka marrë informata lidhur me gjendjen e rasteve të pickuara nga rriqrat. I kemi mjetet dhe metodat për këtë qëllim dhe ekipet janë të përgatitura profesionalisht të cilat tashmë janë në veprim", ka bërë të ditur Hula. Ajo ka vënë në pah sa kanë filluar takimet informuese dhe edukuese me nxënësit nëpër shkolla fshatrash të Malishevës dhe se do të vazhdojnë edhe në komunat e tjera të rajonit të Prizrenit. Edhe në Komunën e Suharekës kanë filluar të paraqiten rastet e para të pickimit nga rriqrat. 8 raste nga pickimi i rriqrave janë paraqitur në QKMF të Suharekës, mirëpo Hidajete Haliti, drejtoresh e kësaj qendre, ka thënë se ato kanë qenë raste të zakonshme dhe nuk ka shenja ethesh hemorragjike. "Kanë nisur të paraqiten rastet e para të pickimit nga rriqrat. Jemi të përgatitur me mjetet mbrojtëse dhe i kemi protokollet që na i ka sjellë Instituti i Shëndetit Publik si të veprojmë në trajtimin e pacientëve që pickohen nga rriqrat", ka bërë të ditur Haliti. Ndërkaq edhe në Spitalin Rajonal të Prizrenit, në Repartin Infektiv, janë paraqitur disa të pickuar nga rriqrat, kurse lidhur me këtë, Beran Karalezi, shef i këtij reparti thotë se ato janë raste të zakonshme dhe se nuk ka shenja ethesh hemorragjike. Ndërsa Hula nga ISHP-ja në Prizren ka shtuar duke thënë se nëse do të ketë konfirmim zyrtar dhe nëse rastet paraqiten në QKMF-të e rajonit, rastet e dyshimta dërgohen në QKUK në Prishtinë. Vjet janë paraqitur gjithsej 35 raste të infektuar me ethe hemorragjike në rajonin e Prizrenit, ndërsa një i moshuar nga Hasi i Prizrenit kishte vdekur. Pjesa më e madhe e të infektuarve kishte qenë nga Komuna e Malishevës, në të cilën ishin paraqitur 28 raste me ethe hemorragjike, ndërsa nga Suhareka të infektuar kishin qenë 4 persona, nga Prizreni 2, ndërsa 1 rast nga Rahoveci. Hula ka rikujtuar se rasti i parë me ethe hemorragjike në rajonin e Prizrenit ishte paraqitur në vitin 1954 në fshatin Nishor të Suharekës.



**Në Repartin Infektiv janë paraqitur disa të pickuar nga rriqrat, por Beran Karalezi, shef reparti, thotë se ato janë raste të zakonshme, nuk ka shenja ethesh hemorragjike**

Dresnikasit e Klinës të dëshpëruar për rrugën, e cila po u shkakton telashe, sidomos nxënësve

# Pesëmbëdhjetë familje në pritje të asfaltimit të rrugës

**Dedë Dedaj, përfaqësues i fshatit Dresnik i Poshtëm, ankohet se që pas përfundimit të luftës kishte bërë kërkesë për asfaltimin e rrugës 2 kilometërshe. Por për të nuk është intervenuar madje as me zhavorr. Ndërkaq zyrtarët komunalë shprehen se do të intervenohet por jo me asfalt për shkak të ngërçeve buxhetore**

KOHA Ditore *Agron Gashi*

KLINË, 19 PRILL- Fshati me i afërt i Klinës, që mund të llogaritet edhe si paralagje e qytetit, Dresniku i Poshtëm, ka mbetur pa rrugë të asfaltuar madje në të nuk është intervenuar pas kohës së luftës as me zhavorr. Janë 14 familje Prenaj të cilat me shumë peripeci duhet të kalojnë rrugës së dëmtuar deri në Klinë. Ato janë mu në mes fshatit Dresnik dhe Klinë dhe duhet ta përshkojnë rrugën e dëmtuar. Nëpër këtë rrugë kalojnë edhe fëmijët e Dresnikut që ndjekin mësimet në Klinë nga ata parafillorë deri në të nëntën. Shumë kërkesa të këtij fshati dhe familjeve Prenaj, nuk janë dëgjuar as nga LDK-ja e as tashti PDK-ja. Ndërkohë zyrtarët e komunës, thonë se janë marrë vesh me KFOR-in për të intervenuar në këtë rrugë me zhavorr. Përfaqësuesi i Dresnikut, Dedë Dedaj, ankohet se rruga vetëm 2 km do të ishte një lehtësi e madhe për banorët deri në Klinë derisa për t'iu shmangur kësaj rruge plot me gropa banorët detyrohen të kalojnë nëpër Dresnikë të Epër ku pjesa dërmuese e banorëve janë serbë dhe duhet të kalojnë 5 km deri në Klinë.

Fshati Dresnik i Poshtëm ka 37 familje shqiptare, 5 ashkali dhe 8 serbe me rreth 500 banorë. Ndërsa në Dresnikun e Epër para lufte kanë qenë 150 shtëpi serbe janë ndërtuar 40 sosh, 13 jetojnë aty ndërsa të tjerat janë të zbrazëta. " Para lufte serbët kanë qenë në privilegjuar. Ata kanë telefon e asfalt e rryme e ne jo", ankohet Dedaj sipas të cilit edhe pas luftës po vazhdon e njëjta gjë. "Familjeve serbe deri të dera e shtëpisë ua kanë asfaltuar rrugën, ndërsa ne shqiptarëve jo", thotë Dedaj. "Asnjë lopatë zhavorr s'na ka dhënë pushteti as ai i LDK-së as ky i PDK-së", tregon Dedaj. Shprehet se në projektin e kthimit në vitin 2005 shkruan se janë rindërtuar 5 shtëpi për shqiptarët, mirëpo realiteti është ndryshe, sepse nuk ka ndodhur një gjë e tille dhe mjetet janë "hangër" nga dikush. "Komuna na ka premtuar për asfaltimin e rrugës por s'ka bërë asgjë, dikujt asfalt e dikujt as zhavorr", ankohet Dedaj. Ai nder të tjera tregon se që nga viti 2004 kur janë pastruar mbeturinat nga shtëpitë e serbëve në fshatin Dresnik i Epër, bërlloku është hedhur afër shtëpisë së tij dhe tashti së fundi sllovenët kanë premtuar se do të pastrojnë atë hapësirë plot me hekura të ndryshëm. Dedaj ka nisur të humbë besimin të pushtetarët pasi që pos fjalëve të mira nuk ka asgjë konkrete. Sipas Dedajt, për rregullimin e rrugës 2 km deri në Klinë, nevojiten 450 kubikë zhavorr ose 45 kamionë, ndërsa komuna ka premtuar 10 deri 15 kamionë me rërë. " Fëmijët tanë shkojnë në shkollë nëpër rrugën me baltë kur bie shi", thotë ai.

Filip Prenaj, tregon se që pas vendosjes së tyre në këtë vend në rruga është ndërtuar në vitet e 70. "Kërkesa për rregullimin e kësaj rrugë daton që në vitet e 80, por askush nuk i është përgjigjur pozitivisht", thotë ai. Regjimi serb në vitet e 90, thotë Prenaj, ka kushtëzuar rregullimin e kësaj rruge me atë që shqiptarë e serbë të dilnin bashkë në meremetimin e saj për të dëshmuar gjoja marrëdhëniet e mira ndëretnike, por që shqiptarët nuk kanë pranuar. Sipas Prenajt, është turp për organet komunale që një rrugë 2 km se rregullojnë kur dihet se janë asfaltuar shumë rrugë madje edhe nga dy- tre herë. Janë 50 nxënës të këtij fshati që çdo ditë kësaj rrugë të dëmtuar shkojnë në shkollë nëpër baltë. Nga ana tjetër zyrtarët e KK-së, premtojnë se kjo rrugë do të rregullohet me zhavorr por tash për tash jo me asfalt. Ramiz Rrusta, nënkryetar i Klinës, tregon se bashkë me KFOR-in kemi arritur një marrëveshje për rregullimin e rrugës me zhavorr ku komuna do të sigurojë zhavorrin dhe mekanizmin rrafshues ndërsa KFOR-i transportin. Rrusta ua përkujton banorëve të Dresnikut të Poshtëm se kanë edhe rrugën e asfaltuar por pak me rrotull nëpër Dresnik të Epër. " Për ne të gjithë qytetarët janë të barabartë por edhe ata duhet të kuptojnë mundësitë tona buxhetore", thotë Rrusta.



**Dresnikasit, thonë janë të diskriminuar karshi serbëve, ndaj kërkojnë rrugën, e cila po u shkakton shumë telashe qarkulllimi**

## Fotolajm



**Kaçanik, 19 prill - Zjarrfikësit kaçanikas u kanë bërë një "dush" trotuareve dhe asfaltit të rrugës kryesore "Ismail Raka" në Kaçanik, të dielën. "Iniciativa për pastrimi rrugësh është e Drejtorisë së Emergjencës, ndërsa është mbështetur edhe nga stafi i SHIL-it që menaxhon me parkimin e kësaj rruge", ka theksuar Skënder Sopa, zyrtar i DESHP-it. (E.R.)**

### Vitia dhe Lipjani kanë përkujtuar dëshmorët

# E ardhmja e sigurt në themele të gjakut të dëshmorëve

*IBRAHIM SEFEDINI & ARIAN DURIQI*



Përkujtim në nderim të dëshmorëve të Pozheranit, të dielën

VITI, 19 PRILL - Janë përkujtuar të dielën dëshmorët e Pozheranit të Vitisë, me rastin e 10-vjetorit të rënies. Fillimisht është përkujtuar dëshmori i kombit Mejdi Korrani-Korri nga Pozherani dhe po ashtu edhe dëshmorët e këtij fshati të rënë në etapa të ndryshme të historisë më të re të shqiptarëve siç janë mr. Halil Alidema, Jeton e Naser Rama, Xhevat Qerimi, Samet Bogujevci si edhe i vrari Shefqet Mustafa. Kryetari i Vitisë, Nexhmedin Arifi, ka thënë se kujtimi për dëshmorët na mëson se si duhet të ndërtojmë të ardhmen dhe të ardhmen e kemi të sigurt sepse atë e kemi ndërtuar mbi themelet e gjakut të dëshmorëve. "E kaluara jonë e lavdishme është një pasuri e jona e përgjithshme prandaj duhet ta çmojmë atë", është shprehur kryetari Arifi. Ai ka theksuar se bazuar në këtë të kaluar institucionet qendrore dhe ato lokale janë duke punuar me përkushtim për zhvillimin e vendit. Ndërkaq kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se në këto ditë të dhimbjes dhe krenarisë kur përkujtohen dëshmorët, të cilët nëpër kohë të ndryshme i kanë kontribuuar çlirimit të vendit, të gjallët duhet të mbrojnë kontributin patriotik mbi të cilin është arritur liria. "Duhet të punojmë dhe të jemi të këmbëngulës që të mbrojmë parimet kombëtare në nivel vendi", është shprehur Haradinaj. Ai ka theksuar se këto vlera nuk i pengojnë askujt dhe mbi këto vlera duhet punuar në planin e procesit të integrimit në strukturat veriatlantike dhe në NATO."Të gjallët duhet të mbesin mbi parimet kombëtare me gjithë funksionin që ushtrojnë", ka përfunduar Haradinaj.

Ndërkaq edhe Hallaqi dhe Ribari i Vogël të Lipjanit kanë përkujtuar në fundjavë 47 të rënët e lirisë, të pushkatuar nga forcat serbe në prill 1999. Hallaqi, ndërkaq, ka 21 vrarë gjatë periudhës së luftës, ndërkohë që, Ribari i Vogël ka pasur 26 të vrarë. Në përkujtimet e ndara të këtyre 2 fshatrave është thënë se prilli gjithmonë për këto mjedise është muaji i kujtimeve, dhimbjeve, por edhe i krenarisë. Shukri Buja, kryetar i Lipjanit, është shprehur se të rënët gjatë luftës kanë qenë po ata që kanë kontribuar më së shumti për lirinë dhe shtetin e ri të Kosovës. "Ditët e prillit për komunën tonë janë ditë dhimbjesh e përkujtimesh, por njëherësh edhe ditë të krenarisë. Këtë muaj përkujtuam shumë të rënë për liri nga komuna jonë, përuruam komplekse memoriale, mbajtëm akademi dhe përkujtime në shenjë nderimi për gjakun e derdhur për lirinë që sot e gëzojmë", ka thënë Buja. Ndërkohë që, Xhemail Buzuku, duke folur në emër të Këshillit organizativ nga Hallaqi, ka thënë se ky ishte një fshat i bukës e i besës për ish - UÇK-në.

Ramadan Budakova, po ashtu anëtar i Këshillit organizativ, gjatë përkujtimit të mbajtur në Ribar të Vogël ka thënë se spiralja e dhunës serbe nuk la pa e goditur edhe këtë fshat. "Banorët ishin detyruar të zhvendoseshin nga shtëpitë e tyre për t'i shpëtuar më së keqes, por fatkeqësisht, forcat serbe vranë dhe masakruan 25 qytetarë të pafajshëm në Ribar, ndër ta edhe gra e fëmijë, nga mosha 10 deri në 90 vjeç", ka thënë Budakova. Në Ribar të Vogël, është përuruar edhe Kompleksi memorial i varrezave që ka kushtuar 23 mijë euro, kontribut nga Komuna e Lipjanit.

### Zhvillohen 2 aksione paralele në Malishevë

# Vaksinohen qentë shtëpiakë, vriten ata endacakë

**"Rabiesi (tërbimi) dhe paraziti i Ekinokokut, janë 2 sëmundje të rrezikshme që mund të barten nga qentë tek njerëzit dhe Shërbimi veterinar po ofron trajtime preventive kundër këtyre dy sëmundjeve pa kurrfarë pagese për vaksinimin e të gjithë qenve me pronësi, në mbarë territorin e Malishevës", ka njoftuar Robaj**

*REXHEP KRASNIQI*

MALISHEVË, 19 PRILL - Tashmë disa ditë në Komunën e Malishevës po realizohet programi për vaksinimin e qenve shtëpiakë. Por, të shtunën në këtë komunë ka nisur edhe eliminimi i qenve endacakë. Agjencia e Veterinarisë dhe e Ushqimit e Kosovës dhe KK i Malishevës, në bashkëpunim me Stacionin e Veterinarisë të kësaj komune këto ditë po realizojnë një program për kontrollimin dhe vaksinimin e qenve shtëpiakë. "Rabiesi (tërbimi) dhe Paraziti i Ekinokokut, janë dy sëmundje të rrezikshme që mund të barten nga qentë te njerëzit. Shërbimi Veterinar po ofron trajtime preventive kundër këtyre dy sëmundjeve pa kurrfarë pagese për vaksinimin e të gjithë qenve me pronësi, në mbarë territorin e Malishevës", ka njoftuar Avni Robaj, doktor i shkencave veterinere, që aktualisht është drejtor i Stacionit Veterinar në Malishevë. Aksioni, sipas Robajt, po realizohet në kuadër të fushatës preventive për ruajtjen e shëndetit të popullatës. Për mbarëvajtjen e aksionit, opinioni është sensibilizuar me afishe të shumta që janë shpërndarë me këtë rast, nëpër të gjitha rrugët dhe fshatrat e Malishevës. "Masa të këtilla parandaluese, janë mbrojtja më e mirë nga rreziku që kanoset nga Rabiesi dhe paraziti i Ekinokokut", ka vlerësuar Robaj. Ndërkohë, sipas burimeve nga Zyra e informacionit Publik të Malishevës, Drejtoria e Emergjencës dhe e Shërbimeve Publike e kësaj komune në bashkëpunim me Shoqatën e Gjahtarëve, të shtunën, kanë nisur eliminimin e qenve endacakë që planifikohet të bëhet në 18 vendbanime të Malishevës. Aksioni për eliminimin e qenve endacakë, sipas njoftimit, do të zgjasë 8 ditë, nga 18 deri më 26 prill. Bartësi i aksionit, Drejtoria e Emergjencës dhe e Shërbimeve Publike, ka marrë të gjitha masat e duhura në përgatitjen dhe koordinimin e të gjitha strukturave pjesëmarrëse për realizimin e këtij aksioni, thuhet në njoftimin e ZIP-it. Ditën e parë, sipas këtyre njoftimeve, në qytetin e Malishevës, janë vrarë 70 qenë endacakë, të cilët më pas janë grumbulluar dhe varrosur në një vend të sigurt. Burime nga terreni thonë se disa qytetarë në territorin e Malishevës po hezitojnë t'i dërgojnë qentë e tyre për vaksinim duke shprehur dyshime në mos vaksinat për qentë janë vrastare. Avni Robaj ka siguruar se nuk bëhet fjalë për diçka të tillë dhe se qëllimi i vetëm, sipas tij, është parandalimi i dy sëmundjeve të përmendura te qentë me pronarë dhe mosbartja e sëmundjeve te njerëzit. Aksioni për eliminimin e qenve endacakë, ndërkaq është nxitur nga debati i gjerë i ditëve të fundit për këtë problematikë që ka dalë pas mbytjes së një fëmije në Komunën e Kamenicës nga qentë.

## Shkurt...

### AAK-ja, LDK-ja dhe PDK-ja përforcojnë radhët, AKR-ja dhe LDD-ja heshtin

ISTOG, 19 PRILL - Partitë politike të Istogut, edhe pse nuk dihet saktësisht data e zgjedhjeve lokale, tashmë kanë nisur garën për përforcimin e radhëve të tyre. AAK-ja, LDK-ja dhe PDK-ja thonë se janë duke punuar në terren për zgjerimin e nëndegëve partiake, ndërsa LDD-ja dhe AKR-ja, siç duket, punojnë në heshtje për këtë qëllim, por nuk deklarohen haptas. "AAK-ja në Istog është duke punuar vazhdimisht në terren për përforcimin dhe shtimin e radhëve të veta. Në këtë javë ka formuar edhe një nëndegë të re në Cerrcë, ku interesimi për t'u anëtarësuar në këtë parti ka qenë i madh", thotë kryetari i Degës së AAK-së, Bekë Berisha. Ndërsa, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, të shtunën, në Cerrcë, ka kërkuar që sa më shumë të përkrahet AAK-ja, në mënyrë që Kosova të ketë një qeverisje më të mirë. Nga ana tjetër, LDK-ja është ndier e kënaqur se këtë javë ka përvetësuar një këshilltar komunal nga radhët e AKR-së. Kryesuesi i KK-së, nga radhët e LDK-së, Demë Çetta, aderimin e këshilltares së AKR-së në radhët e LDK-së, Valentina Morina, e ka vlerësuar si hap pozitiv në përforcimin e radhëve të LDK-së. Në terren për shtimin e radhëve të veta është duke punuar edhe PDK-ja dhe, sipas saj, punët janë më mirë se kurdoherë tjetër. "Jemi në aktivitet të përditshëm dhe punët janë duke shkuar mirë", thekson nënkryetari i PDK-së, Muhamet Kabashi. Derisa AAK-ja, LDK-ja dhe PDK-ja flasin haptas për rezultatet e tyre në drejtim të përgatitjes për zgjedhjet e ardhshme, AKR-ja dhe LDD-ja nuk kanë dhënë ndonjë koment për këtë çështje. ( S.B.)

### PDK-ja e Skenderajt nis projektin e rikonfirmimit të anëtarëve



SKENDERAJ, 19 PRILL - Ka nisur realizimi i projekti të PDK-së për rikonfirmimin e anëtarëve të partisë, si edhe anëtarësimin e anëtarëve të rinj, të dielën në Skenderaj. "Projekti, i hartuar nga PDK-ja në bashkëpunim me një ekspert amerikan, këshilltar i kryeministrit të Kosovës, do të zgjasë 6 javë, u bën thirrje qytetarëve për anëtarësim në PDK dhe mbahet në të gjitha degët e PDK-së në Kosovë", ka sqaruar Ramadan Gashi, kryetar i degës, i cili ka shtuar se kjo është përgatitje për fushatën elektorale. (A. M.)

### Dy anëtarë të AAK-së aderojnë në PDK

KAÇANIK, 19 PRILL - Dega e PDK-së në Kaçanik e ka nisur aktivitetin për regjistrimin e anëtarësisë së saj, ndërsa 2 anëtarë të AAK-së janë promovuar anëtarë të rinj të kësaj partie. Burim Bajra, anëtar i Kryesisë së Degës së AAK-së në Kaçanik dhe bashkëpartiaku i tij, Elham Bunjaku, e kanë firmosur fletanëtarsimin në PDK, të dielën. "Kam aderuar në PDK pasi kam ardhur në përfundim se në këtë parti do të jem më i vlerësuar dhe do të kem më shumë hapësirë për të kontribuar", është shprehur Bajra, në një konferencë shtypi. Ndërkaq, Xhabir Zharku, kryetar i Degës së PDK-së në Kaçanik, ka sqaruar se gjatë aktivitetit të sipërpërmendur, i paraparë të vazhdojë për 6 javë rresht, do të bëhet riregjistrimi i anëtarëve të vjetër dhe regjistrimi i aderuesve të rinj në parti. "Të gjithë atyre që nuk janë pjesë PDK do t'u ofrohet mundësia që ta përqafojnë programin dhe ofertën elektorale të partisë sonë", ka theksuar ai. Zharku, që është edhe kryetar komune, nuk e ka përjashtuar mundësinë që të jetë kandidat i PDK-së për kryetar të Kaçanikut edhe në zgjedhjet e sivjetme lokale. "Nëse strukturat e partisë kërkojnë nga unë që të kandidohem për kryetar komune, unë do të pranoj", ka thënë ai.

*(E.R.)*


Start
3.47 Euro pa TVSH
60 Min. FALAS brenda Telekomit
Standard
6.96 Euro pa TVSH
10 000 Min. falas brenda Telekomit dhe
10 Min. FALAS me Vala
Super
21.74 Euro pa TVSH
Pa LIMIT brenda Telekomit dhe
60 Min. FALAS me Vala
13.04 Euro pa TVSH
StandardPLUS
10 000 Min. falas brenda Telekomit,
10 Min. FALAS me Vala
ADSL 512
39.13 Euro pa TVSH
SuperPLUS
Pa LIMIT brenda Telekomit,
60 Min. FALAS me Vala
ADSL 2048
TK
vala
0.10 Euro / Min. gjatë Ditës
0.08 Euro / Min. gjatë Natës
TK
powered by PTK
www.telekomi.net
Shijo Komunikimin!


Starpako
Apliko tani!
Kalo rrogën n'TEB
20€ mirëmbajtje falas, kredi të volitshme
APLIKO PËR STARPAKO – ZGJIDHJE KOMPLETE BANKARE
Përfito – blerje me këste 0% kamatë, kurse 20 Euro mirëmbajtje, bonus 1% deri 8% për çdo blerje; oferta speciale për festa; kredi me vetëm 1.5% shpenzime administrative; Siguri të brendit më të fuqishëm bankarë në Kosovë
Kartela Starcard
Financoni blerjet tuaja me këste pa kamatë;
Fitoni bonus 1 për qind për çdo blerje;
Financoni blerjet tuaja deri 45 ditë pa kamatë.
20 € mirëmbajtje falas
Kredi
Vetëm 1.5 për qind shpenzime administrative;
Burokraci minimale;
Shërbim i shpejtë.
Kthim fleksibil
Keni kredi? Mundësi e bartjes së kredisë te ne, mundësi të ri-planifikimit dhe fleksibilitetit.
Overdraft / Mbitërheqje
Mundësi të tërheqjes automatike nga llogaria deri në një rrogë.
Kursime fleksibile
Ky produkt ju ofron llogaritje të kamatës së fituar nga ju në baza ditore, dhe kreditim të interesit në baza mujore. Tërheqje dhe deponim shumë fleksibil me kamatë 3.1 %.
Kaloni financat tuaja në TEB përfitoni nga Oferta
Të gjitha këto në një paket nga TEB Sh. A. Joint Venture me BNP Paribas, bankën më të madhe në Eurozonë.
teb-kos.com / 038 230 000
TEB
BNP PARIBAS JOINT VENTURE

### Kompanitë e pastrimit dhe qytetarët me akuza të ndërsjella për papastërtinë në kryeqytet

# Qytetarët nuk i përgjigjen aksionit për pastrim

**Dy ditë para Ditës së Planetit zyrtarët komunalë janë shprehur optimistë se banorët e kryeqytetit do të jenë pjesë e aktiviteteve në shënimin e kësaj dite**

KOHA Ditore *BUKURIE BAJRALIU*

PRISHTINË, 19 PRILL – Në prag të shënimit të Ditës së Planetit që është më 22 prill, pjesë të caktuara të kryeqytetit vazhdojnë të jenë të mbushura me mbeturina të shumta, për të cilat qytetarët fajësojnë kompanitë e pastrimit, ndërsa zyrtarë të kompanive akuzojnë qytetarët.

"Nuk duhet me e pastru qytetin veç kur është Dita e Planetit se dihet që mbeturinat janë në çdo cep e kompanitë e bëjnë pastrimin vetëm në ato pjesë ku duken e jo edhe nëpër pjesë të tjera", ka thënë Milaim Sadiku, banor i lagjes "Velania". Ai ka shtuar se një pjesë e fajit për papastërtinë e krijuar nëpër rrugët e kryeqytetit bie edhe mbi vetë qytetarët.

"Fajin për papastërti e kanë edhe qytetarët të cilët i hedhin mbeturinat vend e pavend, dhe kemi raste të shumta kur kontejnerët janë të zbrazur kurse anash janë të mbushur me mbeturina e për këtë faji është i yni", ka pranuar Sadiku.

Edhe drejtuesit e kompanive të pastrimit i fajësojnë qytetarët për papastërtinë. Sipas tyre, qytetarët duhet të jenë më të përgjegjshëm për të pasur ambient të pastër në pjesët ku ata jetojnë.

"Nuk mund të fajësohen kompanitë se nuk po pastrojnë, pasi që ato vazhdimisht janë në aksion por faji është edhe i banorëve, të cilët në vend se t'i hedhin mbeturinat nëpër kontejnerë, ata i lënë afër tyre duke krijuar kështu deponi", ka thënë Isak Rakovica, drejtor i ndërmarrjes "Hortikultura".



**Dështimi i aksionit qytetar për pastrimin e lagjes "Bregu i Diellit" nuk do të ndodhë në shënimin e Ditës së Planetit, më 22 prill, shprehen zyrtarët komunalë**

### Banorët- vëzhgues të aksionit

Rakovica ka treguar se punëtorët e kësaj ndërmarrjeje ishin detyruar në fund të javës të largonin disa traktorë me mbeturina nga lagjja "Bregu i Diellit", banorët e së cilës nuk i ishin përgjigjur aksionit për pastrim, edhe pse vetë kishin kërkuar nga kompania që t'i ndihmonte për pastrimin e lagjes.

"Kryetari i Bashkësisë Lokale të lagjes 'Bregu i Diellit' na ka kërkuar ndihmë me mjete teknike për pastrimin e lagjes dhe ne i ofruam traktor dhe dorëza pasi që largimin e mbeturinave do ta bënin vetë banorët, mirëpo kur shkuam atje asnjë prej tyre nuk kishte dalë", ka treguar Rakovica.

Por për të mos dështuar aksioni tre punëtorët e "Hortikulturës" që kishin dalë vetëm për t'iu ofruar ndihmë teknike banorëve ishin detyruar që së bashku me kryetarin e Bashkësisë Lokale dhe një bashkëpunëtor të tij të pastronin lagjen nga e cila kishin larguar më shumë se dhjetë traktorë me mbeturina.

"Kemi dalë para orës dhjetë te vendi dhe kemi pritur deri në orën 12:00 për me u mbledhë banorët e lagjes për të pastruar, por ata vetëm kanë dalë dhe kanë shikuar në dritare me përjashtim të kryetarit dhe një kolegut të tij që kanë ndihmuar dhe i kemi larguar 15 traktorë me mbeturina prej atje", është shprehur Rakovica.

Dhe siç ka thënë ai arsyeja kryesore pse kjo kompani ka ofruar ndihmë për këtë lagje ka qenë vetëdijesimi i qytetarëve se aksione të pastrimit duhet të ndërmarrin më shpesh dhe të mos hedhin mbeturina kudo.

"Mendoj se aksione të pastrimit duhet të bëhen më shpesh dhe qytetarët pa dallim do të duhej t'u përgjigjeshin aksioneve të pastrimit në mënyrë kolektive", ka thënë Rakovica.

### Pastrimi i qytetit në Ditën e Planetit

Por këta të fundit pritet që të jenë pjesë e aksionit në Ditën Ndërkombëtare të Planetit, që do të shënohet më 22 prill, kështu të paktën ka thënë të dielën zëdhënësi i Komunës së Prishtinës, Muhamet Gashi.

"Më 22 prill në Ditën Ndërkombëtare të Planetit, Komuna ka paraparë të organizojë disa aktivitete në të cilat pa dyshim se do të marrin pjesë edhe banorët e kryeqytetit. Përveç kësaj, qytetarët pritet të jenë pjesëmarrës edhe në manifestimin qendror që do të mbahet në Parkun e Qytetit", ka treguar zëdhënësi Gashi.

Ai ka bërë me dije gjithashtu se për shënimin e kësaj dite kësaj radhe janë angazhuar edhe institucionet qendrore si vendëse dhe ndërkombëtare si dhe OJQ të ndryshme.

"Në këtë vit është për ta shënuar sa më mirë Ditën e Planetit është inkuadruar edhe Ambasada amerikane, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe dy organizata joqeveritare dhe është planifikuar që në këtë ditë të mbjellin pemë dhe fidanë nëpër disa pjesë të qytetit", ka thënë Gashi.

Por këtyre aktiviteteve do t'iu paraprijnë disa spote televizive përmes të cilave qytetarët do të mund të informohen me detajet e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Planetit, ku nuk është përjashtuar mundësia që po në këtë ditë të ketë edhe aksione për pastrimin e qytetit.

"Në shënimin e kësaj dite do të ketë aktivitete të shumta, kështu që nuk mund të përjashtohet edhe mundësia e pastrimit", ka deklaruar Gashi.

### Mungesa e sinjalistikës adekuate shkakton kaos në komunikacion

# Udhëkryq zor i kalueshëm afër QKUK-së

KOHA Ditore *GANIMET KLAIQI*

PRISHTINË, 19 PRILL – Nëse dikujt i bie puna që me urgjencë të shkojë në QKUK do të mund të bllokohet në kolonë veturash në udhëkryqin afër këtij institucioni shëndetësor. Për mungesë semaforësh, në këtë vend krijohet kaos veturash.

Sabit Syla, banor i lagjes "Velania", është njëri ndër qytetarët që ka provuar këtë gazep.

"Ditën kur me veturë e kam dërguar babanë në spital më është dashur të prisja mjaft gjatë aty për t'u liruar rruga dhe për të kryer punë. Secili automjet ngutej dhe nuk lëshonte radhë për të vazhduar në destinacionin e caktuar", ka thënë ai.

Madje ai ka thënë se ka dëgjuar se ka pasur raste kur qytetarët janë detyruar ta zbresin pacientin nga vetura dhe ta bartin atë në duar për në spital, për t'i ikur vonesave që krijohen aty.

Ankesa të këtilla kanë paraqitur edhe disa qytetarë, sidomos taksistët që e shkelin për çdo ditë atë udhë.

Arsimi, njëri nga taksistë që punon zakonisht te QKUK-ja, thotë se ky udhëkryq është torturues për vetura e kalimtarë.

"Aty është torturë të presësh. Derisa ti mendon se sipas rregullave të komunikacionit ke të drejtë përparësie kalimi në raport me anën tjetër, anës tjetër nuk i intereson kjo punë, por e fut kryet e kerrit dhe t'i vetëm mund të presësh bashkë me udhëtarët apo udhëtarin që e ke në veturë", ka theksuar ai.

Se udhëkryqi në afërsi të QKUK-së është shndërruara në problem, e pranon edhe zëdhënësi i Komunës, Muhamet Gashi.

"Po, e di se aty ka ngarkesë të madhe nga automjetet. Se ato ngarkesa janë të shpeshta nuk ka dyshim", ka thënë Gashi. Megjithatë, sipas tij komuna në vend të semaforëve e ka ndërmend të bëj zgjidhje tjetër. "Komuna ka planifikuar dhe ka ndarë mjetet që së shpejti në atë vend të ndërtohet një rrethrrotullim", ka thënë Gashi, pa mundur të saktësojë se kur do të ndodhë një gjë e tillë. Zëdhënësi i komunës, duke apostrofuar ekspertët komunalë të komunikacionit ka thënë se në këtë vend ka hapësirë të mjaftueshme për një rrethrrotullim, i cili do të zvogëlonte në masë të madhe pritjet e gjata të qytetarëve.



**Në udhëkryqin problematik afër QKUK-së, komuna ka paralajmëruar ndërtimin e një rrethrrotullimi**

### Fotolajm



**Prishtinë, 19 prill – Ky "mur" me të cilin tash sa kohë janë rrethuar këta kontejnerë në rrugën "Fehmi Agani" është shndërruar në strehimore për lypësit e kryeqytetit, të cilët pothuajse çdo natë e bëjnë gjumin pas tij. Por zyrtarët e kompanisë "Pastrimi", të cilët janë përgjegjës për mirëmbajtjen e kësaj rruge, thonë se nuk kanë informacion se kush e ka vendosur "murin". (B.B)**

**Notesi telefonik**

Policia 92 (telefon fiks), 112 (telefon celular), Stacioni nr. 1 504-604-5059, Stacioni nr. 2504-604-6748, Stacioni nr. 3 504-6 04-6796, Stacioni nr. 4 504-604-2997, Zjarrfikësit 93 (kujdestaria); mobil 933, 548-005, Emergjenca 94, Distribucioni KEK 227-842 (kujdestaria), Ujësjellësi "Prishtina" 541-211; 540-621 Higjienoteknika 554-143, Term okosi 543-210, PTK 988 (informata), PTK 977 (shërbimi për telefoni fikse), PTK 548-367 (shërbimi për telefoni mobile), QKU 500-600 (centrali), Kuvendi Komunal 230-900 (centrali), Inspekcioni komunal 23760, TMK - Shtabi i Përgjithshëm 548-283, Shërbimi për përkujdesjen e konsumatorëve 535-353, Drejtorati për mbrojtje civile dhe emergjente 245-666, 245-777

### Italia dhe Malta akuzojnë njëra-tjetrën se nuk po i ndihmojnë emigrantët ilegalë

# Askush nuk i pranon 140 afrikanët e mbetur në det



**Faktikisht emigrantët ilegalë janë në ujërat ndërkombëtarë, rreth 40 kilometra larg ishullit italian të Lampedusas. Ata janë duke qëndruar në një anije të transportit të mallrave nga Turqia, pasi barkat e tyre kishin filluar të fundoseshin**

ROMË, 19 PRILL (REUTERS) - Mbi 140 afrikanë po qëndrojnë në një anije turke të transportit në ujërat ndërkombëtare mesdhetare pasi Italia dhe Malta nuk janë pajtuar se cila prej tyre duhet t'i pranojë, kanë raportuar të dielën mediat ndërkombëtare.
Faktikisht emigrantët ilegalë janë në ujërat ndërkombëtarë, rreth 40 kilometra larg ishullit italian të Lampedusas. Ata janë duke qëndruar në një anije të transportit të mallrave nga Turqia, pasi barkat e tyre kishin filluar të fundoseshin.
Majori Clinton O'Neill, zëdhënës i qendrës së ndërhyrjeve shpëtimtare të ushtrisë malteze, ka theksuar se anija "Pinar" është urdhëruar të shkojë në vendin ku po fundoseshin afrikanët, pasi ajo ishte më afër zonës.
"Kur i kemi dhënë instruksione anijes që të shkojë në vendin më të afërt, vendi më i afërt ishte Lampedusa", ka deklaruar ai.
Mirëpo Qeveria italiane ka thënë se emigrantët ilegalë duhet të vendosen në Maltë, pasi kjo e fundit ka drejtuar operacionin e shpëtimit.
"Unë i kam kërkuar Maltës që të veprojë në pajtim me përgjegjësitë ndërkombëtare që i ka sipas traktateve të nënshkruara", është shprehur Roberto Maroni, ministri i Brendshëm italian. Autoritetet italiane kanë thënë se dy prej afrikanëve janë dërguar me një helikopter italian në Lampedusa për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore.

### Shumë shtete konfirmojnë mospjesëmarrjen

# Bojkotohet konferenca e OKB-së kundër racizmit

WASHINGTON/AMSTERDAM, 19 PRILL (REUTERS) - Mbajtja e konferencës së OKB-së kundër racizmit duket se është vënë në pikëpyetje, pasi që shumë shtete kanë konfirmuar se nuk do të marrin pjesë në të.
Australia dhe Holanda i janë bashkuar SHBA-së, Izraelit dhe Kanadasë në bojkotimin e këtyre bisedimeve. Britania e Madhe ndërkaq ka thënë se do ta dërgojë një delegacion, mirëpo jo të nivelit të lartë.
Arsyeja është se shtetet e mëdha i druhen faktit që nuk do të diskutohet tema e të drejtave të njeriut.
Bisedimet e së hënës kanë për qëllim që ta rishqyrtojnë progresin rreth luftimit të racizmit që nga forumi i vitit 2001. Ajo konferencë, që ishte mbajtur në Durban, përfundoi me grindje, pasi që shtetet arabe ishin munduar që ta definojnë cionizmin si racizëm.
Shefja e OKB-së për të drejtat e njeriut, Navi Pillay, ka thënë se është "e shokuar dhe tejet e zhgënjyer" nga bojkotet.
"Një numër shtetesh kanë lejuar që një apo dy gjëra t'u ndryshojnë qasjen, gjë që u pamundëson atyre t'i trajtojnë shqetësimet e shumë njerëzve që pësojnë çdo ditë nga racizmi", ka thënë ai.
"Holanda e cilësoi si të papranueshëm projektin final të deklaratave pasi rrezikon ta largojë konferencën nga qëllimet e saj", ka deklaruar ndërkaq ministri holandez i Punëve të Jashtme, Maxime Verhagen, njëra nga shtetet që ka konfirmuar bojkotin. Edhe SHBA-ja ka njoftuar se "nuk do të marrë pjesë në konferencë duke konfirmuar se deklarata finale përmban pjesë që nuk mund




të pranohen".
Robert Wood, zëdhënës i Departamentit amerikan të Shtetit, ka thënë se "për këtë arsye pendohemi, SHBA-ja nuk do të marrë pjesë".

### Aleanca Veriatlantike zmbraps sulmin e kusarëve të detit mbi një cisternë norvegjeze

# Ndjekja e shtatë piratëve nga NATO-ja

**Shtatë piratët kishin tentuar ta sulmonin anijen norvegjeze "MV Front Ardenne" të shtunën mbrëma, mirëpo ishin zmbrapsur pasi që ekuipazhi kishte alarmuar luftanijet në afërsi. Ndjekja e tyre pastaj ka vazhduar për shtatë orë rresht**

NAJROBI, KENI, 19 PRILL (REUTERS) - Luftanijet dhe helikopterët e NATO-s i kanë ndjekur piratët somalezë për shtatë orë rresht, pasi që këta të fundit kishin sulmuar një cisternë norvegjeze, kanë thënë të dielën zëdhënësit e kësaj Aleance, duke shtuar se kjo ndjekje kishte marrë fund vetëm atëherë kur gjuajtën të shtëna paralajmëruese drejt skafit të kusarëve të detit.
Shtatë piratët kishin tentuar ta sulmonin anijen norvegjeze "MV Front Ardenne" të shtunën mbrëma, mirëpo ishin zmbrapsur, pasi që ekuipazhi kishte alarmuar luftanijet në afërsi, kanë deklaruar komandanti portugez Alexandre Santos Fernandez, në bordin e një anijeje luftarake në Gjirin e Adenës dhe komandanti Chris Davies i shtabit detar të NATO-s në Angli.



"Mbetet e paqartë se si u zmbraps sulmi, duket se meritën e kanë pasur ekuipazhi i anijes së sulmuar", ka thënë Davies. Fernandes ka shtuar se nuk ishte shtënë në drejtim të kësaj cisterne.
Davies ka thënë se piratët i kishin dalë në rrugë anijes luftarake kanadeze, "Winnipeg", e cila po e përcillte një anije të "Programit Botëror të Ushqimit" në Gjirin e Adenës. Anija luftarake amerikane "Halyburton" po ashtu kishte qenë në ujërat në afërsi dhe i ishte bashkuar ndjekjes së shtatë piratëve.
"Ndodhi një ndjekje e gjatë, që zgjati rreth shtatë orë", ka thënë Davies.
Piratët i kishin gjuajtur armët në det, derisa anijet luftarake amerikane dhe kanadeze po u afroheshin. Këto anije janë pjesë e misionit të NATO-s kundër piraterisë.
"Skafi i piratëve është munduar të ikë drejt territorit somalez", ka thënë Fernandes. "Ishte nisur drejt Bossasos dhe ne arritëm që ta gjejmë... të shtënat paralajmëruese janë gjuajtur pas disa përpjekjeve për ta ndalur barkën".
Që të dyja anijet kanë thirrur helikopterët për përforcim, duke i ndalur piratët, pasi që ata kishin hedhur në det tërë "arsenalin" e tyre. Piratët pastaj ishin arrestuar, marrë në pyetje dhe ishin liruar.
Piratët nuk mund të ndiqen penalisht nën ligjin kanadez, për shkak se ata nuk i kishin sulmuar qytetarët kanadezë dhe krimi nuk ishte kryer në territorin e Kanadasë.

## Shkurt...



### Chavez: Erë e re e raporteve Venezuelë-SHBA

TRINIDAD DHE TOBAGO, 19 PRILL (REUTERS) - Hugo Chavez ka paralajmëruar se do ta kthejë ambasadorin e Venezuelës në Washington, duke folur për një "erë të re" në raportet me SHBA-në, pasi që ia kishte shtrënguar dorën Barack Obamas në një samit rajonal.
Presidenti socialist venezuelas u ka thënë gazetarëve gjatë Samitit të Amerikës se ai do ta propozojë Roy Chadertonin, ambasadorin e tij aktual në Organizatën e Shteteve Afrikane, si përfaqësues të ri të shtetit të tij në SHBA.
Paralajmërimi paraqet kulmin e një jave, gjatë së cilës Obama kishte hequr dorë nga "ashpërsia amerikane" kundrejt Amerikës Latine, duke i ringjallur shpresat për një qasje të re me Kubën, me të cilën i pati ndërprerë lidhjet rreth 48 vjet më parë.
Venezuela nën Chavezin ishte bërë aleate e ngushtë e Kubës.
Chavez e pati dëbuar ambasadorin amerikan në Venezuelë, Patrick Duddy, në shtator, në shenjë solidariteti me presidentin majtist të Bolovisë, Evo Morales, i cili e pati dëbuar kryediplomatin amerikan nga shteti i tij, duke e akuzuar për ndihmë opozitës në nxitjen e dhunës.
Washingtoni ishte përgjigjur duke i dëbuar ambasadorët e të dyja shteteve.

### Ahmadinejad kërkon mbrojtjen e drejtë të amerikano-iranianes

TEHERAN, 19 PRILL (REUTERS) - Presidenti iranian, Mahmoud Ahmadinexhad, e ka urdhëruar të dielën drejtësinë iraniane të sigurohet se gazetarja amerikano-iraniane, e burgosur për spiunazh të gëzojë të drejtat e saj ligjore për t'u mbrojtur, ka njoftuar të dielën agjencia zyrtare e lajmeve IRNA.
Letra e zyrës së Ahmadinexhadit për prokurorin e Teheranit u botua një ditë pasi Roxana Saberi u dënua me tetë vjet burgim për spiunazh për Shtetet e Bashkuara.
Ahmadinejad e ka urdhëruar kryeprokurorin e Teheranit, Saeed Mortazavi, që të sigurohet personalisht se "të dyshimtës do t'i jepen të gjitha të drejtat për ta mbrojtur veten" kundër akuzave. "Përgatituni për procedurat gjyqësore... për ta vënë drejtësinë në vend", ka cituar IRNA presidentin iranian.
Rasti i gazetares ka tensionuar raportet iraniano-amerikane, në kohën kur presidenti amerikan Barack Obama ia ka zgjatur Iranit dorën e pajtimit.



### Një masakër e re familjare

# Vrasje e pesëfishtë në SHBA



MIDDLETOWN, 19 PRILL (NYT) - Një çift bashkëshortor amerikan dhe tre fëmijët e tyre janë gjetur të vdekur, në shtëpinë e tyre në qytezën amerikane Middletown. Autoritetet kanë thënë se duket që fjala është për vrasje dhe vetëvrasje.
Zëdhënësja e sherifit të qarkut Frederick ka thënë se 34-vjeçari Allen Wood kishte humbur jetën nga plagët që ia kishte shkaktuar vetes. Ajo ka shtuar se bashkëshortja e Woodit, Francis, dhe tre fëmijët e tyre kishin pësuar "plagë të shumta", mirëpo ka shtuar se shkaku i vdekjes së tyre ende nuk është përcaktuar.
Djemtë e moshës katër dhe pesë vjeç janë gjetur të vdekur në shtretërit e tyre, ndërkohë që vajza dyvjeçare me nënën e saj janë gjetur të vdekura në dhomën e fjetjes. Trupi i pajetë i babait po ashtu është gjetur në atë dhomë.
Hetuesit kanë gjetur në shtëpi një pushkë gjuetie dhe disa mjete që besohet se janë shfrytëzuar për prerjen e viktimave. Autoritetet kanë gjetur po ashtu pesë letra të shkruara nga kryefamiljari, Allan Wood, ku ai u kërkon falje familjarëve dhe tregon se vuante nga probleme psikike.
Sherifi lokal po ashtu ka thënë se familja kishte pasur probleme financiare dhe mund të ketë pasur borxhe të mëdha.

### Edhe pse presidenti Barack Obama ka thënë se ish-agjentët kanë vepruar në pajtim me ligjin

# CIA i frikësohet hetimit të torturave

**Avokatët mbrojtjes kanë thënë se kanë filluar ta marrin edhe përkrahjen e disa kongresistëve, të cilët kërkojnë hetimin e agjentëve që kanë përdorur torturat**

WASHINGTON, 19 PRILL (NYT) - Disa prej operuesve të CIA-s frikësohen se mund të hetohen për torturimin e disa të burgosurve të profilit të lartë të "Al-Qaedas", edhe pse presidenti Barack Obama ka thënë se agjentët e CIA-s kanë imunitet ndaj ligjit.
Publikimi i katër memoareve të Departamentit amerikan të Drejtësisë janë vetëm disa prej sekreteve të treguara për metodat e marrjes në pyetje të të dyshuarve të burgjeve sekrete, të drejtuara nga CIA. "Këto janë dominot e para", ka deklaruar Jameel Jaffer, në emër të Unionit Amerikan për Liritë Civile. "Do të jetë e vështirë për administratën të thotë se dokumentet e tjera nuk duhet të publikohen".



Memoaret ishin udhëzues të shkruar nga administrata e Bushit, ku lejohej përplasja e të burgosurve për muri, simulimi i ngufatjes në ujë, lënia pa ushqim dhe lidhja e të burgosurve për ditë të tëra për grila të qelive.
Një zyrtar i lartë i CIA-s i kohës së sulmeve të 11 shtatorit të vitit 2001 ka thënë se ka "ende" memoare ku do të zbulohen metodat e ashpra të intervistës të të dyshuarve për terrorizëm.
14 prej figurave kryesore të kapura të "Al-Qaedas", në mesin e të cilëve edhe kryemjeshtri i sulmeve të 11 shtatorit, Khaild Sheikh Mohammed, ishin dërguar në vitin 2006 në Burgun e Guantanamos, ku edhe është lejuar përdorimi i torturave.
"Ne e dimë se si disa prej të burgosurve janë liruar, por nuk e dimë se sa të burgosur janë dërguar në to. A ka vdekur ndonjëri prej tyre gjatë simulimit të fundosjes në ujë? Mos ndonjëri prej agjentëve e ka tepruar?", ka pyetur ish-agjenti i CIA-s.
Avokatët mbrojtjes kanë thënë se kanë filluar ta marrin edhe përkrahjen e disa kongresistëve të cilët kërkojnë hetimin e agjentëve që kanë përdorur torturat. Një ish-agjent i ka thënë gazetës njujorkeze nën kushte anonimiteti se "të shikoje përdorimin e atyre metodave torturuese kishte një efekt traumatik".

### Kryeministri spanjoll Zapatero do ta presë presidentin francez, Sarkozy, me gjithë thumbimet

# Gratë ftohin gjakrat ndërmjet burrështetasve evropianë

**Tensionet diplomatike ndërmjet dy shteteve evropiane janë ngritur gjatë një fjalimi të presidentit francez me deputetët, kur "Sarko" ka thënë se kryeministri spanjoll "nuk është shumë inteligjent"**

MADRID, 19 PRILL ("TIMES") - Kryeministri spanjoll, Jose Luis Rodriguez Zapatero, do të jetë i obliguar që me krahë të hapur dhe me buzëqeshje ta presë presidentin francez gjatë një vizite në fund të muajit në Spanjë, edhe pse Nicolas Sarkozy dy ditë më parë e ka vënë në dyshim mençurinë e Zapateros.
Tensionet diplomatike ndërmjet dy shteteve evropiane janë ngritur gjatë një fjalimi të presidentit francez me deputetët kur "Sarko" ka thënë se kryeministri spanjoll "nuk është shumë inteligjent".
Mirëpo këshilltarët e burrështetasve evropianë kanë thënë se shpresojnë se gjakrat do të ftohen pasi Sarkozy do të jetë i shoqëruar nga bashkëshortja Carla Bruni, e cila është këngëtare, sikurse edhe



gruaja e Zapateros, që është pjesë e operës madrilene. Shumë media në të kaluarën e kanë krahasuar Zapateron me "Bambin" dhe "Peter Panin".
Kryeministria spanjolle ka thënë se raportimi i mediave se Sarkozy është tallur me aftësinë mendore të Zapateros nuk është i vërtetë. Mirëpo gazeta franceze "L'Express" duke insistuar se pretendimi i saj është i vërtetë, ka theksuar se "Sarkozy e sheh veten si mjeshtër të botës".
Sarkozy nuk është tallur vetëm me Zapateron. Ai ka thënë se presidenti Obama është "i zbehtë"; kancelaria Angela Merkel "ndjek hapin e politikës franceze; komisarit Jose Manuel Barrosos "as që i është ndier zëri" në Samitin e 20 shteteve më të industrializuara të botës; ndërsa fjalë të mira ka thënë vetëm për kryeministrin Silvio Berlusconin e njohur për thumbimet e ngjashme me ato të Sarkozyt.
Analistët spanjollë kanë thënë se sharmit dhe ngrohtësisë së gruas së Sarkozyt dhe të Zapateros u bashkohet edhe muzika. Do të ndikojnë për tejkalimin e thumbimeve të presidentit francez. Ata do të jenë pjesë një banketi të organizuar nga mbreti Juan Carlos, i cili i kishte thënë presidentit të Venezuelës, Hugo Chavezit, "mbylle gojën". Ai nuk është shprehur në lidhje me deklaratat kundërthënëse të liderit francez.

## Ec e beso...



### Me kalë, nga Pekini në Londër

PEKIN, 19 PRILL (REUTERS) - Një mezogrua britanike dhe dy shoqëruesit e saj kinezë janë nisur të shtunën në një udhëtim epik me kalë, gjatë të cilit ata do ta kalojnë Kinën, Azinë Qendrore, Evropën dhe do të arrijnë në Londër, për Olimpiadën e vitit 2012. Megan Lewis, kalëruese 60-vjeçare dhe udhëheqëse e ekspeditës, ka thënë se kalërimi trevjeçar nga Pekini drejt Londrës kishte qenë ëndërr e jetës së saj. Mirëpo ish-mësuesja e gjeografisë, që është duke mbledhur para për organizatat humanitare, e ka pranuar se kalërimi 8.200 kilometrash do të jetë një sprovë si për kuajt ashtu edhe për kalëruesit. "E dimë se mund të ndodhë gjithçka, mirëpo kjo është një pjesë e rrezikut që ia vlen të ndërmerret", ka thënë ajo. Pjesa e parë e udhëtimit do ta shpjerë ekipin treanëtarësh në Mongoli, përgjatë veriut të Kinës, duke përfunduar në krahinën Gansu në gusht - pjesa e fundit e Murit Kinez. Nga atje ata do të kalërojnë nga rajoni më perëndimor i Kinës, Xinjiang, në Azinë Qendrore dhe në Evropë, duke arritur në Londër me kohë për ceremoninë e hapjes së Lojërave Olimpike, më 2012.

### Policia zvicerane në telashe me binjakët identikë

BERNË, 19 PRILL (ANANOVA) - Zyrtarët zviceranë kanë thënë se janë të pafuqishëm për të vepruar kundër binjakëve identikë, që kanë marrë gjoba të shumta për parkim të palejuar dhe e kanë fajësuar njëri-tjetrin për shkeljet. Ata thonë se nuk mund të ndëshkojnë Harold dhe Michael Lengenin (38), për shkelje trafiku, duke shtuar se vetëm gjatë vitit të kaluar ata kanë marrë 29 gjoba parkimi në veturën e tyre të përbashkët. Mirëpo ata refuzojnë të paguajnë, duke u thënë gjykatave se binjaku tjetër kishte qenë fajtor. Ndërkohë policët kanë thënë se pasi që ata janë binjakë identikë, është e pamundur të mbështeten në dëshmi vizuale për të parë se kush e drejtonte veturën kur u gjobit. Një zëdhënës policor ka thënë: "Kjo është tejet frustruese për policët tanë. Sa herë që u japim gjobën, e dimë se çfarë do të ndodhë dhe ata nuk do ta paguajnë kurrë". "Mirëpo, ne nuk mund të bëjmë asgjë".



Tetë shtetet më të industrializuara pranojnë se "janë larg arritjes" së cakut të vënë nga OKB-ja

# G-8 dështon në luftimin e urisë

**Në draftin e siguruar nga "Financial Times" thuhet se ministrat janë pajtuar që agrikultura duhet të bëhet pjesë e agjendës globale politike, duke kërkuar që në disa vende të shtohet kultivimi i prodhimeve bujqësore**





LONDËR, 19 PRILL - Bota është "shumë larg arritjes" së qëllimit të vënë nga OKB-ja që deri më 2015 të përgjysmohet numri i njerëzve që ballafaqohen me urinë kronike, thuhet në draftin e deklaratës së tetë shteteve më të industrializuara të botës, ka raportuar të dielën "Financial Times".

Burme brenda G-8-ës kanë thënë se kjo është "një e dhënë alarmuese" krahasuar me synimin që i kishin vënë vetes tetë vendet anëtare. Edhe pse ekspertët kanë thënë se kishin dyshime se mund të arrihej ky cak, ata kanë shprehur habi se sa prapa qëllimit kanë mbetur.

Kjo e dhënë do të bëhet publike në fund të Samitit të agrikulturës - të parit të këtij lloji prejse tetë vendet më të industrializuara të botës kanë themeluar këtë mekanizëm. Kombet e Bashkuara i kanë njoftuar vendet anëtare se më shumë se një miliard njerëz në ditë nuk arrijnë të ushqehen si duhet, ka mësuar FT-ja.

Shtetet e G-8-ës më në fund e kanë pranuar se janë shumë larg arritjes së qëllimeve të mijëvjeçarit të themeluara nga Kombet e Bashkuara më 2000. Mirëpo ministrat besojnë se ende ka kohë që së paku të sensibilizohet e gjithë bota se uria urgjentisht duhet të sfidohet.

Në draftin e siguruar nga "Financial Times" thuhet se ministrat janë pajtuar që agrikultura duhet të bëhet pjesë e agjendës globale politike, ku parashihet që disa vende duhet ta shtojnë jashtëzakonisht shumë kultivimin e prodhimeve bujqësore. Edhe pse nuk ka shumë plane specifike, në draft thuhet se duhet të "nënvizohet rëndësia investimeve publike dhe private në agrikulturë".

Zyrtarë të lartë të njohur me rrjedhat e Samitit kanë thënë se G-8-a nuk do të zotohen për ndihma financiare. Mirëpo përfaqësues të vendeve anëtare kanë thënë se deklarata përfundimtare ende nuk është finalizuar, dhe se mund të zotohen për masa konkrete.

"Ne jemi të inkurajuar me progresin që është shënuar në Samitin ministror të agrikulturës të G-8-ës dhe jemi të kënaqur që po shohim se G-8-a po lëviz drejt hartimit të një deklarate përfundimtare për sigurimin e ushqimit", ka deklaruar Tom Vilsak, sekretar amerikan i agrikulturës. "Kjo çështje është e lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik dhe me stabilitetin ndërkombëtar, dhe meriton të jetë në qendër të agjendës botërore".

Edhe Qeveria britanike ka njoftuar se takimi ishte përqendruar në arritjen e një konsensusi politik për rritjen e prodhimeve bujqësore. Në draftdeklaratë është thënë se "duhet bërë më shumë për të shtuar sasinë dhe përmirësuar cilësinë e prodhimeve bujqësore, dhe që të gjithë qytetarët të kenë të drejtë për qasje në ushqim të sigurt dhe të mirë".

Gjigantët botërorë kanë prezantuar sukseset e tremujorit të parë, por jo edhe analizat për të ardhmen

## Kompanitë e mëdha nuk i publikojnë parashikimet

**Një e treta e 600 kompanive të mëdha që i janë përgjigjur anketës së kryer nga Instituti Kombëtar për Marrëdhëniet e Investitorëve kanë treguar se politikat financiare të gjigantëve tregtarë kanë ndryshuar shumë**

WASHINGTON, 19 PRILL (REUTERS) - Në këto ditë kur kriza ekonomike po thellohet, nuk është e rëndësishme që kompanitë t'u flasin investitorëve për të kaluarën, por për të ardhmen.

Mirëpo kompanitë me përmasa botërore po hezitojnë t'i publikojnë parashikimit e tyre, duke thënë se tremujori i parë i këtij viti ka qenë më i suksesshëm sesa kishin parashikuar. Madje ata kanë thënë se janë tejkaluar pritjet e tyre.

"Intel" nuk ka pranuar të japë detaje për parashikimet e biznesit të vet, duke theksuar se rezultatet do të jenë të varura edhe nga zhvillimet që do ta shoqërojnë krizën ekonomike. Mirëpo një ditë pasi ka prezantuar suksesin e vet për muajt e kaluar, "Intel" ka njoftuar se ka pësuar rënie prej shtatë për qind.

Një e treta e 600 kompanive të mëdha që i janë përgjigjur anketës së kryer nga Instituti Kombëtar për Marrëdhëniet e Investitorëve kanë treguar se politikat financiare të gjigantëve tregtarë kanë ndryshuar shumë. Shumë prej tyre kanë thënë se për shkak të krizës ekonomike janë shtrënguar t'i ndryshojnë politikat e tyre të huadhënies.

"Nëse nuk e dini se cila është e ardhmja e juaj, ju nuk mund ta parashikoni përafërsisht. Ju nuk dëshironi të jeni jashtë loje, duke u treguar të gjithëve se nuk keni besim në biznesin tuaj", është shprehur Jeff Morgan, shef ekzekutiv i Institutit Kombëtar të Marrëdhënieve të Investitorëve.

Edhe kompanitë e tjera që kanë kryer hulumtime për rezultatet e tremujorit të parë të vitit janë duke vepruar ngjashëm.

"Manpower Inc." ka refuzuar t'i publikojë të dhënat e saj. Shefi i ekzekutiv i kësaj kompanie ka thënë se do të ishte "më e ndershme që të mos i jepnin të dhënat e dukshmërisë së kompanisë sonë".

Edhe kompania për këshillime biznesore "The Hackett Group Inc" ka deklaruar se studimet e fundit kanë zbuluar se shumë kompani të mëdha nuk e dinë me saktësi se cilat do të jenë planet e ardhshme për shkak të ndikimit të krizës ekonomike në veprimtarinë e tyre.



Shkaku kryesor, vlerësojnë ekspertët, është qarja e madhe financiare e muajve të fundit, e cila shpërtheu në SHBA por shumë shpejt u shtri në gjithë botën.

Kompanitë nuk guxojnë të parashikojnë me saktësi se cila do të jetë kërkesa e konsumatorëve, pasi është krijuar panik në mesin e shumë klientëve të bankave të mëdha botërore. Mirëpo gjatë javëve në vazhdim, thonë ekonomistët, do të shihen ndikimet e para të pakove financiare, të ndara me qëllim që të stimulohet tregu financiar.

Protesta në Amerikë kundër masave të Obamas

## Guvernatori i Texasit kërcënohet me ndarje nga SHBA-ja



TEXAS, 19 PRILL (REUTERS) - Rick Perry, guvernator i Texasit, ka paralajmëruar se shteti i tij federal ka gjasa që të ndahet nga Federata e SHBA-së, duke e akuzuar qeverinë federale se është duke ua zënë frymën amerikanëve me tatime dhe borxhe. Perry të enjten kishte shkaktuar histeri tek përkrahësit e tij, që demonstronin kundër taksave. Shumica prej tyre valëvisnin flamujt dhe brohorisnin: "Ndarje".

Megjithatë, guvernatori i Texasit kishte korrigjuar veten në ditët në vijim dhe në bisedimet me gazetarët kishte deklaruar se "nuk ka kurrfarë arsye për daljen nga federata". Me gjithë korrigjimin e tij, Perry është bërë yll i Amerikës konservative, pasi që djathtistët që luftojnë që të dëgjohet zëri i tyre në administratën Obama e kanë gjetur tek ai ikonën e tyre të re.

Me Perryn në krye, Texasi është bërë bastion i valës së madhe të protestave djathtiste.

Politikanët konservativë në tërë SHBA-në kishin organizuar "ahengje protestuese me çaj" pikërisht në kohën kur duhej të paraqiteshin raportet për tatimin federal mbi të ardhurat. Mijëra persona kanë marrë pjesë në këto tubime protestuesish.

Përkrahësit e Perryt në tubimin protestues në Austin kanë valëvitur flamujt dhe transparentet ku Obama quhej "gënjeshtari më i madh".

**Lokaliteti arkeologjik i kohës së antikitetit – ende pronë private**

# Ulpiana, vetëm një për qind në dorë të shtetit

**Nga afro 100 hektarë, sa supozohet se ka lokaliteti arkeologjik i Ulpianës, pronë e shtetit nuk është as një hektar. Zyrtarë të Ministrisë së Kulturës theksojnë se janë në kërkim të formës së blerjes së tokave, ndërkohë që në llogari të pronarëve derdhin mjete për qiramarrje**

KOHA Ditore *HABIBE MALIQI*

PRISHTINË, 19 PRILL - Vetëm një për qind e lokalitetit arkeologjik Ulpiana është pronë shtetërore. Kësisoj, nga afro 100 hektarë sa supozohet se ka ky lokalitet, shtetit i takojnë vetëm 88 arë. Këta 88 arë ishin bërë "pazar" ndërmjet pronarëve të tokave dhe institucioneve shtetërore gati 50 vjet më parë. Muzeu i Kosovës në vitin 1963 i kishte blerë këto toka, dhe prej atëherë, pjesa më e madhe e Ulpianës është pronë private. Për të pasur qasje në pjesën më të madhe të territorit ku shtrihet Ulpiana duhet paguar qira.

Veç kësaj, ekspertët vlerësojnë se gërmimet në këtë lokalitet arkeologjik bëhen pa ndonjë rend, në mënyrë fragmentare dhe kryesisht në tokë private, si kur bëhet fjalë për hulumtime shkencore, si për ekspedita shkollore. Por edhe për ta bërë një gjë të tillë nga buxheti i saj, Ministria e Kulturës çdo vit ndan shuma të majme parash për qira. MKRS-ja të paktën edhe për tre vjetët e ardhshëm nuk planifikon të bëjë kësi "pazaresh" me Ulpianën. Për këtë vit kjo ministri ka ndarë 100 mijë euro, në kuadër të investimeve kapitale. Por kjo shumë është pjesë e një projekti trevjeçar në të cilin nuk parashihet ndonjë proces ekspropriimi.

Nëse MKRS-ja do të duhej ta blinte këtë tokë, në MKRS japin përgjigje të mjegullt.

"MKRS-ja është në përpjekje të gjetjes së formave për kompensimin e pronave në të cilat shtrihet lokaliteti i Ulpianës", ka thënë Arbërore Riza, zëdhënëse dhe këshilltare për media e ministrit Valton Beqiri.

Por, siç thotë ajo, "gjithnjë duke respektuar infrastrukturën ligjore". Derisa Ministria e Kulturës të gjejë "format e duhura" vazhdon të paguajë tagrin e vonesës. Së paku dy kontrata në dy vjetët e fundit ka lidhur MKRS-ja me të zotët e tokës në lokalitetin arkeologjik të Ulpianës. Madje, në një kontratë të lidhur në mes kësaj ministrie dhe një pronari toke, për këtë pronë, MKRS-ja ka paguar qira dhe për kohën kur kjo tokë fare nuk është përdorur për çfarëdo lloj gërmimi arkeologjik. Pagesa është bërë në mënyrë retroaktive për nëntë vite të kaluara.

Zyrtarë të MKRS-së e pranojnë se kanë bërë kontrata me drejtuesit e projekteve për pagesën e qirasë, si pasojë e gërmimeve në prona private.

"Është e vërtetë se ekziston një kontratë e tillë", thotë Burbuqe Deva-Bakija, udhëheqëse e Divizionit për trashëgimi kulturore në MKRS. Ajo shton se "bazuar në marrëveshjen e lidhur në mes të Muzeut të Kosovës dhe pronarit të 15 arë tokë në këtë lokalitet, MKRS-ja ka paguar nga 200 euro për 9 vjet", ka thënë Bakija-Deva.

Ndryshe, Luan Gashi, arkeolog nga Instituti i Arkeologjisë, tërheq vërejtjen në qasjen e përgjithshme që ka MKRS-ja ndaj lokalitetit arkeologjik të Ulpianës. Thotë se mjetet (100 mijë euro) që këtë vit ka ndarë MKRS-ja për Ulpianën mund të shërbejnë vetëm sa për të hapur rrugë. "Ulpiana është 'projekt' i përmasave të mëdha dhe kërkon qasje tjetër", ka thënë ai.



**"MKRS-ja është në përpjekje të gjetjes së formave për kompensimin e pronave në të cilat shtrihet lokaliteti i Ulpianës", ka thënë Arbërore Riza, zëdhënëse dhe këshilltare për media e ministrit Valton Beqiri**

**Agjencia "Botimpex" pjesëmarrëse në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Gjenevë**

# Libri shqip më afër lexuesit të huaj

**Veprat e shkrimtarëve më të njohur shqiptarë do të ofrohen për lexuesit në Panairin e 23-të të Librit në Gjenevë, i cili mbahet prej 22 deri më 26 të këtij muaji. Themelimi i "Botimpexit", sipas drejtorit të kësaj agjencie, Estref Bega, ka pasur për qëllim mbulimin e kërkesës së lexuesve të huaj për publikimet shqiptare dhe anasjelltas**

PRISHTINË, 19 PRILL (KD) - Agjencia e vetme nga Shqipëria "Botimpex" që merret me importin dhe eksportin e librave do të jetë pjesëmarrëse në Panairin e 23-të të Librit dhe Shtypit, i cili do të mbahet në Gjenevë të Zvicrës.

"Nga data 22-26 prill 2009, në sallonin e ekspozitave Palexpo të Gjenevës do të mbahet Panairi i 23-të Ndërkombëtar i Librit dhe i Shtypit", ka bërë të ditur nëpërmes një komunikate drejtori i kompanisë "Botimpex", Estref Bega.

Agjencia, sipas Begës, do të jetë e pranishme me libra për të rritur e për fëmijë, libra letrarë e historikë, kulturorë, fjalorë e metoda të mësimit të gjuhëve, CD, DVD e të tjera.

"Librat e përzgjedhur për këtë panair janë kryesisht botime të reja dhe mbajnë firmat e autorëve më të njohur shqiptarë dhe të huaj", thuhet në komunikatë.

Ndër emrat e njohur të autorëve të cilët qëndrojnë në kopertinat e librave të përzgjedhur nga "Botimpex" janë: Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Kristo Frashëri, Arben Puto, Fatos Kongoli, Eqrem Basha, Luan Starova, Shaban Demiraj, Neritan Ceka, Adelina Mamaqi, Vedat Kokona, Bedri Dedja, Gaqo Bushaka, Diana Culi, Mehmet Elezi, Alfred Papuçiu, Xhevat Lloshi, Kim Mehmeti, Nasho Jorgaq, Miranda Vickers, Marie-Luce Dayer si dhe të shumë krijuesve të tjerë.

Përveç gjetjes së librave të pranishëm në stendën e kësaj agjencie, lexuesit, thuhet në komunikatë, do të kenë mundësi të porosisin librat që u nevojiten, si dhe të marrin informacione më të gjera rreth botimeve në gjuhën shqipe.

Ndryshe "Botimpex" është formuar në vitin 1991 në Tiranë dhe për qëllim ka pasur mbulimin e kërkesës së lexuesve të huaj për publikimet shqiptare dhe anasjelltas. Kjo agjenci është distributor me përmasa botërore për të gjitha botimet shqiptare, sikurse janë librat, gazetat, revistat, CD-të dhe DVD-të. Bashkëpunimet e kësaj kompanie janë të shtrira në përmasa të gjëra dhe atë në shumë fusha të ndryshme si: libraritë, universitetet, institutet hulumtuese, arkivat e të tjera.



## KultBotë



### Koncert i netëve të verës në kopshtin e kështjellës Schoenbrunn

VJENË, 19 PRILL (TOTALPORTAL) - Koncerti i madh tradicional vjenez i shoqërisë së filarmonisë, do të zërë vend më 4 qershor të këtij viti në kopshtin e kështjellës unike Schoenbrunn të Vjenës.

Në koncertin nën dirigjimin e Daniel Barenboima, i cili këtë vit kishte dirigjuar edhe koncertin tradicional vjenez të vitit të ri, do të performohen veprat e Wolfgang Amadeus Mozart, Manuel de Falla, Modest Mussorgskog dhe të Johan Straua.

Nëpërmes këtij koncerti falas, pjesëtarët e Filarmonisë së Vjenës po synojnë që edhe kësaj radhe të promovojnë qëllimet e bashkimit kulturor dhe politik. Kjo është një tentativë e tyre që të bashkojnë njerëzit në një rreth sa më të madh, gjë që kishte ndodhur edhe vitin e kaluar, ku edhe përkundër shiut këtë koncert e kishin ndjekur 60 mijë njerëz.

Kështjella Schoenbrunn dhe parku i saj janë vendet më të bukura të Vjenës. Kopshti i stilit barok, në vitin 1996 është renditur në listën e vendeve më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në botë. Çdo vit këtë kështjellë e vizitojnë më shumë se 2.5 milion njerëz.

### 40 - vjetori i ngrohtores së Vjenës shënohet me "ekspozitë"

VJENË, 19 PRILL (NET.HR) – Ngrohtorja e Vjenës, këtë vit kremton 40-vjetorin. Por mënyra se si do të shënohet ky përvjetor është arti. Në fakt, vetë ngrohtorja është ekpozita. Ajo çfarë do të ekspozohet është puna e arkitektit kryesor të objektit si njëri ndër turistët special të Viennese Spittelau.

Emri i arkitektit, Friedensreich Hundertwasser është në mënyrë të pashmangshme i lidhur me historinë e ngrohtores.

"Fernëwrme Wien" është zbuluar më 30 janar 1969, ndërsa sot 40 vite më pas kjo kompani është njëra ndër 5 më të mëdhatë që përbëjnë rrethin e ngrohjes në Evropë.

Mirëmbajtja e ngrohtores, të cilën para 20 vjetëve e kishte sjellë Hundertwasser, ka sjellër deri te imazhi i mirë i kompanisë.

Diversiteti i materialeve shumëngjyrëshe dhe shumëformëshe përkundër betonit ngjyrë gri, është gjëja e parë e cila bie në sy.

Ndërtimi i ngrohtores prezanton një simbiozë të teknologjisë, ekologjisë dhe artit.



Disenjatori i dritave skenike, Nico de Rooij, lidh bashkëpunim me Teatrin Kombëtar

# Ndriçimi, esenca e emocionit në teatër

**“Sikurse hijet që e përbëjnë esencën e pikturave, ashtu edhe dritat përbëjnë esencën e emocionit në teatër”, thotë mjeshtri i ndriçimit skenik, holandezi Nico de Rooij, teksa zbulon fshehtësi të profesionit të tij. Së shpejti Rooij do të “ndriçojë” një shfaqje të Teatrit Kombëtar të Kosovës**

KOHA Ditore *SUNITA KURTI*

PRISHTINË, 19 PRILL - Nico de Rooij duket se e ka të projektuar në kokë ndriçimin e skenës teatrore teksa flet për mjeshtërinë e profesionit të tij. Një maestroje si ai nuk është e lehtë t’i kuptohet zanati. Rooji është i diplomuar për dizajn pamor në Akademinë Mbretërore të Londrës. Është koncentruar në dizajnin e ndriçimit skenik. Pakkush në Kosovë do ta çmonte atë çfarë ai di të bëjë.

“Elementi “dritë” është një pikë që vazhdimisht injorohet në teatër”, thotë drejtori artistik i Teatrit Kombëtar të Kosovës, Jeton Neziraj.

Në Holandë, prej nga vjen Rooji, është tjetër muhabet.

Një gjë të tillë e dëshmon edhe vetë Rooij, teksa zbërthen rëndësinë e ndriçimit skenik.

Dritat, thotë ai, janë ato që vënë në pah elemente vizualisht të padukshme në skenë, por të cilat ngjallin emocion.

“Janë elemente thelbësore për të krijuar atmosferë”, ka thënë ai të dielën në një lokal përbri Teatrit Kombëtar të Kosovës. Përballë tij rri ulur Jeton Neziraj, i cili ka ftuar disenjatorin Rooji në Kosovë.

Ndriçimi i skenës është një art në vete. Rooji tërheq një paralele me artin figurativ.

“Sikurse hijet që e përbëjnë esencën e pikturave, ashtu edhe dritat përbëjnë esencën e emocionit në teatër”, thotë ai me bindje, duke shtuar se dritat përbëjnë kornizën e një spektakli qoftë ai në një skenë teatrale, mjuzikël apo pikë vallëzimi modern.

Një natë më parë, (të shtunën mbrëma), maestros së ndriçimit skenik i ka rënë hise të shohë një shfaqje në Teatrin Kombëtar të Kosovës. “Bodrumi” me tekst të Ilir Gjocajt dhe regji të Fadil Hysajt është shfaqja që ai ka parë, me të arritur në kryeqytetin e Kosovës. Kishte diçka që nuk shkonte me ndriçimin e “Bodrumit”, por Rooji nuk kritikon hapur. Shfaqja, siç thotë ai, i kishte lënë përshtypjen e një pjese teatrore ku mbretëron motivimi për të përmirësuar gjendjen ekzistuese teknike dhe teatrale edhe me gjithë vështirësitë e shumta skenike.

“Përveç temës prekëse të luftës që kam parë tek “Bodrumi”, mund të them se trupa realizuese e shfaqjes ka dhënë më të mirën duke pasur parasysh mundësitë”, thotë ai.

Por, në pultin e dritave të Teatrit Kombëtar të Kosovës së shpejti do të ulet edhe vetë Nico de Rooij. “Revizori” i Gogolit, premiera e radhës në TKK, do të jetë shfaqja të cilën do ta “ndriçojë” mjeshtri holandez.

“Synimi ynë është të realizojmë së bashku premierën e radhës”, zbulon Neziraj. Por sipas drejtorit artistik të TKK-së, në ndriçimin e skenës në Kosovë është edhe një e metë që rëndon mbi mangësitë teknike.

“Ndriçimi është pikë edhe e dobësisë kreative e jo vetëm teknike”, thotë ai. Por kjo e fundit (dobësia teknike) pritet të përmirësohet së shpejti. Për një gjë të tillë do të angazhohet edhe vetë Rooij. Në kurriz të lidhjeve që Rooij ka me Teatrin Kombëtar të Holandës, pritet që të përfitojë edhe Teatri Kombëtar i Kosovës, pasi që këta të fundit shpresojnë të marrin nga teknika e “vjetër” e ndriçimit të Teatrit holandez.

“Pritet që një pjesë të teknikës së ndriçimit që Teatri Kombëtar i Holandës nuk e përdor më, ta përdorim ne”, ka bërë të ditur Neziraj, për të cilin ripërtëritja e teknikës ndriçuese për teatrin holandez do të ishte “bingo” për TKK-në.

Nico de Rooij ka premtuar se do të bëjë të pamundurën për të siguruar sponsor në Holandë, që do ta financojnë në përmirësimin e dritave në Teatrin Kombëtar të Kosovës.

“Nëse ka mundësi që të investohet apo të bëhet diçka në ndonjë fushë të teatrit, atëherë ato janë dritat”, ka thënë Rooij, i cili për ta bërë të plotë këtë pohim ka shtuar se edhe edukimi për dritat duhet të jetë i pranishëm.



**“Atë që unë mund të ofroj është ndihma rreth perceptimit të dritës”, ka thënë Nico de Rooij, i cili së shpejti do të ndriçojë premierën e radhës në Teatrin Kombëtar të Kosovës**

“Është mirë që njerëzit që merren me drita në Kosovë të shohin punën e homologëve të tyre që e ushtrojnë këtë profesion jashtë Kosovës”, është shprehur Rooij. Të njëjtën gjë e ka pohuar edhe drejtori artistik i TKK-së, Jeton Neziraj. Por në të njëjtën kohë këtë gjë e ka cilësuar si proces të pamundur për momentin.

“Kemi menduar të dërgojmë njerëz jashtë Kosovës në mënyrë që të aftësohen në këtë lëmë, por në mungesë të përkrahjes financiare ky dhe shumë projekte të tjera për momentin janë të parealizueshme”, është shprehur Neziraj.

Për ta nxjerrë pak a shumë sistemin e dritave të teatrit nga errësira, Rooij thotë se ka alternativë.

“Që të kemi ndriçim më të mirë në teatër, mund të ju referohemi programeve kompjuterike të cilat konsistojnë me llojin e caktuar të dritës”, është shprehur Rooij.

Holandezi Nico de Rooij i cili së fundi (para 3 dite) kishte marrë përgjegjësinë e realizimit të konceptit vizual të një premiere të mbajtur në Teatrin Kombëtar të Holandës, vizitën e tij në Kosovë e konsideron si të dobishme për disa arsye. Thotë se mund të japë ndihmë në mënyrën e të kuptuarit të dritës. Teksa në xhamin e syzeve me kornizë të trashë reflektohet drita që depërton nga dritaret e lokalit në qendër të kryeqytetit, Nico de Rooij shton: “Atë që unë mund të ofroj është ndihma rreth perceptimit të dritës, si një element që ngjall emocion tek publiku ku përveç vlerës funksionale ngërthen edhe vlera estetike”.

Drita ka një kuptim më të thellë për mjeshtrin e ndriçimit skenik.

“Ndriçimi është finalizues i përpjekjeve për krijimin e ‘atmosferës teatrale’”, përfundon ai.

## KultBotë

THE HISTORY CHANNEL

### Yjet e kinematografisë bashkohen në dokumentar

LOS ANGELES 19 PRILL (HOLLYWOOD REPORTER) – Kanali kabllor “The History” është bashkuar me organizatën “The People Speak” për të realizuar dokumentarin i cili do të përqendrohet në konceptin e demokracisë në të cilën do të marrin pjesë aktorë të mirënjohur.

Matt Damon, Josh Brolin, Viggo Mortensen, David Strathairn, Marisa Tomei dhe shumë të tjerë do të performojnë në dokumentar duke dhënë një pasqyrë kronologjike të disa prej ngjarjeve më të rëndësishme në historinë amerikane. Damon do të luajë rolin e shkrimtarit të librit “The Grapes of Ëorth”, Johnes Steinbeck, ndërkaq Tomei do ta luajë rolin e një punëtori të fabrikës Hanson Harriet Robinson.

Ndërkaq, aktorët Damon dhe Brolin janë po ashtu anëtarë të bordit ekzekutiv të producentëve, siç ishte edhe historiani dhe kritiku Howard Zinn, në jetën dhe veprën e së cilit është bazuar dokumentari.

### Botohet përmbledhja me tregime e Kurt Vonegatit

NEW YORK, 19 PRILL (SEECULT) - Një përmbledhje e tregimeve të shkurtra të shkrimtarit amerikan Kurt Vonegat, i cili ka vdekur para dy vitesh, do të botohen në nëntor të këtij viti. Kësisoj ka bërë të ditur, shtëpia botuese „Delacorta Press“, e cila të dielën ka zbuluar edhe atë se chfarë do të përmbajë kjo përmbledhje. Kësisoj, në përmbledhjen që do të titullohet “Look at the Birdie”, do të jenë 14 tregime. Po i njëjta shtëpi botuese ka bërë të ditur se do të botojë edhe 15 libra të Vonegatit, përfshirë edhe romanin “Galapagos”. Kurt Vonegat ka lindur në Indijanopolis në vitin 1922. Ka studiuar biokimi në Universitetin Kornel. Në fillim të Luftës së Dytë Botërore fillimisht u bë këmbësor i ushtrisë amerikanë për t’u shndërruar më pas në rob lufte i forcave gjermane. Autori i prozës që karakterizohet me simbiozë të fantastikës, realizmit e satirës, ka arritur famë si njëri ndër shkrimtarët më në zë amerikanë me romanin „Zogu i burgut“ dhe “Hokus-pokus”. Vonegat në vitin 1997 ka batuar romanin e tij të fundit me titull “Tronditja kohore“.



Biblioteka në Brod të Gorës së Sharrit e mbyllur për lexuesit

# Përpjekjet e dështuara për hapjen e bibliotekës

SHARR, 19 PRILL - As edhe në “Javën ndërkombëtare të bibliotekës” , e cila në Kosovë është shënuar me mjaft aktivitete, Bibliotekës së Brodit të Gorës nuk i është hequr dryni. Ndonëse brodasit për afro tre vjet pareshtur kërkojnë nga organet kompetente rihapjen e bibliotekës, një gjë e tillë deri tani nuk është bërë. Mbyllja e bibliotekës në këto vite të pasluftës është e pakuptimtë, konstatojnë brodasit, të cilët disa herë kanë përsëritur kërkesën e tyre për rihapjen e bibliotekës së kësaj bashkësie lokale, ku gravitojnë edhe nxënës e banorë të fshatrave Baqkë e Dikancë.

Por deri më tani, sipas drejtorit të shkollës, Zenun Mandak, këto kërkesa nuk kanë dhënë efekt të dëshiruar. Sipas tij, mbyllja e kësaj biblioteke, e cila ka kohë që për mungesë objekti është transferuar në lokalet e kësaj shkolle, po u shkakton vështirësi banorëve të këtyre lokaliteteve. E tëra kjo, sipas tij, ka ndodhur për shkak se bibliotekisti, i cili ka punuar disa vite, e ka lënë punën. Në anën tjetër qeveritë e deritanishme lokale nuk e kanë parë të arsyeshme që të pranojnë punëtorë të tjetër.



“Në emër të drejtorisë së shkollës disa herë i kemi bërë kërkesa me shkrim Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës në këtë komunë, për zgjidhjen e këtij problemi, por që deri më tani nuk kemi marrë asnjëherë përgjigje”, ka thënë Mandak.

Për gjetjen e ndonjë zgjidhjeje eventuale, drejtori i kësaj drejtorie, Hajri Ramadani, ka pohuar se janë bërë përpjekje, por në mungesë mjetesh, si dhe limitit të caktuar të punëtorëve të administratës komunale, kjo çështje nuk ka mundur të zgjidhet.

*Mehmet Spahiu*


Hyundai i Ri
i20
i rehatshëm
i shpejtë
i mrekullueshëm
10.900 Euro
Drive your way
HYUNDAI www.hyundai.com
PRISHTINË / VETERNIK / TEL: 044 /966 - 104; 044 / 966 - 230
GARANCION: 3 Vite ose deri 100.000 km
HELIX


A e din
kush
është i pari ?
1


Bëhu pjesë e së ardhmes.
Bashkohu me
PDK
www.pdk-ks.org


RENAULT CENTRE
Tel: 044/ 375 203
RENAULT minute
MUÇIQI
Ofertë Speciale
KOLEOS
18,107.00€
KOLEOS 4X2 2.5 16 V BENZIN
(edhe 7 copë)
19,608.00€
KOLEOS 4X2 2.0 DCI DIESEL
(edhe 4 copë)
Oferta vlen deri më 01.05.2009
MUÇIQI
19,704.60€
KOLEOS 4X4 2.0 DCI DIESEL
(edhe 9 copë)
10000 Prishtinë, Rr.Ahmet Krasniqi, Arbëri (ish dragodan)
Tel: 038/ 222 559, 044/ 375 203, www.renault- centre.com


ComLine Computers
ne jemi të parët
dhe të vetmit me garancion
IBM Pentium 4
Intel Pentium - 3.0 Ghz
RAM - 1024 MB (1 GB)
HDD - 80 GB (Sata)
VGA - 128 MB
DVD-Rom
Tastatur & Maus
Monitor 17" NEC LCD
189€
24 muaj
ne dimë
dhe mundemi
Rr. Ilaz Kodra
Prishtinë
(afër KEK-ut)
038 541 131
044 488 555
049 488 555
IBM Pentium 4
Intel Pentium - 3.0 Ghz
RAM - 512 MB
HDD - 40 GB
VGA - 128 MB
CD-Rom
Tastatur & Maus
Monitor 17" NEC LCD
169€
IBM Pentium 4
Intel Pentium - 2.6 Ghz
RAM - 512 MB
HDD - 40 GB
VGA - 128 MB
DVD-Rom
Tastatur & Maus
Monitor 17" NEC LCD
149€



Fotolajm

Me një shfaqje spektakulare, trupa e cirkusit "Tihany" ka shënuar 50-vjetorin e themelimit. Shfaqja është dhënë para publikut të Panama City. E veçantë e kësaj trupe është se 70 performuesit e "Tihany" vijnë nga 20 vende të ndryshme të botës. (Foto:AFP)

## 20 prill 2009

1894 - U nda nga jeta poeti i madh anglez, George Bajron. Në korrik 1809, gjatë një udhëtimi nëpër Mesdhe, romantiku rebel, këngëtari dhe përkrahësi i flaktë i luftës për liri dhe demokraci, vizitoi edhe Shqipërinë dhe qëndroi për një kohë në oborrin e Ali Pashë Tepelenës. Në kryeveprën e tij "Child Harold" poeti hedh përshtypjet e thella që i la Shqipëria dhe shqiptarët gjatë udhëtimit të tij në trojet arbërore.

571 – U lind Hazreti Muhamed themeluesi i Islamit. U bë nismëtari i bashkimit të popujve arabë. Nga viti 630 udhëhoqi shtetin e parë mysliman në Arabi. Islamizmi sot është një nga besimet më të përhapura fetare krahas krishterimit dhe budizmit.

1792 – Franca i shpalli luftë Austrisë, gjë që pati shënuar fillimin e luftërave revolucionare franceze.

1889 – Lideri nacist, Adolf Hitler, u lind në Braunau të Austrisë.

1902 – Shkencëtarët Maria dhe Pierre Curie e izoluan elementin radioaktiv, radiumin.

1945 – Forcat aleate morën kontrollin mbi qytetet gjermane, Nuremberg dhe Stuttgart gjatë Luftës së Dytë Botërore.

1968 – Pierre Elliott Trudeau dha betimin si kryeminstër i Kanadasë.

1972 – Moduli lunar nga "Apollo 16" arriti në Hënë.

# MI5 në kërkim të Q-së



LONDËR, 19 PRILL (REUTERS) – Shërbimi britanik i inteligjencës, MI5, vendi i punës së agjentit më të njohur sekret, James Bond, gjatë këtyre ditëve ka shpallur konkurs për këshilltarin kryesor shkencor të kësaj agjencie. Në konkurs shkruan se detyra kryesore e tij do të duhej të ishte "koordinimi i punës shkencore, në mënyrë që shërbimi sekret të ketë mbështetjen e fuqishme për gjetjen e mjeteve më të mira shkencore dhe teknologjike në punën e saj.

Natyrisht adhuruesve të filmave të James Bondit gjëja e parë që u bie ndërmend është se MI5 është duke e kërkuar "Q"-në, i cili edhe në realitet, ashtu si edhe në filma, do t'i furnizonte agjentët me gjëra të mahnitshme praktike, të cilat do t'u ndihmonin në kryerjen e detyrave sekrete dhe të rrezikshme.

## Ciceroni kulturor

### 20 prill

***

Në teatrin Oda vazhdon të jetë e hapur ekspozita "Dokufoto", e fotografëve Balasz Gardi dhe Teru Kuwayama.

***

Në Kinemanë ABC jepet filmi "The International", me regji të Harald Zwart. Filmi shfaqet në orën 17:00, 19:30, 22:00.

***

Në Galerinë e Arteve të Kosovës vazhdon të jetë e hapur ekspozita personale e Agim Ramadanit, e hapur me rastin e 10-vjetorit të vrasjes së tij.

***

Në galerinë "Qafa" vazhdon të jetë e hapur ekspozita personale e krijuesit Enver Hoxha.

***

Në "Galerinë A" vazhdon të jetë e hapur ekspozita "Momente qetësie" e fotografes Nita Zeqiri.

***

Në galerinë "Ekspoart 40" vazhdon të jetë e hapur ekspozita personale e Agim Krasniqit – Kragi.

## Horoskopi



### Dashi (21.03-20.04)

Keni kujdes, të mos vepron nën ndikimin e frustrimeve që ju kanë kapluar. Duhet ta kaloni këtë fazë me qetësi dhe me veprime të bazuara në arsye.



### Demi (21.04-20.05)

Do të krijohet një lidhje e papritur ndërmjet jush dhe një personi që nuk e keni parë më herët. Tregohu i kujdesshëm dhe përpiqu të kuptosh qëllimin e vërtetë të saj.



### Binjakët (21.05-20.06)

Duhet ta gjeni rrugën më të duhur për të qenë kreativ gjatë kryerjes së detyrave. Do ta shihni se shumë punë do të përfundohen me sukses nëse i bëni me kënaqësi.



### Gaforrja (21.06-20.07)

Gjithçka do të varet nëse do ta bindni sa duhet veten që gjërat realizohen nëse keni përkushtimin e nevojshëm. Pse ngurroni – kaloni në veprime konkrete.



### Luani (21.07-20.08)

Kënaqësitë që sjellin gjërat e imëta do të jenë satisfaksion më i madh për ju. Kështu do të filloni një javë të mbarë.



### Virgjëresha (21.08-20.09)

Nëse keni kohë ta kaloni pak kohë me një mik të vjetër gjatë një dreke apo darke, do të të ndihmonte shumë në krijimin e një ideje të qartë se çfarë dëshironi nga vetja.



### Peshorja (21.09-20.10)

Nëse dikush po planifikon se ku do t'i kalojë disa ditë pushimi, të njëjtën gjë duhet ta bëni edhe ju. Jeni lodhur nga puna e madhe e ditëve të fundit.



### Akrepi (21.10-20.11)

Nëse ju jepet një rast i mirë që do ta ndryshonte rrugën e karrierës tënde, mos e lëshoni. Por duhet të jeni të matur nëse rasti përkon me ambiciet tua.



### Shigjetari (21.11-20.12)

Nëse dëshironi të jeni më i respektuar nga një person që ka dyshime për personalitetin tënd, tregojani një rrëfim të suksesshëm të së kaluarës tënde.



### Bricjapi (21.12-20.01)

Çlirohu nga gjitha ngarkesat e mundshme psikike dhe gjeje një ritëm të ri për një fillim të mbarë të kësaj jave. Do të keni shumë aktivitete që do t' ju marrin kohë të konsiderueshme.



### Ujori (21.01-20.02)

Duket se nuk jeni të vetëdijshëm, por jeni duke hyrë në një fazë te re emocionale. Nëse ndërgjegjësoheni sa më herët për të, do të jetë më mirë për ju.



### Peshqit (21.02-20.03)

Lajm i mirë është fakti se ju keni një energji të madhe dhe shumë pozitive për t'i kryer me përpikëri planet që ia keni parashtruar vetes. Vetëm duhet të kaloni në aksione konkrete.

KOHA Junior

NËSE E KENI THËNË NDONJË THËNIE TË MENÇME, SHKRUAJENI DHE DËRGOJENI NË EMAILIN TONË JUNIOR@TREMBELAT.COM



„Zemërgjerësi e vërtetë ndaj të ardhmes është të japësh gjithçka në të tashmen."

– ALBERT CAMUS

# Kentrosaurusi dinozauri i pazakontë

Kur flitet për Stegosaurusin, zakonisht mendohet për vet Stegosaurusin gjigant. Por, stegosaurus ka qenë një grup dinozaurësh që kanë qenë të madhësive të ndryshme, disa shumë të mëdhenj, e disa mjaft të vegjël. Kentrosaurusi i ka takuar grupit të stegosaurusëve dhe ka pasur një madhësi relativisht të vogël në krahasim me dinozaurët e tjerë – sa një lopë e madhe. Por, për kentrosaurusin, nuk ka qenë vetëm madhësia që e ka bërë kaq të veçantë. Radhitja e pllakëzave në shpinë ka qenë në tërësi ndryshe prej stegosaurusëve të tjerë. Në vend se të kishte dy radhë të këtyre pllakave të gjera, kentrosaurusi kishte (po ashtu dy radhë) pllaka të atilla që ishin aq të ngushta sa që më shumë dukeshin si gjemba. Madje, edhe fjala "kentrosaurus" e ka kuptimin e " zvarranikut me maje". Në pjesën më afër kokës dhe qafës, gjembat janë më të shkurta dhe më pak të thepisura, ndërsa duke shkuar në drejtim të bishtit ato janë bërë më të gjata (deri në 60 cm) dhe më të mprehta. Përveç këtyre gjembave, kentrosaurusi kishte edhe një palë gjemba të tjera që ishin të vendosura anash, në regjionin e ijëve (në të katër ijet, pasi që kentrosaurusi ka ecur në katër këmbë!!!).

### Pllakat

Arsyeja e ekzistimit të këtyre gjembave ka zgjuar debate të shumta në mesin e shkencëtarëve të kësaj fushe. Shumë prej tyre mendojnë se pllakat e stegosaurusëve në përgjithësi kanë qenë aty për të kontrolluar në njëfarë mënyre edhe temperaturën e asaj kafshe. Por, pllakat e kentrosaurusit, duket se nuk kanë mundur të kryejnë atë funksion mu për shkak se kanë qenë aq të ngushta. Por, ndoshta, duke qenë se kontrosaurusi ka qenë mjaft i vogël me trup, ai nuk ka pasur nevojë për një sistem të tillë, të komplikuar të rregullimit të temperaturës trupore. Ndoshta këto gjemba apo pllaka te ky dinozaur kanë pasur thjeshtë, rolin e një parzmoreje, duke qenë se ky dinozaur ka qenë shumë i rrezikuar nga dinozaurët më të mëdhenj, mishngrënës. Vetëm me evoluimin e llojeve më të mëdha të stegosaurusëve, është paraqitur edhe nevoja për ndryshime evolutive në sistemin e kontrollit të temperaturës, e në këtë rast, ndryshimi i anatomisë së pllakave të shpinës.

### Truri i dytë apo depo energjie?

Një tjetër karakteristikë e këtij dinozauri, e për të cilën sërish zgjohen debate të shumta në mesin e shkencëtarëve, është ekzistimi i një hapësire midis eshtrave të ijëve apo shpatullave të tij. Dikur mendohej se ndoshta kjo hapësirë ka qenë vendi i një truri të dytë që ka pasur funksionin e kontrollimit të lëvizjeve të këmbëve të pasme dhe të bishtit. Por, dëshmitë më të vonshme tani e japin një tjetër ide: ndoshta kjo hapësirë ka qenë vendi në të cilën është vendosur ndonjë gjëndër apo ndonjë organ i veçantë – një masë e indit trupore – e cila ka furnizuar me energji pjesët e pasme të trupit, në rast të rrezikut, apo emergjencës. Nejse, ajo teoria e "trurit të dytë" po tingëllon shumë më interesant!!!!!



■ Dikur në një kohë, në Museun Humbold në Berlin, ka qenë i ekspozuar një skelet pothuaj i plotë i kentrosaurusit. Fatkeqësisht, nuk është më, pasi që ai është shkatërruar gjatë Luftës së Dytë Botërore.

**4 | 20** Një kentosaurus i gjatë rreth 4 metra do të kishte gjemba të gjatë mesatarisht rreth 20 centimetra

### Tjetër...

■ Përndryshe kentrosaurusi ka qenë i gjatë (bashkë me bisht) rreth 5 metra, ndërsa i lartë deri në 2 metra, dhe ka peshuar diku rreth 1.000 kg. Mendohet se ka jetuar në regjionin e Tanzanisë së sotme gjatë periudhës së vonshme të Gjurasikut, por, fosile të tij janë gjetur edhe në regjionin e Kinës. Ka qenë bimëngrënës, pra është ushqyer me bimë.

@ Për ndonjë propozim ose koment na shkruani në junior@trembelat.com

GJENI ËSHTË NJERIU QË BËN GJËRA QË TJERËT NUK MUNDEN.
GJENI PESË DALLIME.



1



2

### Kuriozitetetete... te.

■ Mbase nuk ua ka marrë mendja, por kërmijtë dhe njerëzit kanë diçka të përbashktët. Përdorin gjene të ngjashme për të përcaktuar anën e djathtë dhe të majtë të trupit.

■ Për tretjen e ushqimit nevojiten të ndodhin reaksione të ndryshme kimike, e lukthi juaj përmban një prej acideve më të fuqishme që ndihmon të ndodhin këto reaksione. Acidi i lukthit është aq i fuqishëm sa që është në gjendje të "djegë" edhe gurët.

■ Gjuha e Luksemburgut (luksemburgishtja), që është edhe gjuha e tyre kombëtare është shumë e afërt me gjermanishten. Madje gjermanishtja është gjuha e parë e huaj për shumicën e banorëve të Luksemburgut dhe është gjuhë që përdoret edhe në media.

Garfildi




Kelvin dhe Hobs




**Faqen e përgatisin** TREMBELAT.com
**Të gjitha ilustrimet, përveç stripave, janë origjinale nga Trembelat.**


KOHAVISION
SMS
E HËNË - E PREMTE
17:15
KTV
KOHAVISION
www.kohavision.net
EC ME KOHËN


KOHAVISION
EXPRESS live
EXPRESS LIVE
expreslive@kohavision.net
E HËNË - E PREMTE
18:15
KTV
KOHAVISION
www.kohavision.net
EC ME KOHËN


KOHAVISION
BURSA E KOSOVËS
BURSA E KOSOVËS
E HËNË
20:00
KTV
KOHAVISION
www.kohavision.net
EC ME KOHËN


KOHAVISION
Asist
ASIST
asist@kohavision.net
E HËNË
22:00
KTV
KOHAVISION
www.kohavision.net
EC ME KOHËN




Botimet KOHA sjell edhe një vepër mjeshtërore

## Librin që do ta mbrojë Kosovën para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

**Shtetësia e Kontestuar**
**Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi**

Juristi i jashtëzakonshëm dhe eksperti i së drejtës ndërkombëtare, Marc Weller, ua prezenton rekapitullimin e plotë të çështjes juridike të Kosovës që tërhiqet zvarrë mbi 20 vjet, duke argumentuar fuqishëm se pse Pavarësia e Kosovës është plotësisht në pajtim me të Drejtën Ndërkombëtare.

Lexoni punimin më të shkëlqyer të bërë ndonjëherë për mbrojtjen e Kosovës shtet.

Në shitje me KOHA Ditore

Libri 8 € + gazeta 0.30 €






Botimet KOHA sjell kronikën autentike të njërit nga, siç e quanin veten, njerëzit e rëndomtë që lanë punën dhe familjet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të luftuar padrejtësinë e madhe që i shkaktohej popullit shqiptar në Kosovë.

Si u mblodhën mbi treqind vullnetarë që dhanë betimin për të luftuar për Kosovën?

Si u bë që nga ky numër të mbeteshin vetëm 84 trima që lanë pas New Yorkun për t'u inkuadruar në luftë nga Shqipëria?

Si u pritën; ku u dërguan; si u trajtuan; në çfarë kushtesh jetuan; si dhe kush i stërviti?

Si u futën në zjarr dhe si ndodhi që të bëheshin pjesë të operacionit "Shigjeta" – ofensivës së parë të koordinuar ndërmjet NATO-s dhe UÇK-së?

Lexoni rrëfimin për guximtarët që erdhën nga ana tjetër e Atlantikut për ta ndihmuar çlirimin e Kosovës

15% e çmimit të shitjes do të mblidhet në fondin që do t'u ndahet familjeve të dëshmorëve të UÇK-së nga KOHA dhe autori

Së shpejti me KOHA Ditore

# Ftesë për aplikim

dokufest PRIZREN

**DOKUFEST**-i fton te gjithë autorët e filmave dokumentarë, të shkurtë si dhe të filmave të animuar që të aplikojnë për edicionin e 8-të të festivalit.

Regjisorët, skenaristët, produkcionet dhe shkollat e filmit mund të dërgojnë veprat e tyre për të konkuruar në njërën nga kategoriritë e festivalit:

**Ndërkombëtare, Ballkanike ose Nacionale.**

- Realizimi i filmave duhet të jetë i kryer pas 1 Janarit 2007.
- Filmat e shkurtë nuk duhet të jenë më të gjatë se 30 minuta.
- Filmat nuk duhet të jenë të shfaqura ne ndonjerin prej televizioneve nacionale.
- Afati i fundit për dorëzimin e veprave është 1 maj 2009

Për më shumë informata si dhe për mënyrën e aplikimit vizitoni web faqen zyrtare të festivalit: **www.dokufest.com**

**Edicioni i 8-të mbahet prej 3 - 9 gusht në Prizren.**

Quipu
Card Personalisation Centre

**Administrative Card Personalization Officer**

**QUIPU** is an expanding IT-Service provider including Card Personalization Services of the **PROCREDIT BANK NETWORK** in Eastern Europe, Africa and Latin America.

For our office in Prishtina we are searching for:

**Administrative Card Personalization Officer,** who like to work in an international environment,

Your profile:

- University Degree in Management and Informatics (Business Administration with Computers Skills, etc.)
- Very good level of English oral and written form,
- Good attitude on learning new topics,
- Flexible and reliable on the job,
- Customer oriented and good communication skills,
- Excellent knowledge of MS Office (as a plus),
- Knowledge of program languages is an advantage,

Job status: **Full-time**

If we have attracted your attention and you feel to fit the profile, send us your CV including your salary expectation, within **April 24, 2009** to:

BEHLULI@quipugmbh.com

We are looking forward to meeting you!

ProCredit Bank

## NJOFTIM PËR SHITJE PËRMES ANKANDIT PUBLIK

Gjykata Komunale në Deçan ka marrë Konkluzë mbi shitjen publike E.nr. 455/2007 për shitjen e patundshmërisë së hipotekuar të debitorëve Afrim dhe Hajdar Cacaj nga Deçani, e cila evidentohet në Fletën Poseduese me nr. 229, ZK Deçan-Qytet me numër të ngastrës kadastrale 1292 me kulturë shtëpi, ndërtesë, oborr dhe pemishte me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.13.68 ha.

Pasuria e hipotekuar do të shitet në Ankandin Publik, në mbështetje të dispozitës së nenit 208, 209 dhe 210 të Ligjit mbi Procedurën Përmbaruese, me qëllim të realizimit-shlyerjes së obligimeve të debitorëve të lartpërmendur sipas Marrëveshjes mbi Kredinë C-10146 ndaj Kreditorit-ProCredit Bank, Kosovë me seli në Pejë.

Çmimi fillestar nga i cili do të filloj shitja publike për ngastrën kadastrale të cekur më lartë është 66,666.66 euro.

Patundshmëria e hipotekuar është vlerësuar në shumë prej 100,000.00 euro.

Data e ankandit-shitjes është: 24.04.2009
Koha e ankandit-shitjes është ora: 13:00
Vendi i ankandit-shitjes: Gjykata Komunale në Deçan.

Të interesuarit duhet të deponojnë shumën prej 10 % të vlerës së cekur të patundshmërisë në emër të kaucionit në depozitin e Gjykatës, para se të filloj shitja e jo më vonë se me datën 23 Prill 2009, me të drejtë kthimi të kaucionit pas ankandit, ofertuesve të pasuksesshëm.

www.procreditbank-kos.com

CAPITAL RING
estate agent

www.ringks.com

**OFRON: SHITJE**
**Shitet banesa në Ulpianë, ka 39m2. Cmimi: 45.000euro.**
**Shitet banesa në Bregun e Diellit, ka 75.92m2. Cmimi: 860euro për m2.**
**Shitet banesa në Dardani, ka 61.8m2. Cmimi: 83.000euro.**
**Shitet banesa në Qendër Prishtinës, ka86m2. Cmimi: 101.000euro.**
**Shitet banesa te sheshi Nënë Tereza, ka 50m2. Cmimi: 98.000euro.**
**Shitet banes ate Pallati i Rinisë, ka 64m2. Cmimi: 118.000euro.**
**Shitet banesa në Dardani, ka84m2.Cmimi: 120.000euro.**

**OFRON: ME QIRA**
**Lëshohet kati i I i shtëpisë me qira afërMuzeut të Kosovës, ka 45m2. Cmimi: 350euro.**
**Lëshohet shtëpia me qira në Aktash, ka 100m2. Cmimi: 350euro (i negociueshëm).**
**Lëshohet banesa me qira te Qafa, ka 65m2. Cmimi: 400euro.**
**Lëshohet banesa me qira te Qafa, ka 60m2. Cmimi: 400euro.**
**Lëshohet banesa me qira në Dardani, ka 84m2. Cmimi: 450euro.**
**Lëshohet banesa me qira te Pallati i Rinisë,ka 65m2. Cmimi: 500euro.**
**Lëshohet banesa me qira te hotel Iliria, ka 48m2. Cmimi: 500euro.**
**Lëshohet shtëpia me qira në Tasligje, ka 267m2. Cmimi: 1.000euro.**
**Lëshohet shtëpia me qira në Tasligje, ka 300m2. Cmimi: 2.500euro.**

**LOKALE ME QIRA**
**Lëshohet lokali me qira te përmendorja Isa Kastrati, ka 150m2. Cmimi: 250euro.**
**Lëshohet lokali me qira te Kolegji Fama, ka 51m2. Cmimi: 500euro.**

# MOB IN
SHTËPI E MOBILEVE

## KONKURS

**Për vendet e lira të punës:**

**MOB IN FUSHË-KOSOVË**
**1. MONTERA** – depo në Fushë-Kosovë.
**2. PUNËTORË NË DEPO** – depo në Fushë-Kosovë.
**3. SHITËSE** – filiala në Fushë-Kosovë.
**4. PASTRUESE** – filiala në Fushë-Kosovë.

**MOB IN PEJË**
**1. MONTERA** – depo në Pejë.
**2. PUNËTORË NË DEPO** – depo në Pejë.
**3. SHITËSE** – filiala në Pejë.

**MOB IN GJILAN**
**1. SHITËSE** – filiala në Gjilan.

**MOB IN GJAKOVË**
**1. SHITËSE** – filiala në Gjakovë.

**Kushtet:**
- **MONTER: VETËM ME PËRVOJË PUNE në montimin e mobileve, Patent shoferi.**
- **PUNËTORË NË DEPO: Përvojë pune te ngjashme, Patent shoferi.**
- **SHITËSE: E DOMOSDOSHME PËRVOJA E PUNËS NË SHITJE, përgatitja shkollore e lartë e preferuar, të jetë e shkathët dhe komunikative.**
- **PASTRUESE: Përvojë pune të ngjashme dhe e kujdesshme në punë.**

**Për informata lajmërohuni në Tel:**
**FUSHË-KOSOVË: 038/535-017, 049/262-220**
**PEJË: 039/431-549, 049/328-774**
**GJILAN: 0280/323-140**
**GJAKOVË: 0390/326-454**


OFERTË DERI MË 30 PRILL
KOMPLEKSI EXCLUSIVE 2
NË LAGJEN "KALABRIA"
BANESA PREJ VETËM
356€
NË MUAJ
60 KISTE
EXDC
EXCLUSIVE DESIGN COMPANY
Rruga Bulevardi i Dëshmorëve, Hyrja 58, Kati 1, Nr 3, Prishtinë
info@exdc-ks.com / www.exdc-ks.com
+381 (0)38 555 467 | +377 (0)44 454 777


Hekurudhat e Kosovës Sh.a.
Kosovske Železnice D.d.
Kosovo Railways J.s.c.
TRANSPORTI I UDHËTAREVE
Hekurudhat e Kosovës ofrojnë transportin e udhëtarëve në këto relacione:
1. Prishtinë – Shkup – Prishtinë
Orari i trenit:
Nisja Prishtinë 05:50h Arritja Shkup 08:36h
Nisja Shkup 15:35h Arritja Prishtinë 18:25h
Çmimi i biletës për një drejtim - 4 Euro.
2. Pejë – Prishtinë – Pejë
Orari i trenit:
Nisjet Pejë 05:47h 11:20h Arritjet Prishtinë 07:30h 13:26h
Nisjet Prishtinë 07:50h 16:30h Arritjet Pejë 09:46h 18:10h
Çmimi i biletës për një drejtim – 3 Euro
3. Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Fushë Kosovë
Orari i trenit:
Nisjet F.Kosovë 04:25h 06:01h 14:00h 19:00h Arritjet Hani i Elezit 05:40h 07.14h 15:25h 20:27h
Nisjet Hani i Elezit 06:00h 11:00h 16:50h 20:45h Arritjet F. Kosovë 07:33h 12:26h 18:15h 22:10h
Çmimi i biletës për një drejtim në Trenin e Lëvizjes së Lirë - 0.50 Euro.
Çmimi i biletës për një drejtim në Trenin Lokal – 2.20 Euro.
Ju dëshirojmë udhëtim të këndshëm me ne!
Info: tel 038 536 619, 038 536 355
www.kosovorailway.com

KOHA PËR Sport
e hënë • 20 prill 2009 nr - 414

# Sigali e Bashkimi kryejnë gjysmën e punës






# Humanisti Kuqi

Futboll, Javë e ligë për të rrezikuarit

Faton Toski i harruar

Kastrati si në ditët më të mira

Buzuku mbron titullin e Suedisë

Zidane Jr. princi i vogël i Realit

Kaka alternativë për Ronaldon në Man Utd

NBA, Kampioni humb përparësinë e terrenit

Barazimi me Juven ia "nxjerr" gjuhën Mourinhos




## Red Bull shfaqet "me krahë" në Kinë

Ndeshja e parë gjysmëfinale e plejofit: Sigal Prishtina - Trepça 101:77 (30:17, 18:21, 23:19, 30:20)

# Prishtina kryen gjysmën e punës

**Kampionia në fuqi, Sigal Prishtina, tani udhëheq 2:0 në serinë gjysmëfinale të plejofit. Në fakt, Prishtina ka startuar me 1:0 në fitore kundër Trepçës, pasi gjatë edicionit të rregullt e mposhti katër herë këtë skuadër. Prishtinës i duhet vetëm edhe një fitore për t'u plasuar në finale**

KOHA Ditore *TAHIR SOPI*

PRISHTINË, 19 PRILL - Sigal Prishtina ka bërë një hap të madh drejt finales së plejofit të Technomarket Superligës A. Basketbollistët prishtinas të dielën mbrëma në Prishtinë kanë mposhtur Trepçën me shifrat 101:77 në ndeshjen e parë gjysmëfinale të plejofit. Me këtë triumf, Sigal Prishtina udhëheq 2:0 karshi Trepçës dhe është vetëm një fitore larg plasimit në finale.

**Pallati i Rinisë dhe Sporteve, Prishtinë**
**Shikues:** rreth 800
**Arbitra:** Zeka, Rifati, Vula
**Me pesë personale:** Guyden (T)

**S. Prishtina:** Azemi 18, Hasani 8, Bingjia, Spaqi 4, Young 13, Rugova 4, Jones 10, Podvorica 2, Selimi 2, Owens 22, Lila, Mazreku 18.

**Trepça:** Sejdiu, Selmani 2, Hangjiq 2, Gardiner 18, Veseli 9, Mustafa, Hajdari, Asllani 21, Hajrizi 18, Guyden 5, Shabani, Haxhiu 2.

Të kaltrit nisën serinë gjysmëfinale me 1:0 në fitore, pasi gjatë edicionit të rregullt mposhtën katër herë Trepçën.
Qendra amerikane Kevin Owens ishte më efikasi te Sigal Prishtina me 22 pikë të shënuara. Në ndihmë atij i dolën edhe Edmond Azemi e Blerim Mazreku, që realizuan nga 18 pikë për kokë. Për Owensin kjo ishte ndeshja më e mirë deri tani në fanellën e Sigal Prishtinës.
"Mund të them se kam nisur të adoptohem në lojën e ekipit dhe kjo po sjell rezultate. Kemi dashur të tregojmë se jemi ekip i fortë, duke dominuar edhe një herë ndaj Trepçës në këtë edicion. Jemi larg finales vetëm një fitore dhe kjo është një ndjenjë e mirë", ka thënë pas ndeshjes Owens.
Te skuadra e Trepçës shënuesi më i mirë ishte Gazmend Asllani me 21 pikë. Pikë dyshifrore te mitrovicasit shënuan edhe John Gardiner e Drilon Hajrizi nga 18 sosh.
"Falë mosangazhimit tonë Sigal Prishtina arriti të shënonte një fitore bindëse. Ishim shumë të butë dhe aspak nuk ishim



luftarakë. Prishtina shënoi fitore të merituar", tha trajneri i Trepçës, Aleksandar Sarkanj.
Sigal Prishtina epërsinë më të thellë e regjistroi në pesë minutat e fundit të ndeshjes, kur Owens shpërtheu. Amerikani vetëm në çerek të fundit shënoi 10 pikë.
Basketbollistët e Trepçës vetëm në çerekun e dytë ishin më të mirë se kundërshtarët e tyre, duke e mbyllur këtë dhjetëminutësh në favor të vet 21:18.
Çerekun e parë dhe të dytin Sigal Prishtina i nisi shumë mirë, ku edhe arriti një epërsi prej 19 pikësh (40:21) - minuta 15.
Ndeshja e radhës gjysmëfinale zhvillohet të enjten në palestrën "Minatori" në Mitrovicë.

# Kastrati, si në ditët më të mira

DUSSELDORF, 19 PRILL - Sulmuesi kosovar Bekim Kastrati si asnjëherë më parë është duke kaluar çaste të mira. Kastrati në ndeshjet e fundit luan titullar për Fortuna Dusseldorfin, ndërsa disa ditë më parë ai shënoi edhe një gol.
"Po i shijoj këto momente të mira, madje më të mirat qëkur jam transferuar te Fortuna. Nuk e kam pasur të lehtë viteve të fundit. Jam i kënaqur që gjërat po ecin mirë", ka thënë Kastrati në një intervistë për "RevierSport".
Kastrati me Fortunan po synon Bundesligën 2 të Gjermanisë. Fortuna pas 32 javëve gjendet në pozitën e katërt në Ligën e Tretë të Gjermanisë me 55 pikë, tri pikë larg pozitës që dërgon në Bundesligën 2.
Kastrati dy vjetët e fundit gjithmonë ka pasur probleme me lëndime. Ai këtë edicion ka zhvilluar 9 ndeshje kampionale dhe ka shënuar 1 gol. Ai po aktivizohet rregullisht nga fillimi në katër ndeshjet e fundit.
"Në skuadër atmosfera është mjaft e mirë. Shpresoj që gjithçka të ecë si duhet deri në fund dhe të sigurojmë Bundesliga 2", ka shtuar Kastrati.
Kastrati në Fortuna ka kaluar në verën e vitit 2007 nga Eintracht Braunshweigu. Ai me skuadrën gjermane ka kontratë deri në vitin 2009. Kastrati 30-vjeçar ka një paraqitje me Përfaqësuesen e Shqipërisë.

Ndeshja e parë gjysmëfinale e plejofit: Peja - Bashkimi 63:68 (22:14, 14:20, 9:15

# Peja dëshpëron në "Karagaç"

**Të sapoardhurit në Pejë, Chris Reaves dhe Alen Trepalovac, kanë shënuar vetëm nga pesë pikë. Performanca e tyre e dobët dhe moskomponimi me pjesën tjetër të skuadrës ishin çelësi i fitores për Bashkimin, mendon trajneri i skuadrës prizrenase, Jeton Nixha**

*BUJAR MEHMETI/KTV*

PEJË, 19 PRILL - Dy përforcimet e ardhura gjatë javës në Pejë, jo që nuk shfaqën lojën e "premtuar", por më e keqja, në ndeshjen e tyre debutuese skuadra pësoi nga Bashkimi. Peja të dielën në "Karagaç" e humbi takimin e parë gjysmëfinale të plejofit nga skuadra e portokalltë me 63:68. Fundori amerikan Chris Reaves dhe qendra kroate Alen Trepalovac shënuan vetëm nga pesë pikë. Ata ishin sjellë me "emergjencë" në vend të Carlos Morbanit e të Anthony Knoxit të lënduar. Ndeshja e dytë luhet në Prizren.
"Është përparësi e madhe që e kemi fituar takimin e parë si mysafirë. Tash luajmë në shtëpi dhe këtë e konsiderojmë përparësi të madhe. Peja duket se nuk ka arritur t'i komponojë sa duhet dy lojtarët e rinj, dhe ne lutemi që kjo të mos bëhet deri në ndeshjen e dytë", ka thënë trajneri i Bashkimit, Jeton Nixha.
Mënyra si nisi loja krijoi përshtypjen se për Pejën takimi i parë do të jetë një formalitet. Plot 5 minuta e 22 sekonda skuadra mysafire nuk shënoi pikë, ndërsa në semafor rezultati ishte 14:0. Në ndërkohë, Bashkimi nisi të marrë veten dhe të ngushtojë këtë epërsi në 22:14.
Peja në çerekun e dytë sërish shfaq lojë të mirë dhe arrin epërsinë në 12 pikë 34:22 (15'), por që shkrihet nga pak në minutat e fundit të kësaj periudhe. Me të filluar e treta, një dyshe e Donte Genniet barazon shifrat në 36:36, kurse më pas pikët



e Kadiqit u japin epërsinë e parë prizrenasve. Deri në minutat e fundit loja është zhvilluar pikë për pikë. Bashkimi siguron një dominim të lehtë që e mban deri në fund.
Në minutën e fundit, Peja provon nga distanca të anulojë epërsinë, mirëpo Shaptahoviq një herë dhe Reaves dy herë huqin nga treshet. As gabimet taktike në çastet e fundit nuk prodhuan rezultat për verdhezinjtë.
Lojtari më efikas te Peja ishte Florian Miftari me 26 pikë e 6 asistime.
"Betejën e humbëm për luftën jo. Jam optimist se do ta rikthejmë rezultatin në ndeshjen e dytë në Prizren. Sonte e nisëm mirë, mirëpo në çerekun e fundit nuk u treguam të kujdesshëm", tha Miftari.
Në radhët e Bashkimit katër lojtarë patën pikë dyshifrore. Më efikasi ishte Korab Ferizi me 18 pikë e 9 kërcime.

**Palestra e Sporteve "Karagaç", Pejë**
**Shikues:** rreth 2.000
**Arbira:** Kurshumlia, Mumini, Mehmeti
**Pesë gabime:** Shaptahoviqi

**Peja:** Shaptahoviqi 2, Radoni 4, V. Grapci 7, Gashi 2, Kuraja 2, Reaves 5, Miftari 26, Rr. Grapci, Mulliqi, Haxha, Trepalovac 5, Luca 10

**Bashkimi:** Bajrami, Prasoviq, Rexhepi 12, Sahiti, Shpejti, Maloku, Gennie 17, Kurti 6, Biraj, Kadiq 15, Ferizi 18, Bunjaku

## Futbollistët shqiptarë në Evropë

### Gjermani

### Mavraj titullar kundër Dortmundit

Mbrojtësi kosovar Mërgim Mavraj ishte titullar te Bochumi, që u mposht 2:0 në shtëpi nga Borussia Dortmund, të shtunën, në kuadër të xhiros së 28-të të kampionatit gjerman. Reprezentuesi i shpresave të Gjermanisë luajti tërë ndeshjen. Bochumi është i 14-ti me 28 pikë. Ndërkohë, sulmuesit Edmond Kapllani e Berat Sadik ishin rezervistë te skuadrat e tyre, Karlsruhe e Arminia Bielefed. Karlsruhe barazoi 2:2 me Hoffenheimin, ndërsa Arminia u mposht 1:0 nga Bayerni.

### Asistojnë Kuqi e Rama

Sulmuesi Njazi Kuqi ka përgatitur golin e fitores për Koblenzin që të dielën mposhti si mysafir Duisburgun me shifrat 3:2. Ndeshja ishte e vlefshme për javën e 28-të të Bundesligës 2. Kuqi në minutën e 91-të pasoi për koreanin Du-Ri Cha që shënoi golin e fundit. Kuqi luajti tërë ndeshjen. Te Koblenzi në stol qëndroi Renaldo Rama, ndërsa munguan Fatmir Vata e Ardian Gjokaj. Koblenzi mban pozitën e 12-të me 34 pikë. Të dielën në Bundesliga 2 ka asistuar edhe mesfushori Valdet Rama. Skuadra e tij Ingolstadt humbi 3:2 nga Freiburgu. Rama ka asistuar në golin e parë të Ingolstadtit që u shënua në minutën e 49-të. Rama luajti tërë ndeshjen dhe u ndëshkua me karton të verdhë. Ndërkohë Albert Bunjaku (Nunberg) e Shqipëron Skeraj (Greuther Furth) nuk ishin grumbulluar fare me skuadrat e tyre që po ashtu luajtën të dielën.

### Ukrainë

### Dallku zverdhet në humbje

Mbrojtësi Armend Dallku është ndëshkuar me karton të verdhë, derisa Vorskla u mposht 1:0 në shtëpi nga Metalist Kharkiv. Kjo ndeshje i takonte javës së 24-t të kampionatit ukrainas dhe u zhvillua të shtunën në mbrëmje. Dallku dhe Debatik Curri luajtën tërë ndeshjen për Vorsklan, ndërkaq sulmuesi Ahmed Januzi luajti tërë pjesën e dytë. Vorskla është e pesta me 37 pikë. Të shtunën luajti edhe Zorya që barazoi 1:1 me Karaptyn në fushën e këtij të fundit. Për Zoryan shënoi sulmuesi kavajas Parid Xhihani. Ky ishte goli i dhjetë i 25-vjeçarit Xhihani këtë edicion. Ai është shënuesi i parë i skuadrës dhe i pesti në ligë. Të dielën Dorian Bylykbashi asistoi në fitoren 2:1 të Kryvbasit kundër Dinamos së Kievit. Ai asistoi në golin e barazimit që u realizua në minutën e 34-t. Për Krivbasin tërë ndeshjen luajtën portieri Isli Hidi dhe mesfushorët Bylykbashi e Henri Ndreka. Hidi u zverdh në minutën e 87-të. Dinamo është lider i klasifikimit me 61 pikë. Krivbasi është i teti me 32.

Sulmuesi i Koblenzit me trup në Gjermani,me mendje në Kosovë

# Kuqi i dhuroi apartament një familjeje pa strehë

**Familja gjashtanëtarëshe Peci kishte jetuar për vite pa kulm mbi krye. Mirëpo një vizitë e papritur nga bashkëshortja e futbollistit Njazi Kuqi zëvendësoi vuajtjet e tyre me gëzim. E mësuar me ndihma në veshmbathje dhe ushqime, familja e varfër nuk u kishte besuar syve kur në duart e tyre ishin dorëzuan çelësat e një apartamenti të ri. Ideja e Kuqit për ndihmën kishte lindur në momentin kur kishte shkëmbyer fanellat me sulmuesin e Kombëtares së Gjermanisë, Miroslav Klose**

KOHA Ditore *Arsim Maxhera*

Mitrovicë, 19 prill - Naser Peci kishte humbur shpresat se do të mund t'i siguronte kulm mbi kokë familjes së tij gjashtanëtarëshe. Familja Peci në dy vitet e fundit kishte jetuar me qira në një shtëpi të vjetër, në lagjen "2 Korriku" në Mitrovicë. Kryefamiljari Naseri tregon se në atë shtëpi nuk kishte kushte minimale për jetesë. Në fillim të këtij viti shtëpinë në të cilën banonte familja Peci e kishte vizituar bashkëshortja e futbollistit Njazi Kuqi, Pranvera. Pasi ishte bindur për kushtet e vështira në të cilat jetonte kjo familje, Pranvera Kuqi kishte premtuar ndihmë.

"Mua më shkoj mendja se ajo do të na bënte ndonjë ndihmë në veshmbathje apo në ushqim. U befasova shumë kur pas disa ditësh ajo më mori në telefon dhe më tha që të shkoja e t'i merrja çelësat e një banese të cilën burri i saj, Njazi Kuqi, e kishte blerë për familjen time. Nuk kam pritur një gjë të tillë. Unë faktikisht kisha humbur shpresat se familjen time do të mund ta bëja me shtëpi. Se shtëpinë do ta kisha dhuratë nga dikush tjetër nuk më ka shkuar mendja ndonjëherë", tregonte të dielën Naser Peci derisa qëndronte ulur në dhomën më të madhe të banesës që familja e tij e ka dhuratë nga futbollisti Njazi Kuqi.

## Familja Peci nuk e di si duket Njazi Kuqi

Familja Peci të shtunën e kaluar ishte vendosur në banesën prej 65 metrash katrorë, që ndodhet në Tunel të Parë të Mitrovicës.

Ish-minatori Naser Peci (44) nuk kishte dëgjuar për Njazi Kuqin më parë. Edhe sot nuk e njeh njeriun që bëri me shtëpi katër fëmijët e tij. Ai momentalisht është i papunë, ndërsa familja i jeton nga asistenca sociale.

"Nuk e përcjell shumë sportin dhe nuk kisha dëgjuar më parë për Njazi Kuqin. Unë ende nuk e kam takuar Njaziun, të cilin e falënderoj nga zemra për dhuratën që na bëri. E kam parë një ditë në televizor kur shënoi një gol, por po ta takoja nuk besoj se do ta njihja", ka shtuar Naser Peci.



Ai nuk ka asnjë lidhje familjare me Njazi Kuqin apo me bashkëshorten e tij.

"Nuk e di se ku morën vesh se familja ime jeton në kushte shumë të vështira dhe pse zgjodhën pikërisht familjen time që ta ndihmojnë. Unë jam takuar vetëm një herë me bashkëshorten e Njaziut kur ajo erdhi të na vizitonte, ndërsa me vetë Njaziun asnjëherë. Më kanë premtuar se muajin tjetër do të na vizitojnë. Do të jem i nderuar t'i pres në shtëpinë që e kam dhuratë nga ata", ka shtuar ai.

## Gjithçka kishte nisur me fanellën e Miroslav Kloses

Sulmuesi i Koblenzit, 26-vjeçari Kuqi, në vjeshtë të vitit të kaluar kishte vendosur ta ndihmonte një familje në Kosovë. Pas ndeshjes së Përfaqësueses së Finlandës me Gjermaninë, luajtur më 10 shtator, Kuqi kishte ndërruar fanellën me sulmuesin e njohur gjerman Miroslav Klose. Fanellën e Kloses më pas e kishte vendosur në ankand publik dhe kishte deklaruar se paratë e fituara nga shitja e saj do t'i ndajë për ndonjë familje të varfër. Fanella e Kloses ishte shitur 4.800 euro.

"Parave që mora nga shitja e fanellës së Kloses ia shtova edhe disa të tjera dhe bleva banesën për familjen Peci. Unë më herët kisha vendosur që me paratë e fituara nga ajo fanellë të ndihmoja ndonjë familje të varfër. Fati deshi që ajo të jetë familja Peci. Për shkak të obligimeve që kisha në skuadër, nuk kisha kohë ta vizitoja këtë familje. Se cilën familje do të ndihmoja kishte vendosur bashkëshortja ime. E di që një shoqe e saj i kishte propozuar që kjo të ishte familja Peci, e cila siç kam mësuar ka jetuar në kushte shumë të vështira. Më pas gruaja ime e ka vizituar këtë familje dhe së bashku kemi vendosur që ta ndihmojmë atë", ka treguar të dielën Njazi Kuqi.

Ai nuk pranon të zbulojë se sa e ka blerë banesën.

"Nuk ka rëndësi shuma. Me rëndësi është se katër fëmijët e kësaj familjeje tani kanë shtëpi të veten dhe kushte më të mira për jetesë", ka shtuar Kuqi.

Njaziu ka lindur në Vushtrri, ndërsa si fëmijë është shpërngulur në Finlandë.

### Kuqi edhe dy vjet në Koblenz

Njazi Kuqi për skuadrën e kategorisë së dytë gjermane, Koblenz, do të luajë deri në qershor të vitit 2011. Ai të enjten ka vazhduar edhe për dy vite kontratën me Koblenzin. Kontrata aktuale i skadonte në qershor të këtij viti.

"Kontratën e kam nënshkruar të enjten. Në Koblenz kam kaluar shumë mirë dhe jam i kënaqur që do të luaj për këtë skuadër edhe në dy vitet e ardhshme. Edhe trajneri më ka thënë se është shumë i kënaqur me mua. Ai ka thënë se unë mund të luaj edhe 30 apo 40 për qind më mirë se tani dhe se dëshiron që në dy vitet e ardhshme të më shfrytëzojë këtë përqindje. Trajneri Uwe Rapolder ka qenë shumë korrekt me mua, më ka besuar shumë. Prania e tij është njëra prej arsyeve kryesore që kam vendosur të vazhdoj me Koblenzin", ka thënë Kuqi. "Kisha ofertë shumë të mirë edhe nga Duisburgu dhe disa ekipe të kampionatit belg, por në fund vendosa për Duisburgun. Oferta ishte shumë konkrete dhe kjo është arsye që vazhdimin e kontratës kemi vendosur ta bëjmë publik të hënën", ka shtuar Kuqi.

Ai për Koblenzin luan nga janari i vitit 2008. Më herët ka luajtur edhe për Carl Zeiss Jenana, Groningenin, Birminghamin, Blackpoolin, Peterboroghin e Lahtin. Ka tri paraqitje dhe tre gola në Përfaqësuesen A të Finlandës.

## Futbollistët shqiptarë në Evropë

### Itali

#### Bogdani mposhti ish-skuadrën

Sulmuesi Erion Bogdani është ndëshkuar me karton të verdhë në fitoren 2:0 të Chievos si mysafir kundër Sienës. Ndeshja u zhvillua të dielën në kuadër të xhiros 32 të kampionatit italian Serie A. Kundër ish-skuadrës së tij Bogdani ka luajtur deri në minutën e 80-të, kur u zëvendësua nga Langella. Chievo është e 16-ta me 34 pikë. Ndërkohë portieri kosovar Samir Ujkani ishte rezervist te Palermo, që fitoi 4:1 kundër Bolognas.

### Suedi

#### Rashkaj mposht kampionin

Mesfushori kosovar Anel Rashkaj ka realizuar golin e vetëm në fitoren 1:0 të Halmstadit si mysafir kundër kampionit në fuqi të Suedisë, Kalmarit. Ky takim u zhvillua të dielën në kuadër të javës së katërt të kampionatit suedez. Rashkaj shënoi në minutën e shtatë, ndërsa u zëvendësua në atë të 87-të. Ky ishte goli i parë i 19-vjeçarit këtë edicion. Për Halmstadin kjo ishte fitorja e parë këtë edicion. Të dielën luajti edhe Malmo që barazoi 1:1 me Trelleborgun. Për Malmon tërë ndeshjen luajti Labinot Harbuzi që po ashtu u ndëshkua me karton të verdhë, derisa sulmuesi Agon Mehmeti u zëvendësua në minutën e 65-të. Për Trelleborgun deri në minutën e 83-të luajti Fisnik Shala. Mesfushori Emir Bajrami luajti tërë ndeshjen për Elfsborgun që fitoi 2:1 kundër Gefles në fushën e kësaj të fundit. Në kategorinë e dytë suedeze Erton Fejzullahu ka shënuar gol në fitoren 4:0 të Mjallbyt kundër Assyriskas.

### Zvicër

#### Ferati kthehet në krye

Kampioni në fuqi i Zvicrës, Baseli, është kthyer në krye të klasifikimit të Superligës zvicerane pas fitores 3:2 kundër Xamaxit të dielën në javën e 28-të. Baseli tani ka 61 pikë, një më shumë se përcjellësi i parë, Zuerichu, që të shtunën barazoi 2:2 me Sionin. Për Baselin tërë ndeshjen luajti mbrojtësi Beg Ferati, ndërsa në stol qëndruan Jurgen Gjasula e Orhan Mustafi. Për Zuerichun tërë ndeshjen luajti mesfushori Adrian Nikçi, ndërsa nga minuta e 66-të edhe sulmuesi Admir Mehmedi. Të shtunën luajti edhe Aarau i Kristian Nushit që fitoi 2:1 me Bellinzonan. Mesfushori Nushi asistoi në golin e parë të Aaraut, që u shënua në minutën e 47-të. Ai luajti tërë ndeshjen. Te Bellinzona deri në minutën e 75-të luajti mesfushori Shkëlzen Gashi që u zverdh.

Mesfushori i Eintracht Frankfurtit vuan mungesën e përgatitjes fizike

# Toski i harruar

**Nga 13 ndeshje sa u paraqit në fazën pranverore, në 10 ishte titullar. Nuk ishte fillim i keq. Por, nuk dihet ende se kur saktësisht u ndal karriera e Faton Toskit. Nuk dihet se nga erdhi rënia e formës**

Frankfurt, 17 prill (Frankfurter Rundschau) - Ishte një kohë kur Faton Toski ndihej më mirë në lëkurën e tij. Ishte koha kur mesfushori i Eintracht Frankfurtit ishte në qendër të vëmendjes. Gazetat shkruanin për të, vlerësohej si talent i madh. Në fillim të stinorit, majtaku shënoi një gol duke i nxjerrë një pikë Frankfurtit me Wolfsburgun (2:2). Edhe më vonë ai tregoi përsëri performancë të mirë dhe dukej se kishte siguruar një vend standard te Eintrachti, pra se është bërë tamam një lojtar i Bundesligës. Nga 13 ndeshje sa u paraqit në fazën pranverore në 10 ishte titullar. Nuk ishte fillim i keq. Por, nuk dihet ende se kur saktësisht u ndal karriera e Faton Toskit. Nuk dihet se nga erdhi rënia e formës. Ajo që dihet është se mesfushori kosovar është zhdukur nga qendra e vëmendjes.

Për gjithë këtë ka një arsye: Toski 22-vjeçar vuan nga një dëmtim i ijës. Trajneri Friedhelm Funkel e pret Toskin në stërvitjet javët e ardhshme. Mirëpo, ai më nuk planifikon shumë në të këtë stinor. Toski ka kohë që më nuk është në formën e tij më të mirë fizike. Qysh në fazën përgatitore për stinorin pranveror ai u vlerësuar ndër më të dështuarit. Madje, në një seancë trajneri e kishte detyruar të vraponte dhe të qëndrojë në stërvitje më tepër se të tjerët. Funkel, po për shkak të përgatitjes jo të mirë e kishte larguar nga skuadra e parë Toskin. Mirëpo, trajneri duket se ka ndërruar fjalët tash.

"Ne do t'i tregojmë atij se si punohet dhe çfarë duhet bërë për të luajtur me skuadrën e parë. Nëse ai nuk arrin t'i plotësojë këto kritere, atëherë do të jetë e vështirë", ka thënë trajneri Funkel. Toski me Eintrachtin ka kontratë deri në vitin 2011. Toski duket si një aktor që nuk mund të mbështetet vetëm në aftësitë e tij.



"Ai është një lojtar i ri dhe i talentuar. Ka zhvilluar ndeshjet të mira me ne. Ka shënuar gola dhe do të ketë sërish rastin", ka thënë trajneri Funkel.

2 Korriku - Besa 0:0

# Besa shtyn 2 Korrikun në një rang më të ulët

PRISHTINË, 19 PRILL - Kapiteni Besim Ademi në shumë raste gjatë pjesës vjeshtore dhe asaj pranverore ka nxjerrë faqebardhë ekipin e tij, 2 Korriku, por të dielën nuk pati të njëjtin fat, ndonëse mundësia iu dha. Ai ka dështuar të shënojë nga pika e bardhë kundër Besës së Pejës. Sfida e zhvilluar të dielën në Prishtinë në kuadër të javës së 20-të të Raiffeisen Superligës mbaroi 0:0 dhe ky përfundim vetëm sa ia shtoi gajlet ekipit nga lagjja e Arbërisë. 2 Korriku mbetet në bisht të klasifikimit, është i 14-ti me 20 pikë sa ka edhe Drita që mbyll klasifikimin, ndërkohë Besa mbetet e pesta me 29 pikë.

Starti i ndeshjes ishte diç më dinamik, sidomos 15 minutat e parë kur edhe vendasve iu dha mundësia të shënojnë nga penalltia, por dështuan. Besim Ademi u pengua në zonë të rreptësisë dhe vetë mori përsipër të gjuajë atë, por portieri pejan Sanell Bandiq priti.

Ademi deri tash ka shënuar 12 gola dhe është i dyti në listën e realizatorëve. Pak minuta pas dështimit të penalltisë Ademi pati edhe një rast, por gjuajtja me kokë kaloi mbi portë. Në këtë pjesëlojë për Besën rrezikoi Gashi (45).

Në 45 minutat e dytë Besa u tregua paksa më dominuese, por dështoi të shënojë golin e fitores. Bekim Bajraktari (49), Haxhi Zeka (54, 71) dhe Ahmeti në minutat e fundit patën raste shënimi. Jetullahu dhe Ademaj rrezikuan për vendasit.

Kjo është përballja e dytë e këtyre dy skuadrave brenda katër ditëve. Të mërkurën Besa mposhti 2 Korrikun në Prishtinë me rezultatin 3:0 në ndeshjen e parë çerekfinale për Kupën e Kosovës. Ndeshja e kthimit mes këtyre dy skuadrave do të zhvillohet këtë mesjavë në Pejë.



| 2 Korriku | 0:0 | Besa |
|---|---|---|
| Dabiqaj | | Bandiq |
| Llumnica (Le. Krasniqi) | | Gacaferri (Krasniqi) |
| Li. Krasniqi | | Cacaj |
| Ademaj | | Morina |
| Selimi | | Bajraktari |
| Thaqi | | Papuçi |
| Prekopuca | | Çekaj (Demaj) |
| Ademi | | Hysenlekaj (Ahmeti) |
| Dubi (Canolli) | | Mellinaj |
| F. Krasniqi (Mavriqi) | | Zeka |
| Jetullahu | | Gashi |

*Stadiumi i 2 Korrikut, Prishtinë*
*Shikues: rreth 300*
*Arbitra: Dumi, Bericha, Agërbashi*
*Kartona të verdhë: Canolli (2 Ko) – Papuçi, Çekaj (B)*

Vëllaznimi - Kosova 1:0 (0:0)

# Fitore që kthen qetësinë në Gjakovë

KOHA Ditore *GAZMEND DOLI*

GJAKOVË, 19 PRILL - Sulmuesi i Vëllaznimit, Uliks Emra, ka shpaguar mundin e shokëve dhjetë minuta pa përfunduar takimi, kur ka finalizuar rastin më të mirë në ndeshje, kundër Kosovës së Vushtrrisë. Goli i Emrës ka qenë i vetmi në takim që skuadra gjakovare e ka përfunduar në favor të vetin me rezultat 1:0. Ndeshja është luajtur të dielën në stadiumin e Gjakovës.

Kjo fitore e rikthen ekipin kuqezi në pozitën e dytë (34) pas një kohe të gjatë, ndërsa largon edhe më shumë skuadrën nga presioni i mbetjes në ligë. Kjo është fitorja e dytë në pranverë. Vëllaznimi në këtë stinor nuk ka humbur asnjë takim, ndërsa ka barazuar tri herë si mysafir.

"Goli ka ardhur në kohën më të duhur. Gjatë gjithë kohës kemi pasur presion, duke e ditur se kemi mungesë të shënuesve, po vijmë shumë vështirë deri te gola. Por mendojë se e kemi merituar fitoren", tha tekniku i Vëllaznimit, Blerim Mula.

Deri te shënimi i golit të dy ekipet kanë qenë shumë aktive në lojë, posaçërisht gjatë 45 minutave të fundit. Emra ka pasur edhe një shans në minutën e 27-të kur ka gjuajtur pak centimetra larg shtyllës së djathtë, si dhe në minutën 44 kur portieri Burim Sadiku kishte intervenuar para tij. Ndërsa deri në minutën e 80 kur ka shënuar, Emra "nuk është ndier i gjallë". Robert Gjeraj ka rrezikuar në disa raste, si ato në minutat 40 dhe 75.

Më keq nuk kanë luajtur as edhe lojtarët nga Vushtria. Armend Zabërgja në dy raste 30 dhe 60 ka mundur shumë lehtë të realizojë, sikurse edhe Tahir Ademi në 70 dhe 77.

"Ne kemi ardhur për fitore, por një gabim yni na kushtoi. Sot na ka munguar edhe fati", tha pas takimit Armend Zabërgja.

Vushtrriasit të dielën në Gjakovë kanë qenë të mbështetur fuqishëm edhe nga grupi i tifozëve Forca, që në numër të konsiderueshëm kanë bërë tifo për ekipin e tyre.

| Vëllaznimi | 1:0 | Kosova |
|---|---|---|
| *Emra 80'* | | |
| Mushica | | Sadiku |
| Gjeraj | | Isrefi (Varfi) |
| Vula | | Uka |
| R. Duraku | | Izmaku |
| Kasapi | | Cakaj |
| Mullaliari | | Zeçaku |
| Gashi | | Zeneli (Sokoli) |
| Sh. Duraku | | Mazhuni |
| Oela (Pedrinja) | | Mehmeti |
| Nikoliqi (Bushaj) | | Zabërgja |
| Emra (Jimiku) | | Ademi |

*Stadiumi i qytetit në Gjakovë*
*Shikues: rreth 3000*
*Arbitra: Shaleta, Musolli, Reci*
*Kartona të verdhë: Vula, Kasapi, Sh. Duraku (V) – Mazhuni (K)*

Trepça - Hysi 1:0

# Baliqi përmbys Hysin

KOHA Ditore *MUSA MUSTAFA*

MITROVICË, 19 PRILL - Mesfushori mitrovicas Emin Baliqi (22) ka shënuar golin e vetëm në fitoren e Trepçës ndaj Hysit. Baliqi pasi pranoi një top nga Visar Shkupolli, kaloi dy mbrojtës dhe gjeti rrugën për të tundur rrjetën me një goditje nga rreth 7-8 metra.

Takimi i zhvilluar të dielën në Mitrovicë mbaroi 1:0. Kjo është fitorja e dytë e mitrovicasve në sezonin pranveror dhe shumë e vlefshme në luftën e tyre për mbijetesë në elitë. Pas 20 javëve Trepça është e dhjeta me 26 pikë, kurse Hysi ndodhet në zonën e të rrezikuarve, është i 12-ti me 23 pikë.

Trajneri i Trepçës, Gani Sejdiu, vlerëson se ekipi i tij u angazhua maksimalisht dhe ishte i disiplinuar gjatë gjithë ndeshjes.

"Të vetëdijshëm për kundërshtarin shumë të rrezikshëm që bën lojë të shpejtë në fazën e sulmit me kujdes nisëm lojën. Fitorja ishte më se e domosdoshme dhe u arrit me angazhimin e të gjithëve. Shënuam fitore të merituar me lojë korrekte", ka thënë Sejdiu.

Në të vërtetë skuadra vendase ishte më e rrezikshme gjatë tërë ndeshjes, sidomos në 45 minutat e dytë. Vetëm sulmuesi Elvis Osmani pati katër raste shënimi (24, 64, 66, 76). Rrezikuan edhe Emin Baliqi (3), Alban Dragusha (37) dhe Fetah Ibrahimi (79). Për Hysnin rastin më të mirë e lëshoi Elhami Berisha (26).

"Ishte një ndeshje e niveluar, Trepça dominoi dhe e deshi më shumë fitoren. Ne dështuam në mesfushë, ndonëse krijuam 2-3 gjysmëraste që nuk u shfrytëzuan. Trepça meritoi fitoren", ka thënë trajneri i Hysit, Luan Prekazi.

| Trepça | 1:0 | Hysi |
|---|---|---|
| *Baliqi 22'* | | |
| Ismajli | | Neziri |
| Ibrahimi | | Ahmeti |
| Hashani | | Islamaj |
| Llapashtica | | Gashi |
| Dragusha | | Sogojeva |
| Kaqiu | | Ademi |
| F. Sejdiu (I. Sejdiu – Dervishi) | | Musolli (Beticha – Mehmeti) |
| Osmani | | Zabërgja |
| Isufi | | Kida |
| Baliqi | | Zhdrella |
| Shkupolli (Fetahu) | | Osmani |

*Stadiumi "Adem Jashari", Mitrovicë*
*Shikues: rreth 500*
*Arbitra: Kelmendi, Peshteni, Havolli*
*Kartona të verdhë: Llapashtica, Dragusha, F. Sejdiu (T) – Ademi (H)*

## Semafori

**Raiffeisen Superliga - XX**

| | |
|---|---|
| Prishtina - Besiana | 3:1 |
| Vëllaznimi - Kosova | 1:0 |
| Gjilani - Ulpiana | 1:1 |
| 2 Korriku - Besa | 0:0 |
| Ferizaj - Drita | 5:1 |
| Trepça - Hysi | 1:0 |
| Drenica - Trepça '89 | 1:2 |
| Istogu - Flamurtari | 1:3 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. Prishtina | 20 | 15 | 4 | 1 | 36:12 | 49 |
| 2. Vëllaznimi | 20 | 9 | 7 | 4 | 27:19 | 34 |
| 3. Flamurtari | 20 | 10 | 3 | 7 | 27:28 | 33 |
| 4. Drenica | 20 | 9 | 4 | 7 | 31:23 | 31 |
| 5. Besa | 20 | 7 | 8 | 5 | 24:19 | 29 |
| 6. Ulpiana | 20 | 9 | 2 | 9 | 25:23 | 29 |
| 7. Kosova | 20 | 7 | 7 | 6 | 29:18 | 28 |
| 8. Gjilani | 20 | 8 | 4 | 8 | 24:22 | 28 |
| 9. Ferizaj | 20 | 8 | 2 | 10 | 33:39 | 26 |
| 10. Trepça | 20 | 7 | 5 | 8 | 22:29 | 26 |
| 11. Trepça '89 | 20 | 6 | 7 | 7 | 17:19 | 25 |
| 12. Hysi | 20 | 6 | 5 | 9 | 28:27 | 23 |
| 13. Besiana | 20 | 7 | 1 | 12 | 21:36 | 22 |
| 14. 2 Korriku | 20 | 5 | 5 | 10 | 27:32 | 20 |
| 15. Istogu | 20 | 5 | 5 | 10 | 24:31 | 20 |
| 16. Drita | 20 | 5 | 5 | 10 | 16:27 | 20 |

*Në xhiron XXI, më 25/26 prill, takohen: Trepça '89 - Drita, Flamurtari - Vëllaznimi, Ulpiana - Trepça, Kosova - Drenica, Besiana - Istogu, Gjilani - Ferizaj, Besa - Prishtina, Hysi - 2 Korriku.*

## Lista e shënuesve

**13 gola:** Labinot Osmani (Hysi)

**12 gola:** Besim Ademi (2 Korriku)

**11 gola:** Enis Zabërgja (Hysi)

**10 gola:** Berat Hyseni (Prishtina)

**9 gola:** Haxhi Zeka (Besa), Artan Bajra (Istogu)

**8 gola:** Armend Zabërgja (Kosova), Faton Zejnullahu (Flamurtari)

**7 gola:** Dardan Rogova (Vëllaznimi), Labinot Lubishtani, Astrit Fazliu (Ferizaj), Sherif Topalli (Ulpiana), Suad Saliagiq (Prishtina)

**6 gola:** Elvis Osmani, Florent Sejdiu (Trepça), Dukagjin Gashi (Drenica), Liridon Hasani (Gjilani)

**5 gola:** Besim Bajraktari, Brahim Vojvoda, Muhamet Dragusha (Drenica), Emir Ragipoviq (Besiana), Naim Kodraliu (Flamurtari), Blerim Hysenlekaj (Besa), Uliks Emra (Vëllaznimi)

**4 gola:** Premton Muja (Gjilani), Granit Çekaj, Shpëtim Idrizi (Trepça '89), Kushtrim Lushtaku (Drenica), Përparim Demiraj (Istogu), Jeton Llumnica (2 Korriku), Azem Ahmeti (Prishtina)

Boks amator për femra

# Buzuku mbron titullin e Suedisë

**Boksierja Kosovare Buzuku të shtunën në finale mposhti Maria Lindqvistin. Në gjysmëfinale të enjten ajo ishte më e mirë se Nathalie Nilsen**

MALMO, 19 PRILL - Boksierja shqiptare Kosovare Buzuku ka mbrojtur titullin e kampiones së Suedisë në kategorinë deri 60 kilogramë të boksit amator. Buzuku të shtunën në finale mposhti Maria Lindqvistin e klubit Kalmar me rezultat të thellë 26:3. Në gjysmëfinale të enjten Buzuku pati mposhtur Nathalie Nilsenin me rezultat 23:9.
"Ndihem shumë mirë, kam realizuar synimet që i kisha vënë vetes. Kundërshtarja ime nuk ishte shumë e mirë teknikisht, por fizikisht ishte shumë e fortë. Unë isha më e shpejtë se ajo", ka thënë 20-vjeçarja Buzuku për mediumet suedeze.
Ajo është pjesë e klubit Sundsvall. Buzuku që ka lindur në Kosovë bokson rregullisht për Përfaqësuesen e Suedisë. Vlerësohet ndër boksieret më të mira të këtij vendi.
Kosovare Buzuku dhjetë ditë më parë mbrojti edhe titullin e kampiones së Skandinavisë.
"Synim im i ardhshëm është që të fitoj kampionatin evropian që do të mbahet në shtator. Jam duke u përgatitur shumë mirë dhe besoj se do të tregohem e suksesshme", ka shtuar Buzuku.
Kohëve të fundit Buzuku është përballur me disa lëndime. Për këtë arsye nuk arriti të paraqitet në kampionatin botëror për boksiere, që u mbajt në fund të vitit të kaluar. Nëse boksi amator për femra futet në program të Lojërave Olimpike, Buzuku është njëra nga kandidatet kryesore për të përfaqësuar Suedinë në "Londër 2010".

Formula 1, Shpërblimi i Madh i Kinës

# Red Bull shfaqet "me krahë" në Kinë



**Kjo është fitorja e parë për Red Bullin dhe e dyta për Sebastian Vettelin. Edhe vendi i dytë i takoi kësaj skuderie. Befasia e stinorit, Brown GP, ka rrëmbyer vendin tre dhe katër. Ndërkohë, Ferrari ka regjistruar edhe një dështim të madh**

**Shpërblimi i Madh i Kinës:**

| | Koha |
|---|---|
| 1. S.Vettel (R.ed Bull) | 1:57:43.485 orë |
| 2. Mark Webber (Red Bull) | +10.9 sek. |
| 3. Jenson Button (Brawn GP) | +44.9 |
| 4. R. Barrichello (Brawn GP) | + 1:03.7 min. |
| 5. H. Kovalainen (McLaren) | + 1:05.1 |

**Renditja individuale:**

| | Pikë |
|---|---|
| 1. Jenson Button | 21 |
| 2. Rubens Barrichello | 15 |
| 3. Sebastian Vettel | 10 |
| 4. Timo Glock | 10 |
| 5. Mark Webber | 9.5 |

**Renditja e konstruktorëve**

| | Pikë |
|---|---|
| 1. Brawn-Mercedes | 36 |
| 2. Red Bull-Renault | 19.5 |
| 3. Toyota | 18.5 |
| 4. McLaren-Mercedes | 8 |
| 5. BMW Sauber | 4 |

SHANGHAI, 18 PRILL - Sebastian Vettel ia ka dhuruar skuderisë Red Bull fitoren e parë në histori të Formula 1. Vettel ka triumfuar të dielën në garën për Shpërblimin e Madh të Kinës të mbajtur në Shanghai, në një garë që është përcjellë gati vazhdimisht nga shiu. Ky është stinori i pestë i Red Bullit në F1 dhe më në fund ka realizuar fitoren e parë. Gjermani Vettel ka startuar i pari dhe i pari ka mbyllur garën. Ai pas vetes ka lënë kolegun e tij të Red Bullit, australianin Mark Webber.
"Ka qenë një strategji fantastike dhe një punë fenomenale e skuadrës. Skuadra ka bërë një punë të mrekullueshme", ka thënë Vettel.
Për Vettelin kjo është gara e dytë që e ka fituar në karrierën e tij të F1. Ai edicionin e kaluar pati triumfuar në garën e Shpërblimit të Madh të Italisë të mbajtur në Monza. Edhe atëherë gara ishte mbajtur gjatë kohës sa po binte shi.
"Nganjëherë ka qenë mjaft e vështirë për të mbajtur bolidin në shteg, veçanërisht gjatë kthesave. Ka qenë një lloj lumi në shteg", ka thënë Vettel.
Australiani Mark Webber bëri një luftë të madhe me liderin e F1 britanikun e Brawn GP, Jenson Button. Në fund Webber arriti ta mposhtë Buttonin.
"Është një ditë e mrekullueshme për skuderinë, pasi kemi marrë pikë maksimale. Pas dështimeve në Australi dhe në Malajzi kjo është një ditë fantastike", ka thënë Webber.
Në të vërtetë, bolidët e Red Bullit ishin të pakapshëm. Të tillë ishin edhe për bolidët e skuderisë debutuese, Brawn GP, që befasuan në dy garat e para. Brown GP edhe në Kinë nuk zhgënjyeu. Dy ngasësit e saj Jenson Button dhe Rubens Barrichelo kanë përfunduar në pozitat tre dhe katër.
"Ka qenë mjaft e frikshme. Është një lehtësim që kam përfunduar garën dhe kam zënë vendin e tretë", ka thënë Button.
Vendi i pestë dhe i gjashtë është "rezervuar" për pilotët e McLaren-Mercedesit, përkatësisht Heikki Kovalainen dhe Lewis Hamilton. Ndërkohë, Ferrari ka regjistruar edhe një dështim. Ky është starti më i dobët i kësaj skuderie që nga viti 1981.
"Duhet të qëndrojmë gjakftohtë. Nuk ka arsye për panik, pasi kjo do të bënte punën edhe më të vështirë", ka thënë drejtori i Ferrarit, Stefano Domenciali.

## Blic sportiv

**Cannavaro në verë kthehet në Juventus**



Mbrojtësi italian Fabio Cannavaro në verë do të rikthehet në radhët e skuadrës së madhe italiane Juventus, përcjell "Tuttosport" të dielën. Cannavaro 35-vjeçar me Juventusin do të firmosë kontratë njëvjeçare me opsion për të vazhduar edhe për një vit. Qendërmbrojtësi italian është pjesë e Real Madridit me të cilën skuadër ka kontratë deri në fund të këtij edicioni. "Cannavaro do të jetë një përforcim mjaft i madh për Juventusin. Jo vetëm për Juventusin, por për çdo skuadër. Ai është një lojtar i madh me një përvojë të madhe", ka thënë portieri i Juventusit, Gianluigi Buffon.

**AZ fiton titullin e Holandës**



Skuadra AZ Alkmaar ka fituar titullin e kampionit të Holandës të dielën. Alkmaar ka festuar titullin pasi që përcjellësi i parë Ajaxi është mposhtur bindshëm me shifrat 6:2 nga PSV Eindhoven. Për AZ Alkmaarin është titulli i dytë në histori, pas atij të vitit 1981. AZ tri javë pa përfunduar stinori ka 76 pikë, 11 më shumë se përcjellësi i parë që tash është Twente me 65 pikë.

**Nadal fiton turneun në Monte Carlo**



Tenisti numër një në botë spanjolli Rafael Nadal ka fituar për herë të pestë Master turneun në Monte Carlo. Nadal të dielën në finale ka mposhtur me 2:1 në sete, tenistin serb Novak Gjokoviq (6:3, 2:6, 6:1). Nadal 22-vjeçar ka përmirësuar rekordin e tij personal ndaj Gjokoviqit në 12:4 në fitore. "Dua të uroj Novakun për lojën e tij. Ju falënderoj po ashtu të gjithëve dhe mezi pres që të shihemi sërish vitin e ardhshëm", ka thënë Nadal.

Kampionët e Premier Leagues kërkojnë yllin e Milanit

# Kaka alternativë për Ronaldon në Man Utd



MANCHESTER, 19 PRILL - Manchester United e ka shënjestruar superyllin brazilian të Milanit, Leite Kaka, si alternativë në rast të largimit të portugezit Cristiano Ronaldo, përcjell "News of the World". Trajneri skocez i Man. Utd, Alex Ferguson, vlerëson se i vetmi futbollist që do të zëvendësonte Ronaldo do të jetë Kaka. Ferguson mendon të ofrojë 70 milionë funte për brazilianin. Mirëpo, kjo krejt varet nëse ylli portugez Cristiano Ronaldo do të kalojë në Real Madrid në verë. Ronaldo 24-vjeçar vazhdimisht është duke u kërkuar nga Real Madridi dhe ka gjasa të mëdha që të kalojë te skuadra e madhe spanjolle. Paratë nga shitja e Ronaldos United do t'i përdorë për blerjen e Kakasë. Pjesën tjetër do të ofrojë për të transferuar yllin francez të Bayern Munchenit, Franck Ribery.
Kaka 27-vjeçar ishte kërkuar nga Manchester City në janar. Skuadra angleze ofroi shumë rekorde prej 100 milionë eurosh dëmshpërblim, mirëpo braziliani vendosi t'i mbetet besnik Milanit. "Nuk është sekret që Ronaldo do të largohet në verë. Ai edhe vetë e ka bërë të qartë se me Unitedin do të përfundojë gjithçka me këtë stinor. Lojtarët e dinë këtë dhe po ashtu edhe Ferguson duhet të pranojë këtë. Tash është puna që të arrihet marrëveshja për dëmshpërblim dhe të gjendet një pasardhës për Ronaldon", ka thënë një burim i afërt me skuadrën kampione të Anglisë dhe të Evropës.
Kaka ndërkohë më herët kishte bërë të qartë se nëse vendos të largohet nga Serie A atëherë ka për të luajtur me një skuadër angleze.
Kaka së bashku me sulmuesin e Interit, Zlatan Ibrahimoviq, janë dy futbollistët më të paguar. Braziliani me Milanin ka kontratë deri në verën e vitit 2013.

Nisi plejofi në NBA - çerekfinalet nëpër konferenca

# Kampioni humb përparësinë e terrenit

**Bostoni, kampioni në fuqi i NBA-së, do ta ketë vështirë të mbrojë titullin e fituar vjet. Kjo skuadër qysh në start ka dështuar. Chigago e ka mposhtur në midis të Bostonit dhe ia ka marrë përparësinë e terrenit vendas. Njësoj si Chigago ka shpërthyer edhe Dallasi në duel me San Antonion**




| | |
|---|---|
| Boston - Chicago *(Rondo 29 - Rose 36)* | 103:105 |
| Cleveland - Detroit *(James 38 - Stuckey 20)* | 102:84 |
| San Antonio - Dallas *(Duncan 27 - Howard 25)* | 97:105 |
| Portland - Houston *(Roy 21 - Brooks 27)* | 81:108 |

Boston, 19 prill - Derrick Rose ka bërë debutim të ëndrrave në plejof, një debutim që vetëm legjendari Kareem Abdul-Jabbar e pati bërë. Rose ka realizuar 36 pikë dhe 11 asistime për të udhëhequr Chicagon drejt fitores të shtunën ndaj kampionit në fuqi të ligës NBA, Bostonit. Bullsat triumfuan pas lojës shtesë me shifrat 105:103, koha e rregullt u mbyll 97:97.
Rose ndonëse "rookie" dhe i papërvojë shkatërroi kampionin dhe madje në Boston.
"Atij nuk i nevojitet përvoja. Ai qysh tash ka një përvojë të një veterani. Ai kishte një natë fenomenale", ka thënë fundori i Chicagos, Ben Gordon. Gordon ka përfunduar ndeshjen me 20 pikë.
Rose madje me përformancën e tij arriti një rekord që nuk e kishte bërë as legjenda e NBA-së dhe e Chicagos, Michael Jordan.
"Më duket se djelmoshat kanë bërë një hap të madh para dhe e di se kemi një sfidë të madhe përpara. Ne do të shijojmë këtë fitore sonte dhe që nga nesër do të vazhdojmë të jemi të gatshëm për duelin e radhës", ka thënë trajneri i Chicagos, Vinny Del Negro.
Bostoni vitin e kaluar ishte i pakonkurrencë. Treshja e madhe Kevin Garnett - Paul Pierce - Ray Allen, fitoi titullin e kampionit pa shumë telashe. Mirëpo, kësaj radhe Celticsat do të kenë punë shumë të vështirë. Punët e Celticsave vështirësohen edhe më shumë me mungesën e Kevin Garnettit. Ai është i dëmtuar dhe nuk pritet të jetë i gatshëm për plejof.
"Shpresoj që ky të jetë gongu për t'u zgjuar. Shpresoj që të kuptojmë se Chicago nuk është skuadër që kënaqet vetëm me faktin se ka siguruar pjesëmarrjen në plejof. Shpresoj që të zgjohemi dhe të kuptojmë realitetin. Më mirë të marrim seriozisht këtë sfidë", ka thënë organizatori i Bostonit, Rajon Rondo, që ndeshjen e përfundoi me 29 pikë, 9 kërcime e 7 asistime.
Ndeshja e ardhshme midis Bostonit dhe Chicagos do të zhvillohet të hënën mbrëma. Edhe kjo ndeshje zhvillohet në Boston. Në fakt, Chigago me këtë fitore ka marrë përparësinë e terrenit të cilën e kishte Bostoni si skuadër më mirë e ranguar.
Njësoj edhe Dallas Mavericks ka marrë përparësinë e terrenit në duel me San Antonion, pasi e ka mposhtur si mysafir me shifrat 105:97.
Josh Howard me 25 pikë ka qenë shënuesi më i mirë në radhët e Dallasit.
"Është një fitore e madhe për ne", ka thënë Howard.
San Antonio që ka përfunduar në pozitën e tretë në Konferencën Perëndimore në plejof do të luajë pa fundorin argjentinas Manu Ginobili, për të cilin stinori ka përfunduar shkaku i një dëmtimi të këmbës.
"Ne kemi qenë në këso pozite edhe më herët. Por është një humbje e madhe për ne, pasi kemi humbur avantazhin e fushës", ka thënë ylli i San Antonios, Tim Duncan, që ndeshjen e ka përfunduar me 27 pikë. Skuadra më e suksesshme në stinorin e rregullt, Cleveland, ka shënuar fitore pa shumë telashe në ndeshjen e parë të plejofit. Clevelandi mposhti Detroitin 102:84.
Në NBA tutje shkon skuadra që arrin e para katër fitore.

Djali i legjendës franceze larg syrit të publikut dhe mediave

# Zidane Jr. princi i vogël i Realit

**Ata që duan t'i afrohen djalit të Zinedine Zidanit fillimisht duhet të sigurojnë akreditimin tek klubi madrilien. Enzo 14-vjeçar ruhet si një margaritar. Ai në fushë mahnit sikur babai i tij. Një driblues i mirë, një asistues fenomenal. Natyrisht se edhe mban numrin 10. Po ashtu dallohet lehtë pasi stilin e qëndrimit e ka të ngjashëm me të legjendës franceze**

MADRID, 19 PRILL (BILD) - I riu është në përkujdesje sikur të ishte një princ i vogël. Ata që dëshirojnë t'i afrohen duhet të kenë një akreditim të posaçëm, përndryshe do të refuzohen.



"Nuk e ke leni lejen të flisni me të. Ai është ende një fëmijë dhe ne duhet ta mbrojmë", thonë zyrtarët e Realit, në momentin kur refuzojnë mediumet pa akreditim.
Fjala është për të riun Enzo Zidane, djalin e ish-futbollistit më të mirë në botë Zinedine Zidane. 14-vjeçari luan për të rinjtë e Real Madridit, skuadër kjo me të cilën babai i tij ka gëzuar periudhën më të mirë duke e fituar edhe Ligën e Kampionëve në vitin 2002.
Enzo - kështu e ka emëruar babai i tij pasi që ishte adhurues i yllit urugajas Enzo Francescoli. Enzo është një talent i madh, një gjë që e di edhe vetë babai i tij, legjenda e futbollit Zinedine Zidane.
"Unë e di se ai ka një potencial të madh", thotë Zidane.
Edhe mediumet e vlerësojnë lart Enzon, duke thënë se do të mund të arrijë sukseset e babait.
"Enzo e ka stilin e babait të tij. Ai është një talent i madh që pritet të dëgjohet shumë në të ardhmen", ka thënë shefi i gazetës sportive spanjolle "AS", Tomas Guasch.
Zidane Jr. që në dukje lë përshtypjen e një djaloshi të druajtur dhe të edukuar, në fushë mahnit sikur babai i tij. Një driblues i mirë, një asistues fenomenal. Natyrisht se edhe mban numrin 10, numër që kishte babai i tij. Po ashtu dallohet lehtë pasi edhe ka stilin e qëndrimit të babait të tij.
"Në shtëpi kam luajtur shumë me babanë. Ai më ka mësuar shumë gjëra", thotë Enzo.
Mirëpo emri dhe fama e babait është presioni më i madh për të.
"Ai e di se çfarë kuptimi është për të mbajtur emrin Zidane. Asaj nuk mund t'i ikë", ka thënë Zizou.
Për të mos u dalluar në shikim të parë, Enzo ne fanellë mban emrin "Enzo Fernandez" - mbiemrin e vajzërisë së nënës. Zyrtarët e Realit nuk dëshirojnë të bëjnë aq të madhe punën e Enzos. Ata dëshirojnë ta kursejnë djaloshin nga presioni medial. Sa herë që fotografët nisin të shkrepin aparatet në kohën kur Enzo gjendet në autobus, zyrtarët e klubit mbyllin perdet.
E ardhmja do të tregojë nëse emri Zidane është mallkim apo bekim për të riun Enzo.

## Blic sportiv

### West Ham kërkon Kuranyin



Skuadra angleze West Ham United është duke u interesuar që në verë të transferojë sulmuesin gjerman të Schalkes, Kevin Kuranyi, përcjell "News of the World". Kuranyi 27-vjeçar ka shprehur dëshirën që të kalojë në Premier Leaguen e Anglisë, ndërsa ai është duke u pëlqyer nga trajneri italian i West Hamit, Gianfranco Zola. Për Kuranyin më herët ishte interesuar edhe skuadra tjetër angleze Manchester City. Kuranyi me Schalken ka kontratë deri në verën e vitit 2010. Ai më herët kishte qenë pjesë e skuadrës tjetër gjermane Stuttgart.

### Real, katër javë pa Sneijderin



Mesfushori holandez Wesley Sneijder do të qëndrojë jashtë fushe për katër javë, pasi ka marrë një dëmtim të muskulit të shtunën mbrëma, përcjell faqja zyrtare e Real Madridit të dielën. Sneijder është dëmtuar në fitoren 1:0 të Realit, të shtunën ndaj Recreativo Huelvas. Sneijder me këtë lëndim pritet t'i mungojë Real Madridit në ndeshjen vendimtare të Primera Divisionit kundër Barcelonës, që do të mbahet në fillim të muajit maj.

### Inter ofron Quaresman për Decon




Inter është i gatshëm të ofrojë mesfushorin ofensiv portugez Ricardo Quaresma në ndërrim për brazilianin Deco, përcjell gazeta italiane "Gazzetta dello Sport" të dielën. Quaresma është duke luajtur në Chelsea si huazim, ndërsa në atë skuadër është edhe Deco. Trajneri portugez i Interit, Jose Mourinho, është duke u interesuar për ta rikthyer ish-futbollistin e tij, Deco. Me këtë të fundit ai në vitin 2004 kishte fituar Ligën e Kampionëve me Porton.

Serie A

# Barazimi me Juven ia “nxjerr” gjuhën Mourinhos

**“Mua më pëlqen të luaj në stadium të një klubi historik, të marr një pikë dhe të shoh skuadrën nikoqire (Juventusin) të kënaqet me atë barazim. Mendoj se është spektakli dhe respekti më i madh që Interi mund të marrë. Sonte Inter e ka vërtetuar se e meriton kreun e tabelës. Kemi epërsi prej 10 pikëve dhe jemi skuadra më e mirë në Itali”, ka thënë Jose Mourinho**

TORINO, 19 PRILL - Trajneri portugez Jose Mourinho ka kohë që nuk është ndier kaq mirë sikurse të shtunën mbrëma në Torino. Skuadra e tij, Inter, ka barazuar me Juventusin 1:1 dhe me këtë barazim i është afruar edhe më shumë mbrojtjes së titullit.

Mourinho thotë se kur ka parë futbollistët e Juventusit të gëzohen aq shumë për barazim në fushën e tyre, është ndier tepër krenar.

“Mua më pëlqen të luaj në stadium të një klubi historik, të marr një pikë dhe të shoh skuadrën nikoqire të kënaqet me atë barazim. Mendoj se është spektakli dhe respekti më i madh që Interi mund të marrë. Sonte Inter e ka vërtetuar se e meriton kreun e tabelës. Kemi epërsi prej 10 pikëve dhe jemi skuadra më e mirë në Itali”, ka thënë Mourinho.

Inter ka kaluar i pari në epërsi nëpërmjet sulmuesit të ri Mario Balotelli (64), ndërsa Juventus krejt në fund të ndeshjes ka barazuar rezultatin nëpërmjet çekut Zdenek Grygera (91). Juventus që nga minuta e 76-të ka luajtur me një lojtar më pak pasi është larguar me karton të kuq portugezi Tiago.

“Kemi arritur që me një lojtar më pak të kthejmë rezultatin. Jam i kënaqur. Në pjesën e parë u kemi shkaktuar mjaft telashe, mirëpo jemi ndalur paksa në pjesën e dytë. Por, prapë Interi ka mbrojtjen më të mirë në Serie A dhe është e vështirë të krijohen rastet. Ne e dimë se çfarë lloj ekipi ndërton Mourinho. Mendoj se në fund të stinorit tabela nuk gënjen. Interi ndonëse shpesh fiton me një gol në fund edhe kjo llogaritet fitore. Mendoj se e ka merituar titullin”, ka thënë trajneri i Juventusit, Claudio Ranieri.



Interi gjashtë javë pa përfunduar stinori ka tubuar 74 pikë, 10 më shumë se Juventusi që gjendet në pozitën e tretë.

“Do të fitojmë ‘scudetton’ brenda disa javëve. Na nevojiten tetë pikë nga gjashtë ndeshje, tri prej tyre si nikoqirë. Jemi në një situatë mjaft komode. Asnjë skuadër tjetër në Evropë nuk ka epërsi kaq të madhe”, ka thënë Mourinho.

Interi këtë edicion ka pësuar vetëm dy humbje, ndërsa ka sulmin dhe mbrojtjen më të mirë në Serie A.

“Ne kemi merituar të mposhtim Juventusin. Madje edhe pa fituar kemi treguar se jemi më të mirët në Itali”, ka vazhduar Mourinho.

## Man. Utd eliminohet nga Kupa e Anglisë

Manchester United është eliminuar nga gjysmëfinalja e FA Cup të Anglisë të dielën, pasi është mposhtur nga Evertoni pas penalltive me shifrat 4:2. Koha e rregullt dhe loja shtesë përfunduan pa gola. Ish-portieri i Man. Utd, Tim Howard, ka mbrojtur penalltinë e Rio Ferdinandit dhe Dimitar Berbatovit për t'ia shuar ëndrrën Unitedin për të fituar katër titujt e mundshëm për një stinor.

Everton në finale të FA Cup do të takohet me Chelsean. Chelsea të shtunën mposhti Arsenalin (2:1).

## Serie A - 32

| | |
|---|---|
| **Milan – Torino** | **5:1** |
| *(Inzaghi 13’, 37, 60’, Kaka 68’ pen., Ambrosini 90’ – Franceschini 80’)* | |
| **Genoa - Lazio** | **0:1** |
| *(Zarate 65')* | |
| **Juventus - Inter** | **1:1** |
| *(Grygera 90+1' - Balotelli 64')* | |
| **Palermo - Bologna** | **4:1** |
| *(Belleri 6' a.g., Kjaer 44', Succi 63', Cavani 90+2' - Di Vaio 84')* | |
| **Siena - Chievo** | **0:2** |
| *(Pellissier 22', 48')* | |
| **Udinese - Fiorentina** | **3:1** |
| *(Asamoah 10', d'Agostino 47' pen., 69' - Dainelli 67')* | |
| **Roma - Lecce** | **3:2** |
| *(Totti 3', 59' pen., Brighi 13' - Munari 31', Papadopoulos 55')* | |
| **Cagliari - Napoli** | **2:0** |
| *(Jeda 5', Lazzari 90+2')* | |
| **Atalanta - Reggina** | **0:1** |
| *(Ceravolo 40')* | |
| **Catania - Sampdoria** | **2:0** |
| *(Mascara 39' pen., Martinez 48')* | |

| | |
|---|---|
| 1. Inter | 74 |
| 2. Milan | 64 |
| 3. Juventus | 64 |
| 4. Genoa | 57 |
| 5. Fiorentina | 55 |
| 6. Roma | 52 |
| 7. Palermo | 49 |
| 8. Cagliari | 48 |
| 9. Lazio | 47 |
| 10. Udinese | 42 |
| 11. Atalanta | 41 |
| 12. Sampdoria | 40 |
| 13. Catania | 40 |
| 14. Napoli | 39 |
| 15. Siena | 37 |
| 16. Chievo | 34 |
| 17. Torino | 27 |
| 18. Bologna | 26 |
| 19. Lecce | 24 |
| 20. Reggina | 23 |

## Premier League - 33

| | |
|---|---|
| **A. Villa - West Ham** | **1:1** |
| *(Heskey 11' - Tristan 85')* | |
| **Middlesbrough - Fulham** | **0:0** |
| **Portsmouth - Bolton** | **1:0** |
| *(Kanu 78')* | |
| **Stoke C. - Blackburn** | **1:0** |
| *(Lawrence 75')* | |
| **Sunderland - Hull C.** | **1:0** |
| *(Cisse 45')* | |
| **Tottenham - Newcastle** | **1:0** |
| *(Bent 24')* | |
| **Man. City - WBA** | **4:2** |
| *(Robinho 8', Onuoha 20', Elano 55' pen., Sturridge 90+4' - Brunt 37', 53')* | |
| **Liverpool - Arsenal** | **të martën** |
| **Chelsea - Everton** | **të mërkurën** |
| **Wigan - Man. Utd** | **të mërkurën** |

| | |
|---|---|
| 1. Man. Utd | 71 |
| 2. Liverpool | 70 |
| 3. Chelsea | 67 |
| 4. Arsenal | 61 |
| 5. A. Villa | 54 |
| 6. Everton | 52 |
| 7. West Ham | 45 |
| 8. Fulham | 44 |
| 9. Tottenham | 44 |
| 10. Man. City | 41 |
| 11. Wigan | 41 |
| 12. Stoke C. | 39 |
| 13. Bolton | 37 |
| 14. Portsmouth | 37 |
| 15. Sunderland | 35 |
| 16. Hull C. | 34 |
| 17. Blackburn | 34 |
| 18. Middlesbrough | 31 |
| 19. Newcastle | 30 |
| 20. WBA | 25 |

## Primera Division - 31

| | |
|---|---|
| **Ath. Bilbao - La Coruna** | **0:1** |
| *(Alvarez 86')* | |
| **Atl. Madrid - Numancia** | **3:0** |
| *(Banega 62', Forlan 79', Simao 90')* | |
| **Getafe - Barcelona** | **0:1** |
| *(Messi 19')* | |
| **Malaga - Mallorca** | **1;1** |
| *(Apono 53' - Arango 59')* | |
| **R. Huelva - Real Madrid** | **0:1** |
| *(Marcelo 49')* | |
| **Espanyol - Santander** | **1:0** |
| *(Alonso 57')* | |
| **Valladolid - Villarreal** | **0:0** |
| **Almeria - Osasuna** | **2:1** |
| *(Negredo 71', 89' - Pandiani 84')* | |
| **Valencia - Sevilla** | **2:1** |
| *(Villa 45' pen., Mata 83' pen., Hernandez 90+4' - Escude 9')* | |

| | |
|---|---|
| 1. Barcelona | 78 |
| 2. Real Madrid | 72 |
| 3. Sevilla | 57 |
| 4. Valencia | 52 |
| 5. Atl. Madrid | 49 |
| 6. Villarreal | 49 |
| 7. Malaga | 47 |
| 8. La Coruna | 46 |
| 9. Valladolid | 40 |
| 10. Almeria | 37 |
| 11. Mallorca | 36 |
| 12. Santander | 36 |
| 13. Osasuna | 35 |
| 14. Betis | 34 |
| 15. Getafe | 34 |
| 16. Ath. Bilbao | 34 |
| 17. S. Gijon | 33 |
| 18. R. Huelva | 30 |
| 19. Espanyol | 29 |
| 20. Numancia | 28 |

## Bundesliga - 28

| | |
|---|---|
| **Schalke - E. Cottbus** | **4:0** |
| *(Pander 4', Altintop 23', Jones 60', Kuranyi 88')* | |
| **A. Bielefeld - B. Munchen** | **0:1** |
| *(Toni 64')* | |
| **Koeln - Stuttgart** | **0:3** |
| *(Gomez 16', 55', 71')* | |
| **Wolfsburg - Leverkusen** | **2:1** |
| *(Grafite 23' pen., 85' - Kroos 54')* | |
| **Bochum - Dortmund** | **0:2** |
| *(Owomoyela 11', Valdez 54')* | |
| **E. Frankfurt - M'gladbach** | **4:1** |
| *(Meier 40', Liberopoulos 47', Russ 80', Fink 88' - Daems 75' pen.)* | |
| **Karslruhe - Hoffenheim** | **2:2** |
| *(Freis 33', Federico 65' - Salihoviq 28', Teber 48')* | |
| **Hertha - W. Bremen** | **2:1** |
| *(Simuniq 71', Raffael 87' - Mertesacker 43')* | |
| **Hamburg - Hannover** | **2:1** |
| *(Petriq 2', 52' - Forssell 70' pen.)* | |

| | |
|---|---|
| 1. Wolfsburg | 57 |
| 2. B. Munchen | 54 |
| 3. Hamburg | 54 |
| 4. Hertha | 52 |
| 5. Stuttgart | 51 |
| 6. Schalke | 46 |
| 7. Dortmund | 46 |
| 8. Hoffenheim | 45 |
| 9. Leverkusen | 42 |
| 10. W. Bremen | 36 |
| 11. E. Frankfurt | 32 |
| 12. Koeln | 32 |
| 13. Hannover | 29 |
| 14. Bochum | 28 |
| 15. A. Bielefeld | 24 |
| 16. M'gladbach | 23 |
| 17. E. Cottbus | 23 |
| 18. Karlsruhe | 19 |

## Ligue 1 - 32

| | |
|---|---|
| **Caen - Nancy** | **1:2** |
| *(Yatabare 45' - Hadji 1', Adjet 84')* | |
| **Grenoble - Toulouse** | **1:0** |
| *(Courtois 40' pen.)* | |
| **Monaco - Rennes** | **3:1** |
| *(Leko 77' pen., Pino 84', 90' - Cheyrou 86')* | |
| **Nantes - Nice** | **2:0** |
| *(Bekamenga 19', Bagayoko 89')* | |
| **Sochaux - Auxerre** | **0:1** |
| *(Kahlenberg 85')* | |
| **Valenciennes - Le Mans** | **0:2** |
| *(Cerdan 49', Le Tallec 66')* | |
| **St. Etienne - Lille** | **2:1** |
| *(Ilan 50', Gomis 66' - Fauvergue 71')* | |
| **Lorient - Marseille** | **1:2** |
| *(Gameiro 7' - Civelli 59', Brandao 79')* | |
| **Paris SG - Le Havre** | **3:0** |
| *(Giuly 41', Rothen 55', Hoarau 89')* | |

| | |
|---|---|
| 1. Marseille | 64 |
| 2. Lyon | 60 |
| 3. Bordeaux | 59 |
| 4. Paris SG | 59 |
| 5. Toulouse | 56 |
| 6. Lille | 56 |
| 7. Rennes | 51 |
| 8. Nice | 44 |
| 9. Monaco | 40 |
| 10. Auxerre | 40 |
| 11. Lorient | 38 |
| 12. Le Mans | 38 |
| 13. Grenoble | 38 |
| 14. Valenciennes | 36 |
| 15. Nancy | 36 |
| 16. Nantes | 33 |
| 17. Sochaux | 32 |
| 18. St. Etienne | 32 |
| 19. Caen | 31 |
| 20. Le Havre | 21 |



Auto Avangarde
sh.p.k.
knaqësi
në vozitje
BMW EfficientDynamics
BMW 320d xDrive
E kuqe e mbyllur metalike
Tërheqja xDrive - Tërheqje me katër rrota
Motorri 2.0 diesel 130/177 kw/kf
Timoni Sportiv i lëkurës me multifunksione
Dritat Xenon të mesme dhe të gjata
Rrotat Fellne v-spoke R17
Ulëset Të parat sportive
37,000 €
Auto Avagngarde sh.p.k. shitës dhe servisues I autorizuar për BMW • 038 601 053 • bmw.ks@autoavangarde.org • www.autoavangarde.org • Zona industriale p.n. Prishtinë




doli në shitje
katalogu 200
shtëpi të bukura
dhe revista mujore
IDEA
ARHING
038 244 497 / 044 120 185
IDEA
200 SHTËPI të Bukura

Sot, më 20 prill 2009, bëhet 1 vit qëkur u nda përgjithmonë nga ne, bashkëshorti, babai, gjyshi ynë i dashur



## FUAT (SALIH) NALLBANI
(01.03.1945 – 20.04.2008)

Me dhembje përkujtojmë ditën që të humbëm. Dëshira dhe dashuria jote për të jetuar ishte e papërshkruar, por papritur u largove nga ne dhe more rrugën e përjetësisë. Mburremi me ty dhe veprat e tua, por ditët po kalojnë shumë vështirë pa ty bashkëshort, baba dhe gjysh i dashur. Kujtimi për ty nuk do të shuhet asnjëherë dhe do të qëndrosh përgjithmonë në zemrat dhe mendjet tona.

E përkujtojnë me mall dhe zemër të pikëlluar: bashkëshortja Nazani, djali Eda, nusja Merita, vajza Emeli, dhënderi Vetoni, si dhe nipat Merisi, Ajeri e Venisi.

7 ditë pa kunatën tonë të dashur



## AHSENE IMAMI SHKOLOLLI

Ishe e dashur, bujare, e urtë dhe me virtyte të larta njerëzore. Ashtu do të mbetesh përherë në zemrat tona.

Me respekt e përkujtojnë: Samiu, Hidajetja, Ernesti, Edona, Edoni, Egzoni dhe Arjeta.

Kaluan shtatë ditë nga vdekja e kunatës dhe gruas së axhës sonë shumë të dashur



## AHSENE SHKOLOLLI

Fëmijët e mi të thërrisnin nënë, ndërsa mua me doje si motër. Do të mbetesh e pavdekshme përjetë.

E përkujtojnë kunata Kismetja, djemtë Luani dhe Kreshniku, vajza Laura, nuset Blerta dhe Rejhanja, si dhe nipi Elioni.

Dhjet vite që kur pushon në altarin e lirisë atje ku pushojnë vetëm trimat, pa më të dashurin vëlla



## ENVER (HASAN) VITIA
(14.10.1973 - 21.04.1999)

Ike në amshim vetëm pse ata gjakpirës serbë të privuan nga jeta dhe kështu mbete pa e shijuar edhe ti Lirinë dhe tani Pavarësinë që aq shumë e deshe sa që edhe jetën ia fale, vetëm që Kosova të jetë e lirë. Gjaku yt u bë gur themel i Lirisë dhe i Pavarësisë së vendit ku sot fëmijët e tu Bernardi dhe Arbri e gëzojnë dhe përjetojnë këtë, duke të kujtuar me krenari. Mungesa e jote fizike te ne është mjaft e madhe, mirëpo këtë e kompenson vetëm krenaria për ty që neve na bën të mburremi dhe ty të bën të pavdekshëm. Kujtimet për ty, i dashur vëlla, janë të freskëta dhe të përhershme, ndërsa virtytet e tua na lehtësojnë dhimbjen dhe mallin për ty. Tani ti pusho i qetë në tokën e Kosovës së Pavarur, ndërsa ne do të mbajmë përherë në zemrat tona.
I lehtë të qoftë dheu i kësaj toke!

Të përkujtojnë me mal:l prindërit Hasani dhe Sofia, vëllai Emirsoni, bashkëshortja Flora, si dhe djemtë Bernardi dhe Arbri nga Prishtina dhe Gjermania.

Sot u mbushen 10 vite mall, dhimbje, por edhe krenari për ty, i nderuari dhe i dashuri



## ENVER (HASAN) VITIA
(14.10.1973 - 21.04.1999)

Trimat lindin dhe vdesin njëherë për të jetuar përherë! .....
I tillë ishe edhe ti Enver, prandaj ne sot pas një dekade e kujtojmë me dhembje 21 prillin, ditën në të cilën ajo dorë kriminale serbe të ndau nga kolona për të mos u kthyer më. Jeta qenka e rëndë pa ty, por heroizmi yt na bën krenarë dhe mburremi që të patëm të tillë. U desh që edhe gjaku yt të pikojë mbi këtë tokë vetëm e vetëm që Kosova të frymojë e lirë, prandaj ti Enver së bashku me të gjithë ata dëshmorë të lirisë, të cilët u flijuat për Atdhe, tanimë jeni vendosur në altarin e lirisë atje ku prehen vetëm trimat. Sot, kur ne të gjithë e gëzojmë pavarësinë e Kosovës na duket disi e zbehur, sepse mungesa jote fizike disi le një vend bosh dhe zbrazësi shpirtërore ashtu sikurse kur Pranverës i mungon një lule e njomë dhe ngrohtësia diellore. Pra, pusho i qetë dhe i lehtë të qoftë dheu i Kosovës!

Përherë me mall dhe respekt për ty: axha Sylejman Vitia me shoqen Egzonën dhe fëmijët Flauratin dhe Kestrinin nga Frankfurt/M Gjermani.

Fidanfarm
Nga Himalajet ofron barna 100 % natyrale:
- kundër bakterjeve në urinë
- kundër sekretit vaginal
- kunder gurëve ne veshkë
- për sëmundjen e sheqerit
- kundër kollitjes
- kundër tharitrës në lukth
- për problemet e klimaksit
- për qetësim
- kundër urinimit spontan të femijëve gjatë natës,
- kundër sëmundjes se pankreasit, prostatës, artmisë së zëmrës, holesterolit, tensionit të lartë të gjakut, hemoroideve, për bronhitis, oreks, kundër sterilitetit, për imunitet, për pagjakësisnë, për gjendrën tiroide, për rregullimin e tretjës, etj.
Poashtu ofrojmë: produkte të mjaltit të begatuara me vitamina e minerale nga Himalajet.
Përfaqësues ekskluziv për Kosovë: FIDANFARM Prishtinë
Fidanfarm
Qendra Tregtare te Posta e re Dardania Prishtinë
Tel: 038/544-031,044/174-515
FIDANFARM
FIDANFARM, Fuqia e natyrës!



Përkujtojmë 7-vjetorin e vdekjes së bashkëshortes, vjehrrës dhe gjyshes sonë



## BELKIZE GOLA BATUSHA
1950-2002

Kujtimi dhe dashuria për ty nuk do të shuhen kurrë. Ishe dhe do mbetesh përherë në zemrat tona.

Me mall e përkujtojnë: bashkëshorti Aliu, djali Dukagjini, vajzat Arbënorja e Teuta, nusja Arbënorja, si dhe nipat dhe mbesat nga Gjakova.

Sot u mbushen 8 vjet dhembje e pikëllim



## ISLOM H. RADONIQI

S'gjenden dot fjalë që kanë forcën të shprehin dhembjen për ty, baba. Përherë jeton i gjallë me ne.

Të përkujtojnë: bashkëshortja Fahrija, djemtë, vajzat, nuset, nipat dhe mbesat nga Gjakova dhe Belgjika.

TREG I LIRË
www.shes.si
SHITJE & BLERJE NË INTERNET
PUBLIKONI SHPALLJE TE REJA FALAS
VETURA BANESA SHTEPIA KOMPJUTER
LOKALE TROJE GERADHEME PUNESIME
MAKINA MOBIL PRODHIME ELEKTRONIKE

SERVIS PËR PASTRIM
SHKELQIMI
Lajmë dhe terim tepiha kauqa, fotele, automobila.
Pastrim gjeneral dhe mirëmbajtje ditore.
Tek Ju ose tek Ne.
Transporti GRATIS Tel. 038 545 060
Tel.044 238-409 & 044 207 683

LURA



SHITEN BANESAT e gatshme
Në PRISHTINË afër FARMED-it.
Në GJILAN në qendër të qytetit
Sipërfaqja NETTO.
Çmimet: 689 €; 649€; 600 €
L.Haradinaj 17 PRISHTINË 038/222333 044/124776
e-mail: arrimgjakova@yahoo.com

Sot, më 20 prill 2009, bëhen 10 vjet pa më të dashurin tonë



## IMER H. JASHARI
(1956 – 1999)

Dhembja është e madhe për ty, por më e madhe është krenaria, sepse të patëm bujar fisnik e zemërgjerë.

E përkujtojnë me mall dhe respekt: bashkëshortja Florija, vajzat Njomza, djemtë Burimi dhe Shkëlqimi, babai Hasani dhe nëna Hanifja.

Kaluan dhjetë vite sa dhjetë shekuj pa ju





## SALIH QERIMI
1943 – 1999

## KADRI QERIMI
1968 – 1999

Ne ju kujtojmë dhe jemi krenarë që ishim pjesë e një epoke aq me sakrifica dhe aq domethënëse për gjithë kombin shqiptar. Kjo pjesë e historisë është shkruar me shkronja të arta. Ideali për të cilin ju u flijuat u realizua pas nëntë vitesh. Sot ne jetojmë në Kosovën e pavarur dhe përulemi para gjakut dhe veprës suaj.

Me respekt dhe krenari ju kujtojnë: bashkëshortja-nëna Mihanja, djemtë-vëllezërit Ilazi, Ekremi, Avniu, vajza-motra Asrija, reja-bashkëshortja Safetja me fëmijët Blinera dhe Valdrini, rejat-kunatat Ganja dhe Mirdita dhe mbesa Himara e vogël.

40 ditë nga ndarja me më të dashurën tonë



## MIRANDA LASKI
(16.12.1966-11.03.2009)

Kurrë nuk do të shuhen dashuria, kujtimi dhe malli për ty. Jemi krenarë që të patëm. Gjithnjë do të kujtojmë me respekt dhe dashuri.

E përkujtojnë me mall: bashkëshorti Preni, djemtë Emanueli dhe Samueli, vajza Emanuela dhe mbarë familja Gjergj Laski.

## SOKOL (HALIM) FAZLIU
(25.5.1961 – 20.4.1999)



Kriminelët serbë ta morën jetën në pranverën e përgjakshme dhe na i theu zemrat e vyshkën për tërë jetën pa birin, babanë, vëllanë e bashkëshortin tonë të dashur.

E përkujtojnë: nëna Fatimja, bashkëshortja Mihanja, djmtë Irfani, Fatoni, Adnani, si dhe reja Rrezarta nga Hajvalia.

Kaluan 136 ditë pa bashkëshortin, babanë, vëllanë, gjyshin, axhën tonë të dashur



## NAZMI (TAHIR) REXHEPI
(10.02.1946 – 6.12.2008)

Fjalët nuk mund ta përshkruajnë dhembjen tonë për ty. Kujtimet dhe dashuria për ty përherë do të mbeten në zemrat tona. Jemi krenarë që të patëm.

E përkujtojnë me mall: bashkëshortja Fatimja, djemtë Lulzimi, Bujari, Ibrahimi, Bashkimi, vajzat Bukurija, Kumrija, rejat Lumnija, Hava, nipat Bekimi, Blendi, Donarti, mbesa Loresa, vëllezërit, motrat si dhe mbar familja Rexhepi e Ajeti.

Sot, më 20 prill 2009, bëhen dhjetë vjet që kur dora e zezë barbare serbe vrau, djalin, vëllanë, nipin axhën tonë



## BEKIM (NAZMI) REXHEPI
(1973 – 1999)
Nga fshati Gllamnik – Podujevë

Me mall të pashuar e përkujton familja e Nazmi Rexhepit: nëna Fatimja, vëllezërit Lulzimi, Bujari, Ibrahimi, Bashkimi, motrat Bukurija, Kumrija, kunatat Lumnia, Hava, nipat Bekimi, Blendi, Donarti, mbesa Loresa, si dhe e gjithë familja Rexhepi dhe Ajeti nga Gllamniku.

## Tri vite pa ty

# MENDUH MUHARREM EFENDIJA

**Ecc i dipl.**



**Atë ditë të kobshme të prillit u ndave nga jeta, por në shpirtin mendjen dhe zemrat tona je i përjetshëm.**

**Me shumë mall për ty:**
**Bashkëshortja Alberija**
**Djemtë Shkumbini, Arijaniti, Labinoti**
**Vajza Dorina rejat nipat dhe mbesat.**

---

**Sot u bënë 3 vjet pa bashkëshortin, babanë dhe gjyshin tone të dashur**



## KARAMAN KURDA

**(1932 – 2006)**

**Koha po kalon shumë shpejt, por dhembja për ty, baba i dashur, kurrë nuk do të shuhet. Jemi krenarë që të patëm një baba të vërtetë. Gjithmonë do të jesh në zemrat tona.**

**E përkujtojnë bashkëshortja Fatimja,**
**djemtë Skenderi, Sedati dhe Ekremi, vajzat Barija**
**dhe Igballi, nipat, mbesat, rejat dhe dhëndurët nga Prishtina.**

---

**Sot u mbushën tri vite pa më të dashurin tonë**



## MENDUH (MUHARREM) EFENDIJA

**Ecc. i dplomuar**

**Fjalët e tij të ëmbla, bujaria, çiltërsia, sinqeriteti e respekti për të gjithë, na bëjnë që gjithmonë të mbetet në zemrat e mendjet tona. Ishe dhe gjithmonëë do të mbetesh krenaria e familjeve tona.**

**Të kujtojnë me mall të madh:**
**vëllezërit Mehmeti e Miniri me familjet e tyre**
**dhe motrat Mandushi dhe Nergizja me familjet e tyre.**

## PËRKUJTIM

# DARDAN (MUSA) BINAKAJ

**(28.09.1986 - 20.04.2008)**



**Kujtimet tona për ty nuk do t'i zbeh koha.**
**Dhembja mbetet gjithmonë në thelb të shpirtit.**
**Vdekja të ndau nga ne, por jo edhe nga kujtimet dhe zemrat tona.**
**Mbesim gjithmonë në kujtime të përjetshme për ty!**
**Do të na mungojnë ngrohtësia, sinqeriteti, dashuria dhe kujdesi yt.**
**Dielli rrezon në pavdekësinë e dashurisë sonë për Ty.**
**Yjet kanë shkëlqimin e shpresës.**
**Zemrat tona do të kenë durimin deri në ditë të vdekjes!**

**Nga New York-u, të përkujtojnë:**
**Linda Oshlani, Kujtim Rugova, Alban Berani, Leuron Prelvukaj, Arben Mexhuani, Drilon Jakupaj, Korab Fazliu, Berat Jakupaj, Flamur Mjeku, Skender Ademi.**

---

**Një vit pa nipin, mikun dhe dajën tonë të dashur**



## ZIJADIN JUSUF MUNISHI

**(1941-2008)**

**Përjetësisht, me shumë mall dashuri dhe respekt.**

**E kujtojnë: halla Eminja me bashkëshortin Alushin, djemtë Refikun dhe Ademin, vajzat Misreten, Sadeten dhe Ylfeten.**

---

**Sot u bë një vit qëkur u nda prej nesh më i dashuri ynë**



## ZIJADIN JUSUF MUNISHI

**(1941-2008)**

**Kujtimi dhe malli për ty do të jenë përgjithmonë në zemrat tona, ndërsa krenaria që të patëm do të jetë udhërrëfimi ynë jetësor.**

**E përkujtojnë: nëna Hava, bashkëshortja Eminja; djemtë Shkumbini dhe Kushtrimi me bashkëshorten Arianitën; vajzat: Mimoza me bashkëshortin Dritonin dhe fëmijët Elzën dhe Orgesin, Pranvera me bashkëshortin Adrianin dhe djalin Orikun.**

---

**U bë një vit qëkur u nda prej nesh më i dashuri ynë**



## ZIJADIN JUSUF MUNISHI

**(1941-2008)**

**Ditët që kaluan nuk e shuan dot pikëllimin dhe mallin për ty. Do të mbetesh gjithmonë i dashur dhe i paharruar për ne.**

**E përkujtojnë: nëna Hava, vëllai Rexhepi me bashkëshorten Fetijen, djalin Visarin, vajzat: Edona me Besimin dhe Zana me Armendin dhe djalin Andin.**

---

**Sot, bëhen 6 muaj pa bashkëshortin, babanë, vjehrrin dhe gjyshin tonë**



## MON IMER KASTRATI

**1950-2008**

**Përherë do të jesh në mendjet tona. Sinqeriteti, bujaria e fisnikëria jote do të jenë përherë të pranishme tek ne.**

**E përkujtojnë me pietet: bashkëshortja Xhevahirja, djemtë Agroni, Ymeri, Jetoni, Ylberi, Agimi, rejat Leonora, Igballi, Florina, mbesat Delvina dhe Zanfina, si dhe mbarë familja Kastrati.**

---

**Sot u bë një vit pa ty, më i dashuri ynë**



## ZIJADIN JUSUF MUNISHI

**(1941-2008)**

**Kaloi një vit me dhimbje, pikëllim e mall për ty, i dashuri ynë. Kujtimin për ty do ta ruajmë me dinjitet dhe do të mbetesh gjithmonë krenaria jonë.**

**E përkujtojnë: vëllai Sefedini me bashkëshorten Alijen, Albani me Mimozën dhe Renenë, Shpëtimi me Lavdijen dhe Kronin, Adriatiku me Elirën dhe Blerina me Nehatin, Ruenën dhe Arsën.**

---

**Më 20 prill 2009, u bë një vit pa dhëndrin tonë të dashur**



## ZIJADIN JUSUF MUNISHI

**(1941-2008)**

**Dashuria, kujtimi dhe dhimbja për ty do të mbeten përherë në zemrat tona. I përjetshëm mbetet kujtimi për ty.**

**E përkujton me shumë respekt: miku Rexhep Devaja me familjen nga Ferizaj, Gjilani dhe Radivojci.**

**Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së birit dhe vëllait tonë të dashur**

# DARDAN (MUSA) BINAKAJ

**(28.09.1986 - 20.04.2008)**



**Dardan, ditët po kalojnë e dhembja dhe pikëllimi për Ty çdo ditë e më tepër po na i rëndon zemrat tona.**
**Asgjë më nuk ka kuptim pa Ty. As ditët nuk janë si më parë, as dielli nuk shndrit si dikur, ndërsa netët po zgjasin në pambarim.**
**As pranvera nuk do ta ketë më bukurinë e saj për ne.**
**Kurrsesi nuk po mund të pajtohemi se Ti më nuk je në mesin tonë, e ky fakt po na e këput shpirtin.**
**Dadi, ne po jetojmë me kujtimet për Ty, prandaj përjetë do të jesh në zemrat tona të përvuajtura.**
**Krenohemi që të patëm aq të mirë e bujar.**
**Zoti të shpërbleftë me Xhenet!**

**Përjetë të pikëlluar: babai Musa,**
**nëna Drita dhe motrat Albana e Donika.**

---

**Njëvjetori i vdekjes së papritur dhe tragjike të mikut dhe vëllaut tim të dashur:**



## DARDAN (Musa) BINAKAJ

**(28.09.1986 - 20.04.2008)**

**Një vit i zymtë e i vuajtur pa dritën e jetës sime: vëllanë, shokun dhe shpirtin tim. Fjalët nuk mund ta përshkruajnë dhimbjen që kemi për ty, Dadush. Na mungon çdo gjë jotja: buzëqeshja, shakaja, ngrohtësia dhe dashuria jote që i fale çdonjërit, pa të cilat kjo jetë është aq e zbrazët dhe e ashpër për ne. Çdo sekondë të jetës të kemi në zemrat tona, lutjet, bisedat dhe mendimet tona. Nuk mund të pajtohemi që ti na le të vetëm, e me dhimbje të përhershme në zemër. Në zemrat tona të vrara i vetmi ngushëllim mbetet se një ditë pas vdekjes do të takohemi e të jemi bashkë sërish.**

**Të kujtojnë me mall e dhimbje të thellë në shpirt:**
**motra Albana (tota jote) me bashkëshortin Kujtim Rugova.**

---

**Në njëvjetorin e vdekjes së papritur dhe tragjike të mikut dhe vëllait tim të dashur**



## DARDAN (Musa) BINAKAJ

**(28.09.1986 - 20.04.2008)**

**Ike herët në pranverë, si një dallëndyshe që nuk kthehet më. Ike dhe na le me zemra të thyera. Dadi, jeta është tërë dhembje dhe çdo gjë është e pakuptim dhe e rëndë pa Ty. Ditët janë të ftohta dhe asgjë nuk është si më parë. Kush do të më bëj të qesh si dije ti me thëniet dhe shakat e tua. Pse ajo lumturi e pafund që e kishim u desh të ndalet kaq herët? Gjithçka që flitet sot në mesin tonë ka të bëjë me jetën dhe veprat e Tua të shkëlqyera. Aq shumë i doje dhe të donin fëmijët, por nuk arrite që ta shohësh mbesën tënde Vitën e vogël, të cilën do ta kishe dashur pa masë. Mirëpo, ajo gjithmonë do ta dijë që ka pasur një dajë të pashoq. I kishe gjithsej dhjetë muaj miqësi me Albanin, dhjetë muaj që do të mbeten si dhjetë margaritarë në zemrat tona. Shëmbëlltyra jote si vëlla dhe mik i vërtetë do të mbetet udhërrëfyes për ne dhe pasardhësit tanë. Ndoshta respekti i madh dhe sinqeriteti në pambarim na u kthye bumerang, por të paktën na e dhuroi një kujtim të shenjtë për Ty. Ishe i veçantë në jetë, i tillë do të mbetesh përgjithmonë në mendjet dhe në zemrat tona.**

**Të kujtojnë me mall të pashuar: motra jote Donika,**
**me bashkëshortin Alban Beranin dhe me vajzën Vitën.**

www.ipko.com

Telefoni fikse

# Bisedoni pa kufi me të afërmit tuaj në mbarë botën

# prej 10 centë në minutë për thirrjet ndërkombëtare

## Mbani kontaktet!

- Instalimi dhe numri: **falas**
- Parapagimi: 10€ - **për 1 vit**
- Llogarinë mbusheni kur të doni dhe sa të doni (në dyçanet IPKO, në bankomatët e ProCredit bankës dhe te distributorët e autorizuar ku shihet shenja IPKOmat).

### Përfitoni nga tarifat e volitshme ndërkombëtare

| Çmimi për minutë | Shtetet më të thirrura |
|---|---|
| 10 centë | SHBA, Gjermani, Zvicërr, Britania e Madhe, Kanadë, Kinë,Turqi, Francë, Shqipëri, Kroaci, Suedi, Slloveni, Sërbi, Maqedoni, Belgjikë, Austri, Holandë, Itali, Spanjë, Danimarkë, Norvegji, Australi, Bullgari, Finlandë |
| 15 centë | Mali i Zi, Bosne dhe Hercegovinë |
| 17 centë | Zelanda e Re, Monako |

*Për thirrjet në vendet tjera dhe mobil, vizitoni faqen www.ipko.com

IPKO thirrkudo